



**KORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT**

# **RAPORTI I MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2019**

---

## **STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015 – 2020**

## Tabela e Përmbajtjes

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2020 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2018-2020, PËR PERIUDHËN JANAR- DHJETOR 2019.....</b>	<b>4</b>
<b>II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT.....</b>	<b>5</b>
<b>III. MBI PLANIN E VEPRIMIT 2018 – 2020, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT.....</b>	<b>6</b>
<b>IV. ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – DHJETOR 2019.....</b>	<b>8</b>
<b>V. PROGRESI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT SIPAS QASJEVE.....</b>	<b>121</b>
<b>VI. MONITORIMI I PASAPORTËS SË INDIKATORËVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2019... </b>	<b>19</b>
<b>VII. PROBLEMATIKAT E HASURA GJATË RAPORTIMIT VJETOR .....</b>	<b>23</b>
<b>VIII. SFIDAT.....</b>	<b>23</b>
<b>Aneks - PLANI I MASAVE TË VEPRIMIT 2018-2020, NË ZBATIM TË SNKK 2015-2020.....</b>	<b>24</b>

## LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AZHBR	Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
ILDKPKI	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKK	Kordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PV	Plani i Veprimit
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
SPAK	Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE MBI STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2020 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2018-2020, PËR PERIU DHËN JANAR-DHJETOR 2019.**

Korrupsioni është një kërcënim për demokracinë, mirëqeverisjen, konkurrencën e ndershme, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi.

Ai pengon rëndë zhvillimin ekonomik, duke krijuar një sistem pabarazie, paragjykimi e nepotizmi, duke shkatërruar besimin e njerëzve tek shteti i tyre, prandaj lufta kundër korrupsionit është sot një nga sfidat parësore të çdo shteti me kulturë demokratike, vizion dhe integritet të lartë.

Qeveria ka dhe do vazhdojë në mënyrë të pandalur të ketë një vullnet të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, përmes aksioneve parandaluese, masave ndëshkuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.

Përparësia e qeverisë në fushën e luftës kundër korrupsionit, përkon më së miri me kushtëzimet e vendosura nga Bashkimi Europian për hapjen e negociatave për anëtarësimin në BE. Lufta kundër korrupsionit është një ndër pesë politikat të cilat vendi ynë këshillohet t'i ndjekë me përparësi në procesin e integritetit evropian të vendit. Po kështu, parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj.

Prej vitit 2015 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit. Vizioni i SNKK-së 2015-2020 është: *“Institucione shqiptare transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm”*.

Qëllimet madhore të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit janë parandalimi, ndëshkimi dhe ndërgjegjësimi/edukimi rreth korrupsionit. Këto qëllime janë afatgjata dhe shtrihen në kohë përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit mbulon periudhën prej 6 vjetësh, pasi ai parashikon objektivat dhe masat përkatëse që duhet të realizohen për përmbushjen e këtyre objektivave sipas afateve të detajuara në Planin e Veprimit kundër Korrupsionit. Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit duke qenë një strategji ndërsektoriale, është bazuar në parimin e koordinimit midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHI duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar.

Rishikim vjetor i Planit të Veprimit 2018-2020 për zbatimin e Strategjisë u krye nga Kordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, në mënyrë që të lejojë përshtatjen e Strategjisë me realitetet e reja dhe prioritetet e sektorëve.

Ky Plan Veprimi ka kaluar nëpër një proces konsultimi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit, përfshi këtu institucione të administratës shtetërore në nivel qendror dhe lokal dhe institucione të pavarura, organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, shoqërinë civile etj.

Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë parasysh dhe janë reflektuar edhe ndryshimet e ndodhura si pasojë e reformave të ndërmarra si Reforma në Drejtësi dhe Reforma Administrative Territoriale.

Për hartimin e këtij dokumenti, fillimisht nga ana e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit u krye një vlerësim i zhvillimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, u analizua Plani i Veprimit 2015-2017 i kësaj strategjie, si dhe u identifikuan dhe analizuan problematikat e hasura nga institucionet në implementimin e masave të përcaktuara në këtë plan veprimi.

Një rol të rëndësishëm në procesin e hartimit të Planit të Veprimit 2018-2020, ka patur edhe Pasaporta e Indikatorëve të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, me anë të së cilës janë përcaktuar tregues të matshëm të realizimit të objektivave të kësaj strategjie.

Me Vendimin Nr. 241, dt.20.04.2018 të Këshillit të Ministrave u miratua Plani i Veprimit 2018 – 2020 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, Pasaporta e Indikatorëve, krijimi, funksionimi dhe detyrat e Komitetit Koordinator për zbatimin e SNKK-së dhe Task-Forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion.

Krijimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, përgjegjëse për inspektimet ndërinstitucionale, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, kryesohet nga Ministri i Drejtësisë, Koordinator Kombëtar Antikorrupsion dhe ka në përbërje përfaqësues nga Kryeministria, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Inspektoriati Qendror.

Komiteti Koordinator kryesohet nga Ministri i Drejtësisë dhe ka në përbërje 10 anëtarë, në nivel Zëvendësministri nga secila Ministri Linje (pa përfshirë këtu 2 Ministritë pa portofol).

## **II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 166, dt. 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë,” pranë Ministrisë së Drejtësisë është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive.

Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit. Ky raport mbulon periudhën nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2019 dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit të SNKK-së. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Çdo institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo politike dhe aktiviteti, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, përsa i përket realizimit të nën-aktiviteteve, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektiv.

Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në dy faza kryesore:

1. Raportimi i institucioneve mes pikave të kontaktit, mbi zbatimin e masave për të cilat janë përgjegjëse; dhe
2. Raportimi nga KKK mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij.

Raporti i Monitorimit ka kërkuar një proces të përbërë nga 2 etapa raportimi për shumicën e institucioneve me qëllim plotësimin dhe saktësimin e informacionit të kërkuar. Zgjatja e procesit të raportimit ka qenë e

nevojshme, pasi raportimi në raundet e para rezultoi i paplotë ose i paqartë në shumë nga komponentët e Matricës së Raportimit.

Ecuria e progresit në periudhën që monitorohet, klasifikohet në 3 kategori:

1. Realizuar: Institucionet kanë raportuar “Realizuar” statusin e masës/aktivitetit për periudhën e raportuar. Për masat/aktivitetet me tregues zbatimi periodik, institucionet kanë paraqitur edhe hapat në vijim.
2. Në proces: Institucionet kanë raportuar me këtë status ato masa/aktivitete për të cilat në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm. Institucionet kanë raportuar edhe mbi hapat në vijim për zbatimin e plotë të masës.
3. Pa-realizuar: Të pa-realizuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese. Gjatë procesit të raportimit, synohet mbledhja e informacionit edhe në lidhje me periudhën që planifikohet të ndërmerren masa për realizimin e tyre.

Në vijim, janë trajtuar të dhënat për secilën etapë dhe janë përgatitur udhëzimet me informacionet shtesë që institucionet duhet të plotësojnë për kuadrin e nevojshëm të të dhënave. Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht on-line për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, për të siguruar saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhur. Një rol të rëndësishëm në procesin e hartimit të Raportit Vjetor të Monitorimit për periudhën Janar - Dhjetor 2019, ka patur edhe Pasaporta e Indikatorëve të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, me anë të së cilës janë përcaktuar **37** tregues të matshëm të realizimit të objektivave të kësaj strategjie. Monitorimi i Treguesve është kryer mbi bazë objektivi, të raportuara nga pikat e kontaktit antikorrupsion.

*Pas hartimit të draft raportit*, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikon draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft-raportin e monitorimit para se të miratohet nga Komiteti Kordinator.

### **III. MBI PLANIN E VEPRIMIT 2018–2020, NË ZBATIM TË STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT.**

Plani i ri i Veprimit 2018 – 2020, përbëhet në total nga 18 objektiva, ku 11 prej tyre bëjnë pjesë në qasjen parandaluese, 4 në qasjen ndëshkuese dhe 3 në qasjen ndërgjegjësuese, si më poshtë:

**Qasja Parandaluese**, e cila ka për qëllim çrrënjosjen e korrupsionit së pari nga radhët e administratës publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore dhe kryesisht nga institucionet që ofrojnë shërbime publike për qytetarët.

Kjo qasje shënon numrin më të madh të aktiviteteve që institucionet përgjegjëse planifikohet të zbatojnë gjatë gjithë periudhës dhe përbëhet nga objektivat e mëposhtëm:

- A.1 Rritja e transparencës në Veprimtarinë Shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion;
- A.2 Rritja e transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve publike;

- A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike;
- A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit;
- A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave;
- A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike;
- A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut;
- A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion;
- A.9 Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë;
- A.10 Analizimi i prirjeve të korrupsionit, i efektivitetit të masave antikorrupsion dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit;
- A.11 Artikulimi dhe adoptimi i politikave anti-korrupsion në nivelin e qeverisjes vendore.

**Oasja Ndëshkuese**, ka për qëllim që insitucionet ligjzbatuese dhe veçanërisht ato të pavarura, të cilat kanë një rol thelbësor në këtë proces, duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës, duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore. Kjo qasje përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit;
- B.2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërshkrimin penal të korrupsionit;
- B.3. Rishikimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar;
- B.4. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër korrupsionit.

**Oasja Ndërgjegjëse**, ka për qëllim që publiku të marrë pjesë në luftën kundër korrupsionit duke e denoncuar atë dhe duke qenë aktiv në iniciativa që synojnë parandalimin e fenomeneve korruptive. Kjo qasje përbëhet nga objektivat e mëposhtme:

- C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit;
- C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin e korrupsionit;
- C.3. Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Indikatorët e performancës<sup>1</sup> janë në total **37**, ku 21 prej tyre bëjnë pjesë në qasjen parandaluese, 9 në qasjen ndëshkuese dhe 7 në qasjen ndërgjegjëse. Ky plan veprimi përbëhet në total nga **97 masa**, përkatësisht 52 masa për qasjen parandaluese, 19 masa për qasjen ndëshkuese dhe 26 masa për qasjen ndërgjegjëse. Numri i institucioneve të përfshira në procesin e hartimit të Planit të Veprimit është 84 (11 Ministri, 12 Institucione të nivelit qendror dhe 61 Bashki).

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 241, datë 20.04.2018 “Për miratimin e Planit të Veprimit 2018-2020, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2020, e të pasaportës së indikatorëve, krijimin, funksionimin dhe detyrat e Komitetit Kordinator për zbatimin e

<sup>1</sup> Për arritjen e objektivave të parashikuar dhe vlerësimin e indikatorëve të performancës, është hartuar Pasaporta e Indikatorëve në zbatim të SNKK-së, duke shpjeguar metodologjinë e detajuar për kalkulimin e vlerave të baseline dhe target të paraqitura nga institucionet, një informacion i plotë mund të gjenden në faqen 20-22 të këtij dokumenti.

Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion”, Ministria e Drejtësisë në muajin janar 2020 filloi procesin e monitorimit të SNKK-së për vitin 2019.

Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, ka si synim arritjen e objektivave madhor të kësaj strategjie nëpërmjet realizimit të masave konkrete anti-korrupsion, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas kundër korrupsionit, i cili është në gjendje për të përfituar rezultate të prekshme dhe të tregojë tendencë drejt eliminimit maksimal të kërcënimeve të korrupsionit, si dhe vullnetit për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin. Për të monitoruar ecurinë e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, është hartuar raporti në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit 2018 – 2020, i cili përbën raportin e tetë të monitorimit në vitin 2019 të Strategjisë dhe mbulon periudhën nga 1 janar 2019 deri në 31 dhjetor 2019. Raporti i monitorimi është realizuar nëpërmjet raportimit nga Pikat e Kontaktit Antikorrupsion. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet, progresin dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të sipërpërmendura të strategjisë lidhur me nivelin e zbatimit të çdo mase, buxhetin e alokuar, si dhe ecurinë për këtë vit.

#### **IV. ARRITJET KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – DHJETOR 2019.**

Arritjet kryesore më të rëndësishme për periudhën vjetore, në zbatim të Planit të Veprimit 2018-2020, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit janë si më poshtë vijon:

##### **Oasja Parandaluese**

1. Të gjitha ministritë kanë miratuar dhe publikuar në faqet e tyre të internetit programet e transparencës.
2. Zyra e Komisionerit ka evidentuar 417 autoritete publike të cilat kanë publikuar programin e transparencës, ku nga monitorimi rezultoi se 246 autoritete publike kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare programe transparence, 189 kanë publikuar regjistër të kërkesave dhe përgjigjeve dhe 236 kanë publikuar kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit. Si rezultat i këtij monitorimi janë nxjerrë 30 rekomandime për autoritetet e pavarura dhe ministritë. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019 numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet sistemit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve është 516. Për të njëjtën periudhë numri i ankesave drejtuar Zyrës së Komisionerit nëpërmjet regjistrit elektronik është 147 në total.
3. Janë shqyrtuar në total 786 ankesa të depozituara nga qytetarë por edhe nga organizata të shoqërisë civile. Nga këto ankesa 553 prej tyre janë zgjidhur me ndërmjetësim, 140 janë konstatuar si jashtë objektit, 34 jashtë afatit dhe 16 të paplota. Janë marrë 18 vendime, nga këto: 11 Vendime Urdhërimi, 5 Vendime me Gjobë dhe 2 Vendime Rrëzimi të ankesës. Janë zhvilluar 28 seanca dëgjimore dhe janë kryer 85 inspektive.
4. Gjatë vitit 2019, ka përfunduar përgatitja e Metodologjisë së Vlerësimit të Rikut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes për qeverisjen vendore. Materialet i janë nënshtruar konsultimit publik dhe më pas janë reflektuar të gjitha sygjerimet e mbledhura gjatë këtij procesit të konsultimit. Në muajin dhjetor Zyra e Komisionerit monitoroi të 61 bashkitë. Nga monitorimi rezultoi se 56 nga 61 bashki kanë vënë në zbatim Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.



5. APP si pasojë e masave të ndërmarra ka përmbushur plotësisht objektivin A.2. Për këtë periudhë (janar – dhjetor 2019), përqindja e elementeve të ndryshuar në regjistrin e parashikimeve është 15%, përqindja e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara në fund të vitit është 3.2%, ndërsa përqindja e ndryshimeve të kontratave nga të dhënat e administruara është 1.6%.
6. Në vitin 2019, AKSHI ka shtuar përsëri shërbime të reja elektronike. Për periudhën janar-dhjetor 2019, numri total i shërbimeve elektronike është 601. Janë gjithsej 302,068 përdorues të regjistruar në portalin e-albania. Mbi 7.6 milionë përdorime të shërbimeve elektronike të portalit nga qytetarët, bizneset dhe punonjësit e administratës çka nënkupton se 7.6 milionë vizita në zyrat e administratës janë eliminuar gjatë vitit 2019.
7. 2,813,000 dokumente me vulë dixhitale të gjeneruara në periudhën janar – dhjetor 2019, përmes modulit të e-albanias dhe portalit e-albania, duke reduktuar kështu burokracitë dhe duke eliminuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kontaktin qytetar - administratë.
8. Gjatë kësaj periudhe numri i hetimeve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në Policinë e Shtetit janë evidentuar **1286** vepra penale (ku përfshihen rastet e korrupsionit dhe veprat penale të zyrtarëve në detyrë), për të cilat janë kryer veprimet policore dhe hetimore dhe janë referuar në Prokurori. Nga Drejtoria e Standarteve Profesionale, janë regjistruar **928** ankesa të ardhura në Platformën “Zyra e Bashkëqeverisjes”, në Kryeministri.
9. Janë realizuar 12 trajnime të përbashkëta ndërmjet Prokurorisë dhe Policisë së Shtetit, në fushën e krimeve Ekonomike dhe Financiare, korrupsionit dhe të krimeve në detyrë mes institucioneve ligjzbatuese, me 34 përfitues nga burimet njerëzore që do të merren me trajtimin e rasteve të denoncuar nga qytetarët, apo hetime penale në këtë fushë.
10. Gjatë kësaj periudhe janë kryer **227** takime dhe analiza të përbashkëta me Prokurorinë dhe Agjencitë/Instucione të tjera ligjzbatuese, lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimeve penale.
11. Në institucionin e ILDKPKI-së ka përfunduar instalimi i hardware dhe konfigurimi i tyre lidhur me deklarin dhe kontrollin financiar të pasurive dhe konfliktit të interesit. Ky proces është kryer në vijim të përfundimit të virtualizimit dhe përfundimit të sistemit operativ, të zbatuar nga kompania Infosoft përgjegjëse për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike hardware.
12. Të dyja këto veprime operationale, janë shoqëruar me asistencë teknike dhe trajnime për stafin teknik dhe përdorues të tjerë të sistemit, pjesë e stafit të ILDKPKI-së.
13. Është ngritur Komisioni parlamentar Ad-Hoc për Reformën Zgjedhore. KQZ ka marrë pjesë rregullisht në të gjitha seancat e Komisionit në lidhje me kontrollin financiar të partive politike, duke dhënë kontributin në lidhje me përmirësimet e mundëshme ligjore.
14. Administrata e KQZ-së, në bashkëpunim me ekspertët e NDI, të financuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe, ka përfunduar draftimin e modelit standart për raportimin vjetor.
15. Modeli i raportimit, u miratua me vendimin e KQZ-së 152, datë 11.04.2019, “Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore”.
16. Gjatë vitit 2019, KQZ emëroi 34 ekspertë të cilët monitoruan dhe audituan 36 parti politike për fondet dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore 2019 dhe 16 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit.
17. Audituesit kanë dorëzuar në KQZ 35 raporte auditimi. Audituesit kanë çertifikuar financimin e fushatës zgjedhore për 35 parti politike.

18. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të auditit të brendshëm në MFE, për periudhën vjetore janë trajnuar 338 auditues të brendshëm, ose 100% e audituesve të brendshëm në detyrë të punësuar në sektorin publik, si dhe janë kryer 15 vlerësime të jashtme cilësie.
19. Për periudhën janar - dhjetor 2019, nga ana e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik (MFE) janë kryer 2 kallëzime penale në prokurori, si dhe janë inspektuar 30 subjekte, nga kryerja e 11 misioneve të inspektimit.
20. Nga kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë shtetërore, rezulton se gjatë vitit 2019, një pjesë e konsiderueshme e institucioneve kanë kryer kontrole të brendshme dhe inspektime 68,746, inspektime në terren 29,206 raste, për të cilat janë dhënë 432 rekomandime, janë vendosur 904 gjoba, si dhe janë kryer 172 ndërprerje aktiviteti. Janë zhvilluar 60 auditime tematike dhe përputhshmërie, tematik dhe performance. Për periudhën raportuese (janar – dhjetor 2019), janë dhënë në numër 8,239 masa disiplinore, administrative dhe organizative, 4 hetime administrative si dhe 76 referime penale në Prokurori për punonjës, ndër të cilat 46 persona të arrestuar.
21. Në kuadër të Task Forcës Antikorrupsion, për periudhën janar-qershor 2019, janë kontrolluar 13 institucione, kontrole në proces 13, si dhe janë rekomanduar: 91 masa administrative nga të cilat janë realizuar 84, rekomanduar 105 masa disiplinore dhe janë realizuar 65 të tilla nga ana e institucioneve të kontrolluara. Krijimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale Antikorrupsion, me Vendimin Nr. 241, dt.20.04.2018 të Këshillit të Ministrave përgjegjëse për inspektimet ndërinstitucionale, sipas Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, për periudhën Maj 2018 – Maj 2019, raporton se janë referuar në prokurori 36 kallëzime penale, kryesisht për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, në shumicën e rasteve dhe në bashkëpunim.

### **Oasja Ndëshkuese**

22. Shkolla e Magjistraturës ka realizuar dy aktivite trajnuese me pjesëmarrje të prokurorëve me tema: “Korrupsioni dhe legjislacioni i brendshëm dhe ndërkombëtar në këtë fushë. Veprat penale të Korrupsionit. Teknikat e hetimit dhe gjykimi i këtyre vepra penale”.
23. Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi i barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve..
24. Është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, në zbatim të V.K.M-së Nr. 06.11.2017 “Për Planin e Veprimit Kundër Krimit të Organizuar”, për krijimin e task forcës “Forca e Ligjit”, është krijuar dhe funksionin struktura Task Forca “Forca e Ligjit”, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda me ndikim të lartë shoqëror, krimit kundër korrupsionit dhe atij financiar, sekuestrimin e aseteve kriminale.
25. Është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Policisë së Shtetit “Për shkëmbimin e informacionit ndërmjet sistemit të menaxhimit policor të çështjeve të Policisë së Shtetit dhe sistemit të menaxhimit të çështjeve të Prokurorisë”. Aktualisht është duke u punuar për zbatimin e saj dhe për realizimin e ndërlidhjes së 2 sistemeve.

26. Për periudhën raportuese, është realizuar aksesi në dy databaza për të cilat u lidhën memorandume bashkëpunimi në vitin 2018. Konkretisht: Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Regjistrin Elektronik të Pasurive të Paluajtshme.
27. Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nënshkruan një memorandum bashkëpunimi, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore. Palët morrën përsipër në këtë memorandum, kallzimin dhe hetimin me përparësi të veprave penale në fushën e zgjedhjeve ku sensitiv është korrupsioni aktiv e pasiv në zgjedhje.
28. Për periudhën raportuese janar-dhjetor 2019, është rënë dakort në parim dhe po vijojnë komunikimet në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për aksesin në Regjistrin elektronik të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
29. Policia e Shtetit ka siguruar aksesin në bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronike shtetërore të disa institucioneve si: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, DPSHTRR, ZQRPP, QKB, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
30. Gjatë kësaj periudhe janë kryer 227 takime dhe analiza të përbashkëta me Prokurorinë, dhe Agjencitë/Instucione të tjera ligjzbatuese, lidhur me trajtimin e akteve dhe hetimeve të procedimeve penale.
31. Policia e Shtetit bashkëpunon me “EURPOL, “INTERPOL”, Oficer Ndërlidhës (Kontakti), të Policisë Shqiptare të atashuar në vende jashtë shtetit, si dhe me Oficer Ndërlidhës (Kontakti), të vendeve të atashuar në Shqipëri, CARIN, SELEK, BAMIN, INTERFORCË, etj., si dhe mbi bazën e marrëveshjeve dy palëshe me shtete të tjera.  
Numri i informacione të shkëmbyera me agjencitë homologe, në fushën e krimeve ekonomike dhe financiare janë: 718 informacione me Interpolin; 471 informacione me Europolin; me rrjetin e zyrave për gjetjen e rikuperimin e aseteve kriminale CARIN 32 informacione; 11 informacione të ardhura nga Interforca.
32. Ministria e Brendshme gjatë periudhës raportuese, ka nënshkruar 6 marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe memorandume bashkëpunimi në luftën kundër krimit, si Memorandum Mirëkuptimi mes Ministrisë së Brendshme të Republikës Çeke dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, për dhurimin e pajisjeve për autoritetet ligjzbatuese; Marrëveshje Pune ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Qendrës Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave; letër Qëllimi mbi bashkëpunimin për sigurinë ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Katarit. Me anë të ligjit 77/2019, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për luftën kundër falsifikimit të monedhës; Shqipëria aderoi në këtë konventë, etj.
33. Gjatë vitit 2019, janë zhvilluar 2 analiza të brendshme nga MB mes Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive dhe Drejtorisë së Integritimit dhe Marrëveshjeve, në shqyrtim të progres-raportit të Komisionit European, mbi zbatimin e rekomandimeve të tyre.

## Oasja Ndërgjegjësuere

34. Në muajin prill 2019, Ministria e Drejtësisë organizoi Forumin e pestë konsultativ, një takim në të cilin u trajtuan praktikat më të mira, konkluzionet dhe hapat që do të hidhen në vijim. I tillë mund të konsiderohet takimi përmblyllës i projektit Twinning. Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësues nga financuesit e Projektit të Binjakëzimit, BE-së, përfaqësues nga institucionet që bashkëpunuan për realizimin e Projektit, përfaqësues nga shoqëria civile vendase dhe rajonale të fushës, ekspertë antikorrupsion, etj.
35. Për të vlerësuar efektet e masave antikorrupsion të Qeverisë dhe fushatës për rritjen e ndërgjegjësimit për denoncimin e praktikave korruptive, u zhvillua nga ekspertët e Projektit të Binjakëzimit, një anketim me metodën e anketimit online mbi zbatimin e ligjit për sinjalizuesit, së bashku me partnerët akademikë dhe shoqërinë civile. Anketimi u krye gjithashtu edhe nëpërmjet faqes së internetit të projektit si dhe në faqet partnere. Anketat u shpërndanë në formë të printuar tek studentët në Universitetet e Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës.
36. Gjatë muajit Shkurt 2019, është realizuar trajnimi me temë “Anti -Korrupsioni për pikat e kontaktit në institucionet publike”. Ky trajnim u organizua nga ASPA në bashkëpunim me Projektin Twinning “Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e politikave antikorrupsion në Shqipëri”, financuar nga BE. Gjithashtu në muajin Qershor 2019, u organizua nga ASPA trajnimi me temë: “Korrupsioni në administratën publike dhe mekanizmat e identifikimit në luftën kundër tij”.
37. Në periudhën janar-dhjetor 2019, janë organizuar takime konsultative duke përfshirë të gjitha institucionet përgjegjëse për masat e përfshira në Planin e Veprimit. Takimet kanë pasur për qëllim hartimin/vlerësimin dhe rishikimin e masave (që vijnë nga plani në fuqi) në kuadër të hartimit të Planit të Ri të Veprimit, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.
38. Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, raporton periodikisht mbi denoncimet e qytetarëve dhe bizneseve, nëpërmjet të dhënave të detajuara të paraqitura në raport për çdo ministër dhe Kryeministrin. Në funksion të këtij objekti janë përmirësuar proceset në sistemin elektronik të platformës së bashkëqeverisjes duke mundur gjurmimin dhe etiketimin elektronik të rasteve të dyshuara si korruptive.
39. Përgjatë kësaj periudhe raportuese, AMShC-ja ka hartuar Vendimin e Brendshëm për krijimin e programit Anti- Korrupsion në funksion të monitorimit të aktiviteteve të Institucionit. Programi Anti- Korrupsion, ndodhet i pasqyruar në faqen zyrtare të AMShC-së dhe i aksesueshëm për publikun.

## **V.      PROGRESI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT SIPAS QASJEVE**


Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së tre qasjeve të strategjisë lidhur me statusin e zbatimit të objektivave për periudhën janar-dhjetor 2019, si dhe në tërësi për të gjitha masat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit<sup>2</sup>.

---

<sup>2</sup> Plani i Veprimit dhe progresi për secilin objektiv do të jetë në ankesin e këtij raporti

## Statusi i zbatimit të objektivave të Qasjes A (Parandaluese)

Janar-Dhjetor 2019		
Statusi i zbatimit të objektivave të Qasjes A (Parandaluese)	Numri i objektivave të Qasjes A	Përqindja ndaj totalit të objektivave të Qasjes A
Të realizuara	6	55%
Në proces	5	45%
Të porealizuara	0	0%
<b>Totali</b>	<b>11</b>	<b>100%</b>




*Rezulton se nga 11 objektiva të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Qasjen A (Parandaluese), janë realizuar 6 prej tyre dhe 5 janë ende në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse.*


Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Qasje është në nivelin 55% të realizuara dhe 45% në proces nga institucionet përgjegjëse.

### Statusi i zbatimit të objektivave të Qasjes B (Ndëshkuese)

Janar-Dhjetor 2019		
Statusi i zbatimit të objektivave të Qasjes B (Ndëshkuese)	Numri i objektivave të Qasjes B	Përqindja ndaj totalit të objektivave të Qasjes B
Të realizuara	2	50%
Në proces	1	25%
Të porealizuara	1	25%
<b>Totali</b>	<b>4</b>	<b>100%</b>



### Përqindja e statusit të objektivave




*Rezulton se nga 4 objektiva të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Qasjen B (Ndëshkuese), janë realizuar 2 prej tyre, 1 objektiv është ende në proces zbatimi si dhe 1 objektiv është i pa realizuar nga institucionet përgjegjëse.*

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë Qasje është në nivelin 50% të realizuara, 25 % në proces zbatimi, si dhe 25% të pa realizuara nga institucionet përgjegjëse.

### Statusi i zbatimit të objektivave të Qasjes C (Ndërgjegjësuere)

Janar-Dhjetor 2019		
Statusi i zbatimit të objektivave të Qasjes C (Ndërgjegjësuere)	Numri i objektivave të Qasjes C	Përqindja ndaj totalit të objektivave të Qasjes C
Të realizuara	3	100%
Në proces	0	0%
Të porealizuara	0	0%
<b>Totali</b>	<b>3</b>	<b>100%</b>




***Rezulton se nga 3 objektiva të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Qasjen C (Ndërgjegjësuere), rezulton se 3 objektivat janë të realizuara nga institucionet përgjegjëse.***

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë periudhë raportimi rezulton të jetë 100% të realizuara nga institucionet përgjegjëse.



### Statusi i zbatimit të objektivave të Qasjes A - B - C

Objektivat	Të realizuara	Në proces	Të porealizuara
Statusi i zbatimit të objektivave të <b>Qasjes A</b>	6	5	0
Statusi i zbatimit të objektivave të <b>Qasjes B</b>	2	1	1
Statusi i zbatimit të objektivave të <b>Qasjes C</b>	3	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>11</b>	<b>6</b>	<b>1</b>



Për periudhën janar-dhjetor 2019, në total për të tri Qasjet janë realizuar **11 objektiva**, ndërsa **6 rezultojnë** në proces, si dhe **1 objektivi** i porealizuar nga institucionet përgjegjëse.

Plani i Veprimit 2018 - 2020 përbëhet në total nga **97 masa/aktivitete**, përkatësisht 52 masa për qasjen parandaluese, 19 masa për qasjen ndëshkuese dhe 26 masa për qasjen ndërgjegjësuere.


Progresi i arritur në kuadër të përmbushjes së tre qasjeve të strategjisë lidhur me statusin e zbatimit të masave/aktiviteteve për periudhën janar-dhjetor 2019, si dhe në tërësi për të gjitha masat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, është si më poshtë:

### Statusi i zbatimit të masave të Qasjes A - B - C


Masa	Të Realizuara	Në Proces	Të Porealizuara	Jashtë periudhës së raportimit	Totali i masava sipas objektivave
<b>Viti 2019</b>	62	11	8	0	81
<b>Viti 2020</b>	0	0	0	3	3
<b>Realizuar në vitin 2018</b>	0	0	0	13	13
<b>Totali</b>	<b>62</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>16</b>	<b>97</b>

Masa	Të Realizuara	Në Proces	Të perealizuara	Jashtë periudhës së raportimit	Totali i masava sipas statusit
Qasja parandaluese <b>A</b>	33	9	2	8	52
Qasja ndëshkimore <b>B</b>	13	2	4	0	19
Qasja Ndërgjegjësuere <b>C</b>	16	0	2	8	26
<b>Totali</b>	<b>62</b>	<b>11</b>	<b>8</b>	<b>16</b>	<b>97</b>

### Statusi total i zbatimit të masave



### Përqindja ndaj totalit të masave



***Për periudhën janar-dhjetor të vitit 2019, rezulton se nga 81 masa (aktivitete) të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për të gjitha qasjet, nga institucionet përgjegjëse janë raportuar si më poshtë:***



- **62** prej tyre janë të realizuar;
- **11** janë ende në proces zbatimi;
- **8** masa (aktivitete) janë të porealizuara nga institucionet përgjegjëse.

Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për të gjitha aktivitetet e parashikuara për Qasjen A-B-C (97 masa/aktivitete), janë të realizuara **64%**, në proces **11%**, jashtë periudhës së raportimit **17%**, të porealizuara **8%** nga institucionet përgjegjëse.

Përsa i përket progresit vjetor, të analizuar vetëm mbi masat e parashikuara në PV për këtë periudhë raportimi (81 masa/aktivitete), rezulton se për Qasjen A-B-C janë të realizuara **77%**, në proces **14%**, të porealizuara **8%** nga institucionet përgjegjëse.

Sipas Strategjisë, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të Planit të Veprimit 2018 - 2020, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi masën e disbursimit financiar në bazë aktiviteti të kryer. Nga analiza për aktivitetet e raportuara rezulton se:

-  ***Financimi për vitin 2019 nga buxheti i shtetit është në shumën 235,559,561 lekë.***
-  ***Financimi për vitin 2019 nga donatorët është në shumën 59,486,183 lekë.***

## VI. MONITORIMI I PASAPORTËS SË INDIKATORËVE PËR PERIUdhËN JANAR – DHJETOR 2019

Indikatorët për Qasjen A	Institucioni përgjegjës	Targeti i Synuar për 2019	Targeti i Raportuar për 2019
A.1.a: Numri i institucioneve të cilat kanë implementuar saktë programe transparence	KMDPK	30% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	60%
A.1.b: Regjistri qëndror për ankesat dhe përgjigjet është operacional nga 2020	KMDPK	30 institucione përdorin këtë sistem për të raportuar (d.m.th të gjithë Ministrinë dhe institucionet e pavarura)	100%
A.2.a: Përqindja e elementëve të modifikuar në Planet Vjetore të Prokurimit	APP	35%	100%
A.2.b: Pjesa e kontratave të dhëna përmes procedurave të negociuara pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës	APP	Më pak se 15%	100%
A.2.c: Pjesa e kontratave të ndryshuara gjatë vitit	APP	15%	100%
A3 - Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike	AKSHI	582	100%
A.4 Numri i hetimeve të korrupsionit të ardhura nga denoncimet e qytetarëve.	Pol.Shtetit	Përmirësimi i procesit të monitorimit të brendshëm të Policisë së Shtetit me qëllim marrjen e të dhënave të ndara 5% rritje krahasuar me vitin 2018	100%
A.5.a Sistemi online për deklarimin e pasurive do të jetë funksional në vitin 2020	ILDKPKI	Përfundimi i zbatimit, vizualizimit/ funksionimit të sistemit, instalimi i bazës së të dhënave dhe ndërtimi i aplikacionit Zgjidhja e problemeve dhe rikodimi/ritestimi Testimi i integruar dhe dorëzimi Pajisja me materialet e trajnimit dhe me përdoruesit e trajnimit Pranimi përfundimtar dhe vendosja në funksionim të plotë e sistemit (live)	100%
A.5.b Zbatimi i ligjit për Sinjalizimin dhe mbrojtja e Sinjalizuesve	ILDKPKI	80%	100%
A.6.a Numri i raporteve të publikuara të auditimit nga partitë politike të certifikuara nga auditorët e jashtëm	KQZ	65%	67%
A.6.b Raporti i sanksioneve të dhëna për rastet e identifikuar në kontekstin e shkeljeve të Kodit Zgjedhor	KQZ	25%	0 <sup>3</sup>
A.6.c Financat e partive politike të audituara në përputhje me rekomandimet e BE/ACFA	KQZ	5	40%
A.7.a Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuar dhe zbatuara nga subjektet publike	MFE	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje	57% <sup>4</sup>
A.7.b Numri i rasteve që vijnë nga auditime të brendshme që raportohen për hetim financiar	MFE	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje	100%
A.7.c Numri i referimeve në prokurori si pasojë e inspektimeve financiare	MFE	Trend në rritje, krahasuar me vitin e mëparshëm - minimumi 3% rritje	40% <sup>5</sup>
A.7.d Numri i inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	MFE	35	40%
A.8 Numri i institucioneve publike që kanë kryer analiza vjetore për prirjet për korrupsion	MD/KKK	Instrumenti i hartuar për vlerësimin e rrezikut po zbatohet në 10 Ministri.	0%
A.9 Numri i ministrive që kanë zhvilluar dhe publikuar një plan integriteti në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit	MD/KKK	10 ministri kanë miratuar dhe publikuar një plan integriteti.	5% <sup>6</sup>
A.10 Statistika të konsoliduara dhe të harmonizuara për korrupsionin prodhohen dhe publikohen në mënyrë periodike.	MD	Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista më sipër): - A, B, C1, D1	100%

<sup>3</sup>Rezultati i këtij indikator nuk mund të raportohet në këtë moment pasi KQZ nuk i ka identifikuar dhe sanksionuar në mbledhje publike rastet e shkeljes së ligjit për zgjedhjet e vitit 2019. Afati përfundimtar është data 15 shkurt 2020.

<sup>4</sup> Këto të dhëna analizohen nga Raportet Vjetore të Auditimit të Brendshëm të cilat sipas përcaktimeve ligjore duhet të konsolidohen në Maj të viti pasardhës. Niveli 57% i përket raportimit të të dhënave të vitit 2018, të konsoliduara në Maj 2019. Pra ky tregues për vitin 2019 do të raportohet në maj të vitit 2020.

<sup>5</sup> Këto të dhëna janë të pjesshme pasi janë në proces vendimmarrje/hartimi raporti 5 inspektimeve të kryera gjatë vitit, ndaj nuk mund të shprehemi ende lidhur me rezultatin e tyre. Të dhënat e konsoliduara bëhen zyrtare në Mars 2020.

<sup>6</sup> Është në proces finalizimi PI të MD, si institucion lider. Shkak i vonesës është moskryerja në kohë e procedurave për kontraktimin e ekspertëve


A.11.a Raporti i bashkive që kanë hartuar plane vendore anti-korrupsion dhe plane integriteti (në përputhje me strategjinë ndër-sektoriale kundër korrupsionit	MB	Këto Udhëzime shpërndahen në mënyrë aktive nga MB në të gjitha Bashkitë, ndër të tjera përmes seancave të ndërmjetme informuese.	10%
A.11.b Numri i Bashkive që alokojnë një zë të veçantë të buxhetit për zbatimin e politikës vendore anti-korrupsion	MB	-	Matet në 2020

Indikatorët për Qasjen B	Institucioni përgjegjës	Targeti i Synuar për 2019	Targeti i Raportuar për 2019
B.1.a Numri i kallëzimeve për korrupsion (rastet dhe personat)	PP	Raste të dërguara në gjykatë: 897 Individët e akuzuar: 10730, 0.8% e rasteve 1.5% e të akuzuarve	100%
B.1.b Numri i kërkesave për sekuestrimin e pasurive në rastet e korrupsionit	PP	Të dhëna të publikuara në raporte dy-vjeçare	100%
B.1.c Vlera e parashikuar e të ardhurave nga krimi të sekuestruara në rastet e korrupsionit	AAPSK	Të dhënat e publikuara në raportet gjashtë mujore të AAPSK-së	0%
B.2.a Raporti i procedurave të regjistruara mbi korrupsionin nga referimet e administruara	PP	75%	0%
B.2.b Numri i aksesit në bazat e të dhënave shtesë për policinë dhe prokurorinë	PP Pol.Shtetit	Policia ka akses në 2 baza të dhënash shtesë, Prokuroria ka akses në 3 baza të dhënash shtesë	0%
B.3.a Numri i raporteve të rishikimit të hartuara në mënyrë periodike dhe të bëra publike nga Ministria e Drejtësisë mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare	MFE	Një raport rishikimi i publikuar dhe i dorëzuar tek politikë bërësit	0%
B.3.b Zbatimi i legjislacionit për ngritjen e një Zyre të Rikuperimit të Pasuriv	MFE	Përzgjedhja e institucionit ku do të ngrihet ZRP-ja (me vendim qeverie). Zhvillimi i <sup>7</sup> SoP-ve bazë.	0% <sup>8</sup>
B.4.a Numri i informacioneve të Policisë i shkëmbyer me vendet e treta dhe institucionet mbi-kombëtare mbikëqyrëse të zbatimit të ligjit	Pol. Shtetit	Përditësimi i procesit të brendshëm për të marrë të dhëna të detajuara të ndara/të pandara. Publikimi i të dhënave. 5% rritje krahasuar me bazën e 2018	100%
B.4.b Numri i operacioneve të përbashkëta të Policisë të nisura nga Europol ose Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik ku Shqipëria merr pjesë aktivisht	Pol. Shtetit	4	25%

<sup>7</sup> Procedurat Standarde të Funkcionimit

<sup>8</sup>Ky objektivi nuk është realizuar pasi gjatë takimeve të organizuar janë evidentuar problematika lidhur me varësinë që do të ketë ky institucion.

Indikatorët për Qasjen C	Institucioni përgjegjës	Targeti i Synuar për 2019	Targeti i Raportuar për 2019
C.1.a Krijimi i planeve vjetore të komunikimit dhe vizibilitetit të Strategjisë Kundër Korrupsionit	MD/KKK	(Procesi) Plani i Vizibilitetit dhe dhe Komunikimit për vitin 2019 finalizohet dhe publikohet në Q1 (Performanca) Buxheti specifik i alokuar për zbatimin e Planit të Vizibilitetit dhe Komunikimi	50%
C.1.b Numri i fushatave vjetore të ndërgjegjësimit për luftën kundër korrupsionit	MD/KKK	4	100%
C.2.a Numri i denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të denoncuar në platformën www.shqiperiaqeduam.al	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje	30% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	0%
C.2.b Numri i rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në www.shqiperiaqeduam.al, të cilat i raportohen Policisë së Shtetit/Prokurorisë Shqiptare	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje	30% rritje krahasuar me vitin e mëparshëm	0 <sup>9</sup>
C.3.a Hartimi i një Programi Anti-korrupsion nga AMSHC-ja	AMSHC	Hartimi dhe publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të Programit AntiKorrupsion (si një pjesë specifike e raportit vjetor të Agjencisë))	100%
C.3.b Raporti i projekteve të anti-korrupsionit të financuar nga ASCS	AMSHC	25%	80%
C.3.c Alokimi i buxhetit në mbështetje të Projekteve të Anti-korrupsionit nga OSHC-të	AMSHC	25%	70%



<sup>9</sup> Nuk kemi informacion pasi është task forca antikorrupsion dhe struktura antikorrupsion ajo që i referon.

## VII. PROBLEMATIKAT E HASURA GJATË RAPORTIMIT VJETOR

- ✚ Problematikë mbetet edhe për këtë periudhë vonesa e institucioneve për të raportuar brenda afatit të kërkuar (duke tejkaluar periudhën e raportimit), të cilat ndikojnë drejtëpërsëdrejti në kohën e hartimit të Raporteve të Monitorimit.
- ✚ Mosdërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në SNKK (nga një pjesë e institucioneve), të cilat ndikojnë në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë.
- ✚ Mosdërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në SNKK të mbuluara nga donatorët (nga një pjesë e institucioneve), të cilat ndikojnë në pasqyrimin jo real të kostove.
- ✚ Një çështje tjetër është cilësia e kontributeve që janë raportuar pjesërisht, duke mos raportuar për arritjen e indikatorëve, shpesh ato kthehen për t'u kompletuar bazuar në kërkesat dhe formatin e Planit të Veprimit.
- ✚ Gjatë fazës së monitorimit është vënë re një numër i madh pikash kontakti, të cilat kanë raportuar për aktivitete të veçanta të Planit të Veprimit, duke mos u koordinuar brenda institucionit raportues në mënyrë që të dërgohej pranë MD-së një raportim i plotë mbi të gjitha aktivitetet respektive të institucionit përgjegjës.
- ✚ Problematikë e rëndësishme është cilësia e kontributeve, të cilat janë raportuar pjesërisht, me gabime të shumta drejtshkrimore dhe hartime frazash të pakuptimta, mos kuptimi dhe mos raportimi për arritjen e indikatorëve, ku shpesh janë ri-kthyer për t'u plotësuar sipas kërkesave dhe në përputhje me formatin e Planit të Veprimit.

## VIII. SFIDAT

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- ✚ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.
- ✚ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të raportimit të parashikuara në Strategji.
- ✚ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit tek Drejtoritë e Financës, përpara momentit të raportimit pranë KKK.
- ✚ Ndërlidhja me procesin e planifikimit buxhetor vjetor dhe afatmesëm në mënyrë që të sigurohet mbulimi i nevojshëm financiar nga Buxheti i Shtetit për ato masa që parashikohen të zbatohen nëpërmjet Buxhetit të Shtetit.
- ✚ Sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi gjatë fazave të raportimit, monitorimit dhe rishikimit të Planit të Veprimit me institucionet përgjegjëse dhe grupet e interesit.
- ✚ Informimi periodik dhe rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në PV mbi rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur të Planit të Veprimit dhe raportimi mbi zbatimin e masave të PV-së.
- ✚ Adoptimi i qasjes sektoriale duhet të merret në konsideratë, edhe në kuadër të zbatimit të mbështetjes buxhetore. Ai duhet të shoqërohet me procesin paralel të ngritjes së kapaciteteve

planifikuese, zbatuese dhe monitoruese të Strategjisë. Kjo do të ndihmojë në përthithjen dhe menaxhimin e asistencës teknike që partneri kryesor BE, do ti akordojë së shpejti institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet mbështetjes buxhetore.



## ANEKS 1

### PLANI I MASAVE TË VEPRIMIT 2018-2020, NË ZBATIM TË SNKK 2015-2020

- **Qasja Parandaluese – A**

#### ***Objektivi A.1 Rritja e transparencës në veprimtarinë shtetërore dhe përmirësimi i aksesit të qytetarëve në informacion***

##### **Gjendja aktuale për këtë objektiv**

Zyra e Komisionerit është e ngarkuar për të administruar ankesa për refuzim të informacionit nga autoritetet publike dhe gjithashtu duhet të monitorojë detyrime të tjera që institucioni ka, bazuar në Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Gjatë vitit 2017 Zyra e Komisionerit ka analizuar 560 ankesa dhe ka monitoruar gjithashtu nivelin e transparencës. Autoritetet publike jo vetëm kanë detyrimin të miratojnë Programin e Transparencës por gjithashtu duhet ta përditësojnë atë. Insitucione të pavarura janë ato të cilat kanë programe më të mira transparence. Institucione qendrore si ministritë duhet të punojnë për të përmirësuar programet e tyre të transparencës. Zyra e Komisionerit me mbështetjen e Projektit STAR 2 do të punojë për të patur një program transparence të dedikuar për qeverinë vendore.

##### **Treguesit e performances/Indikatori:**

#### **A.1.a: Numri i institucioneve të cilat kanë implementuar saktë programe transparence**

##### ***Për vitin 2019, indikatori A.1.a është arritur me 60%***

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë 20% rritje ne krahasim me vitin e meparshem, 30% rritje ne krahasim me vitin e meparshem, 50% rritje ne krahasim me vitin e meparshem.

Ky indikator do të tregojë nivelin e transparencës që kanë institucionet dhe duke e matur çdo vit do të kemi mundësinë për të dhënë rekomandime se si të përmirësojmë aksesin në dokumentet publike dhe si të rrisim llogaridhënien e insitucioneve publike.

Zyra e Komisionerit dy herë në vit monitoron programet e transparencës të institucioneve dhe publikon një raport. Stafi i KMDIDP monitoron nëse institucionet kanë publikuar të gjitha tipet e informacionit të cilat janë parashikuar në nenin 7 të Ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” si buxheti, prokurimi, struktura, kuadri ligjor etj. KMDIDP gjithashtu monitoron nëse kordinatori ka përditësuar regjistrat e kërkesave dhe parashikimeve

Performanca do të vlerësohet duke matur përqindjen e rritjes së numrit total të institucioneve që kanë implementuar saktë programe transparence në lidhje me vitin e kaluar.

### **A.1.b: Regjistri qendror për ankesat dhe përgjigjet është operacional nga 2020**

#### **Për vitin 2019, indikator A.1.b është arritur me 100%**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë:

(2018) Ngritja e regjistrit qendror dhe miratimi nga Këshilli i Ministrave për ta bërë përdorimin e këtij regjistri të detyrueshëm. (2019) 30 institucione përdorin sistemin e raportimit (psh. të gjitha Ministrinë dhe institucionet e pavarura); (2020) 80 % e insitucioneve shtesë përdorin sistemin e raportimit në lidhje me të dhënat e vitit 2019.

Çdo autoritet publik ka për detyrë të mbajë dhe përditësojë një regjistër të kërkesave dhe përgjigjeve. Por për të patur një pasqyrë të plotë të kërkesave për informacion publik është i nevojshme një regjistër qendror. Kordinatorët e të drejtës së informimit do ta përditësojnë këtë regjistër duke dhënë të gjithë informacionin që është i nevojshëm.

Zyra e Komisionerit është duke ngritur një regjistër qendror për kërkesat dhe përgjigjet, për të harmonizuar mbledhjen dhe procesin e ankesave. Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar efektivitetin e punës të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike “vis-à-vis” qytetarëve dhe OJQ-ve.

Treguesi do të vlerësohet duke matur në fillim krijimin e regjistrit (**procesi**) dhe më pas përdorimin operacional të tij (**performanca**).

Zyra e Komisionerit e ka ngritur një regjistër qendror për kërkesat dhe përgjigjet, për të monitoruar në kohë reale mbledhjen dhe trajtimin e kërkesave dhe ankesave. Ky proces është i rëndësishëm për të siguruar efektivitetin e punës të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe për të rritur transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike “vis-à-vis” qytetarëve dhe OJQ-ve.

Për vitin 2019, indikator A.1.b është arritur me **100%** sepse në portalin “Pyetshtetin.al” është ngritur regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve, ky regjistër është miratuar me VKM-në nr 145, dt 13.03.2018 duke e bërë përdorimin e tij të detyrueshëm nga autoritetet publike dhe është vënë në zbatim regjistri në 27 institucione qendrore si: Kryeministria; Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Brendshme; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Kulturës; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Banka e Shqipërisë; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Agjencia e Prokurimit Publik; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore; Policia e Shtetit; Qendra Kombëtare e Biznesit dhe në njësitë e qeverisjes vendore si: Bashkia Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Tiranë dhe Shkodër. Instalimi i “regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” do të vijojë në të gjitha autoritetet publike. 162 institucione të tjera kanë ngritur regjistrin qendror të kërkesave dhe përgjigjeve.

Nr	Masa/Aktiviteti	Institucioni përgjegjës /raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
A <sup>10</sup> . 1.1	Implementimi i plotë i Programeve të transparencës dhe rritja e numrit të institucioneve qendrore që e implementojnë	KMDIDP/ ministritë e linjës	Vazhdon	Pa kosto  11,043,540 lekë 283,500 lekë <b>MM</b> <b>AZHBR</b> 300,000 lekë  <b>AKU</b> 1,300,000 lekë	Numri i programeve të transparencës të miratuar nga institucioni qendror	Rritja e transparencës  Informacioni i bërë publik është i përditësuar në formë të përmbajtjeve të evidentuara të skemave të publikimit të cilat pasqyrojnë menutë ku adresohet	Realizuar	<b>KMDIDP</b> Gjatë vitit 2019, ka vijuar monitorimi i autoriteteve publike lidhur me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji kryhet nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të tij si p.sh. numri i Autoriteteve Publike që kanë hartuar dhe/ose përditësuar programet e transparencës, numri i Autoriteteve Publike që kanë caktuar koordinatorë për të drejtën e informimit, përditësimi i regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve, shqyrtimit të ankesave, kryerjes së hetimeve administrative, zhvillimit të seancave dëgjimore si dhe dhënies së vendimeve dhe rekomandimeve. Gjatë kësaj periudhe, Zyra e Komisionerit ka përditësuar listën e Autoriteteve Publike e cila është objekt ndryshimesh të vazhdueshme për shkak të riorganizimeve strukturore <sup>11</sup> që mund

<sup>10</sup> Aktiviteti A.1.1, A.1.2, A.1.4 dhe A.1.5 aktualisht realizohet nga i njëjti staf (5 inspektor dhe 1 drejtor). Aktiviteti A.1.3 realizohet nga një specialist IT.

<sup>11</sup> Lista e autoriteteve publike është subjekt ndryshimesh të vazhdueshme si pasojë e ndryshimeve strukturore, krijimit të autoriteteve të reja apo bashkimit të atyre ekzistuese. Mund të shërbejë si shembull bashkimi i ALUIZNI-t me Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme si pasojë e të cilit u krijua Zyra e Kadastrës.

						<p>dokumenti në faqen zyrtare në internet dhe çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.</p>	<p>të pësojnë institucionet publike në mënyrë të herë pas herëshme. Si rezultat i këtij përditësimi në fund të vitit 2019, rezultojnë 417 Autoritete Publike krahasuar me 525 që rezultonin nga lista e mëparshme (në fund të dhjetorit 2018). Zyra Komisionerit pas përditësimit të listës, ka monitoruar <i>online</i> të gjitha autoritetet publike në lidhje me publikimin e programit të transparencës, koordinatorit dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Nga monitorimi rezultoi se 246 autoritete publike kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare programe transparence, 189 kanë publikuar regjistër të kërkesave dhe përgjigjeve dhe 236 kanë publikuar kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Si rezultat i këtij monitorimi, Zyra e Komisionerit përzgjedhi 30 autoritete (kryesisht ministrinë dhe institucione të pavarura) për të kryer një monitorim më specifik duke konsideruar të gjitha kategoritë e informacionit publik që duhet të jenë prezent në Programet e Transparencës.</p> <p>Problematika që u konstatuan gjatë monitorimit kryesisht ishin</p>
--	--	--	--	--	--	---	--

								<p>rishikimi/përditësimi i programit të transparencës si dhe pasqyrimi në programin e transparencës, të gjithë kategorive të informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Si rezultat i këtij monitorimi janë nxjerrë 30 rekomandime për autoritetet e pavarura dhe ministrinë. Për zgjidhjen e problematikave të adresuara, autoriteteve iu la një afat kohor 90 (nëntëdhjetë) ditor.</p> <p>Konkretisht është proceduar me rekomandime ndaj Autoriteteve Publike si: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Autoriteti i Konkurrencës, Komisioneri i Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Instituti i Statistikave, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura, Enti Rregullator i Energjisë, Avokati i Popullit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>Gjyqësor, Institucionit të Komisionerëve Publik, Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha ministrive.</p> <p><b><u>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</u></b></p> <p>Është përgatitur dhe publikuar Programi i Transparencës për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” në website e MEPJ.</p> <p>Në periudhën janar-dhjetor 2018, janë trajtuar në kohë të gjitha kërkesat për informacion adresuar MEPJ-së, si dhe janë përditësuar të gjitha rubrikat apo raportet për 2017 dhe 2018.</p> <p><b><u>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</u></b></p> <p>Po vazhdohet me zbatimin e Programit të Transparencës, sipas Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, në faqen zyrtare <a href="http://www.mbzhr.gov.al">www.mbzhr.gov.al</a>.</p> <p>Me VKM nr.435 datë 11/07/2018. procedura e konkurimit publik për të drejtën e peshkimit në ujrat e brendshme realizohet <i>on-line</i> nëpërmjet portalit e-albania.</p> <p><b><u>AZHBR</u></b></p> <p>Vijon me zbatimin e Programit të Transparencës, bazuar në Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, duke e pasqyruar atë në faqen zyrtare të saj <a href="http://www.mbzhr.gov.al">www.mbzhr.gov.al</a>.</p>
						Realizuar		
							Realizuar	

								<p>Vazhdon të bëhen publike të gjitha projektet që implementon AZHBR, fondet përkatëse për secilin projekt, baza ligjore e mbështetjes financiare nga të gjitha burimet e financimit, VKM dhe Udhëzimet përkatëse, kriteret e përfitimit dhe formularët për çdo masë mbështetëse etj.</p> <p>AZHBR ka publikuar në faqen zyrtare dhe në vende publike listat e aplikimeve të kualifikuara të skemave Kombëtare 2019, të ndarë sipas masave dhe qarqeve. Nderkohe është publikuar dhe përditësohet në mënyrë progresive edhe lista e kontratave IPARD.</p> <p><b><u>AKU</u></b></p> <p>Në vijueshmëri pasqyrimi i tarifave në faqen web dhe në ambjentet e PIK. Tarifat në faqen zyrtare <a href="http://www.aku.gov.al">www.aku.gov.al</a>, si rubrikë më vehte.</p> <p>Në faqen zyrtare janë pasqyruar edhe masat administrative për subjektet e gjetur me shkelje në fushën e sigurisë ushqimore.</p> <p>Tarifat janë pasqyruar edhe në sportelin pritës, kerkese kjo edhe nga reforma e shërbimeve.</p> <p>AKU ka përfunduar implementimin e kërkesave të reformës së shërbimeve në drejtimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vendosja e posterave të bashkëqeverisjes</li> <li>- Vendosja e posterave informues</li> </ul>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>të De-rregullimit (ADISA)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i ambienteve pritëse për qytetarët sipas kërkesave të Quick Wins;</li> <li>- Në fazën e përfundimit të kartelave informuese sipas standardeve të ADISA</li> </ul> <p>Vijon publikimi në faqen e AKU-së subjektet që konstatohen me shkelje dhe cënojnë sigurinë ushqimore.</p> <p><b><u>Ministria e Mbrojtjes</u></b> Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat e saj vartëse kanë implementuar plotësisht Programet e Transparencës me gjithë informacionet e kërkuara nga ligji.</p> <p><b><u>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:</u></b> Gjatë periudhës së raportimit, Programi i Transparencës është përditësuar dhe ka reflektuar ndryshimet përkatëse, si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore të institucionit. Përditësimi i informacioneve në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është një proces i vazhdueshëm, që zbatohet pa probleme. <a href="http://infrastruktura.gov.al/">http://infrastruktura.gov.al/</a></p> <p><b><u>MSHMS</u></b> Programi i transparencës është vazhdimisht i përditësuar çdo 3 muaj sipas përcaktimeve të Ligjit 119/2014</p>
								Realizuar
								Realizuar
								Realizuar



								<p>“Për të drejten e informimit”. Ky program është i implementuar në MSHMS që prej vitit 2015 dhe menaxhohet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit në MSHMS.</p> <p><b>ISHSH:</b> Për periudhën <b>janar - dhjetor 2019</b>, në ISHSH kanë ardhur <b>7</b> kërkesa për informacion në zbatim të Ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, për të cilat institucioni ka dhënë përgjigje brenda afateve ligjore.</p> <p><b>FSDKSH:</b> Është përditësuar në faqen zyrtare të FSDKSH, informacioni në përputhje me programin e transparencës së miratuar nga Fondi.</p> <p><b>SHSSH</b> Bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", SHSSH ka miratuar Programin e Transparencës Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së SHSSH-së në qendër dhe strukturave të saj në bazë, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare <a href="http://www.sherbimisocial.gov.al">www.sherbimisocial.gov.al</a> si dhe në mjediset e pritjes së publikut në SHSSH. Programi i transparencës është i pasqyruar në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike të informacionit sipas LDI-së si dhe përmes strukturës përkatëse e cila</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>prodhon ose administron dokumentin e emertuar për pasqyrim publik.</p> <p><b>ISHP:</b> Programi është implementuar dhe i pasqyruar në faqen e ISHP.</p> <p><b><u>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit:</u></b> Implementimi i Programit të Transparencës në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Hartimi i Programit të Transparencës për: Agjensinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura <a href="http://akzm.gov.al/akzm/programi-i-transparences">http://akzm.gov.al/akzm/programi-i-transparences</a> Agjensia Kombëtare e Bregdetit <a href="http://www.bregdeti.gov.al/index.php/en/rreth-nesh/transparenca">http://www.bregdeti.gov.al/index.php/en/rreth-nesh/transparenca</a>; Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve <a href="http://www.insq.gov.al/programi-i-transparences-iq/">http://www.insq.gov.al/programi-i-transparences-iq/</a></p> <p><b><u>Ministria e Kulturës</u></b> Programi i transparencës është publikuar në faqen zyrtare <a href="https://kultura.gov.al/programi-i-transparences-2/">https://kultura.gov.al/programi-i-transparences-2/</a> Gjithashtu programet e transparencës janë publikuar edhe nga disa nga institucionet e varësisë.</p> <p><b><u>MFE</u></b> Është vënë në zbatim Programi i Transparencës, sipas Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, në faqen</p>
						Realizuar	
						Realizuar	
						Realizuar	

								<p>zyrtare <a href="http://www.financa.gov.al">www.financa.gov.al</a>, duke mbajtur parasysh interesin në të mirë të publikut për tu pajisur pa kërkesë në shumë kategori në informacione zyrtare. Ky program është vlerësuar si një mënyrë konkrete e punës së MFE, e cila ndërton dhe rrit në mënyrë të vazhdueshme transparencën në veprimtarinë e saj institucionale nëpërmjet përditësimit të vazhdueshëm dhe pasurimit të Programit.</p> <p><b>MASR</b></p> <p>Kjo masë është e realizuar. Është vënë në zbatim Programi i Transparencës, sipas Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, në faqen zyrtare <a href="http://arsimi.gov.al/programi-i-transparences/">http://arsimi.gov.al/programi-i-transparences/</a>  <a href="http://www.arsimi.gov.al/regjistri-dhe-formati-i-kerkesave-per-informacion/">http://www.arsimi.gov.al/regjistri-dhe-formati-i-kerkesave-per-informacion/</a>  Informacioni i bërë publik në website është i përditësuar.</p>
A .1 .2	Implementimi i plotë i programeve të transparencës dhe rritja e numrit të institucioneve nga qeverisja vendore që e implementojnë.	KMDIDP/ bashkitë	Vazhdon	Kostot mbulohen nga Projekti STAR 2	Numri i programeve të transparencës të miratuar nga bashkitë	Rritja e transparencës	Realizuar	<p><b>KMDIDP</b></p> <p>Bazuar në Urdhrin nr. 211 datë 20.09.2018, “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të zbatonin brenda datës 01.01.2019 programin institucional të transparencës.</p>

								<p>Nga komunikimet zyrtare të Zyrës së Komisionerit me njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe nga monitorimi i kryer në faqet zyrtare rezultoi se deri në muajin mars të këtij viti, vetëm 5 bashki kishin vënë në zbatim programin e ri të transparencës në përputhje me modelin e miratuar.</p> <p>Nisur nga kjo situatë, Komisioneri, me shkresën nr. 574 Prot., datë 09.04.2019, iu drejtua njërive të vetëqeverisjes vendore me kërkesën për të përmbushur sa më parë detyrimin.</p> <p>Duke konsideruar rëndësinë e veçantë të transparencës dhe llogaridhënies së bashkive ndaj qytetarëve, në kuadër të 28 Shtatorit, “Ditës ndërkombëtare të së drejtë për informim”, Zyra e Komisionerit dhe STAR II kanë bashkëpunuar gjatë muajit shtator 2019, për kryerjen e një monitorimi mbi zbatueshmërinë e programit model të transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJQV).</p> <p>Nga monitorimi <i>on-line</i> i faqeve zyrtare rezultoi se 44 NJQV kishin vënë në zbatim Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.</p> <p>Pjesa tjetër e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJQV) nuk kanë të publikuar programin në përputhje me programin model të transparencës për Njësitë e</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>Vetëqeverisjes Vendore (<i>nuk aksesohen ose informacionet nuk janë të linkuara</i>).</p> <p>Me anë të shkresës nr. 1552 Prot., datë 04.10.2019 është dërguar rezultati i monitorimit për secilën Njësi të Vetëqeverisjes Vendore (NJQV) duke rekomanduar marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve, që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Në muajin dhjetor Zyra e Komisionerit monitoroi përsëri të 61 bashkitë. Nga monitorimi rezultoi se 56 nga 61 bashki kanë vënë në zbatim Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.</p> <p>Në përfundim të monitorimit, me datë 23.12.2019, Zyra e Komisionerit ftoi në seancë dëgjimore 5 bashkitë të cilat nuk kanë vënë në zbatim Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.</p> <p>Në seancë, u paraqit vetëm përfaqësuesi i një bashkie, i cili njoftoi se ka miratuar/publikuar Programin e Transparencës. Ndërkohë 2 bashki të tjera nëpërmjet <i>email-eve</i> njoftuan se kanë probleme me websitet zyrtare dhe po punohet për vënien në funksionim të tyre.</p>
A .1	Ngritja e regjistrit qendror të	KMDIDP/ të gjitha		Për fazën e parë të	Regjistri qendror i	Rritja e transparencës	Realizuar	<p><b><u>KMDIDP</u></b> Me anë të VKM nr 145, dt 13.03.2018</p>

.3	kërkesave dhe përgjigjeve	insitucionet		<p>implementimit kostot mbulohen nga Fondacioni Shoqëria e Hapur, për fazën e dytë kostot janë parashikuar në mbështetjen buxhetore të RAP.</p> <hr/> <p><b>1,840,589</b> PBA 210,000 lekë Donator Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë + <b>345,600</b> lekë instalim i 4 licencave të reja nga ana e buxhetit institucional të këtyre institucioneve: AMA; ERRE; ERRU; INSTAT <b>234,850</b> lekë</p>	kërkesave dhe përgjigjeve është operacionale dhe miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për përdorim të detyrues hëm	ës		<p>“Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit” u miratua krijimi i regjistrit qëndror të kërkesave dhe përgjigjeve. Në kushtet e mungesës së fondeve për shtrirjen më tej të instalimit të regjistrit qëndror të kërkesave dhe përgjigjeve, Zyra e Komisionerit, nëpërmjet shkresës nr. 529 Prot., datë 01.04.2019, ka kërkuar nga 15 institucione të pavarura të marrin masa për instalimin e sistemit të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve brenda vitit 2019. Gjithashtu, në datën 19 korrik 2019, Zyra e Komisionerit ftoi koordinatorët e të drejtës për informim të autoriteteve të pavarura si më sipër në një takim me temë: “Instalimi i regjistri elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve “pyetshtetin.al”.</p> <p>Në vijim, 4 Autoritete Publike si AM A, ERRE, ERR, INSTAT njoftuan Zyrën e Komisionerit për instalimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve duke bërë që ky regjistër të jetë aktiv tashmë në 31 autoritete publike. Gjithashtu, me shkresën nr. 1808 Prot., datë 12.11.2019, Zyra e Komisionerit, ka kërkuar nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të marrin masa për instalimin e sistemit të regjistrit</p>
----	---------------------------	--------------	--	---	--	----	--	--

				<b>MM</b> Donatorë 50,000 lekë  <b>Buxheti i Shtetit</b> 546,000 lekë <b>AZHBR</b> 150,000 lekë <b>AKU</b> 396,000 lekë			<p>elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve brenda 3 (tre) mujorit të parë të vitit 2020.</p> <p>Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019 numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet sistemit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve (nga 31 autoritetet publike ku regjistri është instaluar tashmë) është 516. Për të njëjtën periudhë numri i ankesave drejtuar Zyrës së Komisionerit nëpërmjet regjistrit elektronik është 147 në total.</p> <p><b><u>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</u></b></p> <p>Është emëruar koordinatori për informim, të dhënat janë bërë të aksesueshme në faqen Web të MEPJ</p> <p>Është krijuar regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe është bërë publikimi i tij. Janë trajtuar në kohë të gjitha kërkesat për informacion. Janë përmirësuar rubrika që i shërbejnë rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.</p> <p><b><u>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</u></b></p> <p>Po vazhdohet me administrimin dhe përditësimin e faqes zyrtare <a href="http://www.mbzhr.gov.al">www.mbzhr.gov.al</a>. Është instaluar regjistri qëndror i kërkesave dhe përgjigjeve, me akses për të gjitha palët e interesuara.</p>
						Realizuar	
						Realizuar	

							<p>Për periudhën Janar-Dhjetor 2019, ka patur 15 kërkesa për informim, të cilave iu është dhënë zgjidhje nga MBZHR.</p> <p>Për rastet e denoncuar në platformën e bashkëqeverisjes ato raportohen për MBZHR direkt nga Koordinatori i Agjencisë për dialog dhe bashkëqeverisje në Kryeministri. Denoncime për procedim penal për periudhën raportuese nuk ka patur.</p> <p><b><u>AZHBR</u></b></p> <p>AZHBR ka hartuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve dhe e përditëson atë periodikisht, në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”. Të gjitha e-mailet që vijnë në e-mailin zyrtar të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural <a href="mailto:info@azhbr.gov.al">info@azhbr.gov.al</a> delegohen sipas drejtorive përkatëse që u drejtohet kërkesa për informacion nga të interesuarit. Tematikat (Topics):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— Kërkesa për informacion mbi programet nga aplikant potencial.</li> <li>— Kërkesa për informacion mbi procesin e shqyrtimit të dosjeve nga aplikantë.</li> <li>— Kërkesa për sqarim dokumentacioni shtesë nga aplikantët.</li> <li>— Kërkesa për informacion, datat e aplikimeve, afatet ligjore, etj.</li> <li>— Kërkesa për sqarim në lidhje me</li> </ul>
--	--	--	--	--	--	--	---



							<p>skualifikimin e aplikantëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kërkesa për informacion në lidhje me institucionet bashkëpunuese me AZHBR.</li> <li>- Aplikues që sjellin dokumentacione në lidhje me thirrjen për punësim nga AZHBR.</li> <li>- Kërkesa nga Studentët për informacion mbi veprimtarinë e AZHBR.</li> <li>- Ankesa dhe pakënaqësi në lidhje me përzgjedhjen ose skualifikimet e aplikantëve.</li> <li>- E-mail nga kolegë dhe administrata e brendëshme AZHBR.</li> <li>- E-mail të tjera.</li> </ul> <p><u>Periudha 2019 Nr. E-mail</u>  Janar - Dhjetor 2019 jane 449 e-maile të regjistruara në adresën. <a href="mailto:info@azhbr.gov.al">info@azhbr.gov.al</a>, të cilat kanë marrë përgjigje. Tematika: kërkesë për informacion mbi procedurat për aplikime në programet mbështetëse IPARD II, Skema Kombëtare, si dhe për statusin e aplikimeve.  Gjithashtu, në vitin 2019 në total janë depozituar në rrugë protokollare 197 kërkesa të ndryshme, si dhe 72 ankesa procedurale nga subjekte të ndryshme te cilat kanë marrë përgjigje zyrtare sipas procedurave ligjore.</p> <p><b><u>AKU</u></b>  Ka hartuar regjistër për të gjitha</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>kërkesat duke përfshire edhe ato që vijnë nga adresa elektronike. Regjistri është i publikuar në faqen zyrtare të AKU-së.</p> <p><b><u>Ministria e Mbrojtjes</u></b> M M dhe institucionet e vartësisë kanë hapur regjistrin qendror të kërkesave dhe përgjigjeve, të cilin e kemi publikuar në faqen zyrtare të MM, në rubrikën “Transparenca”.</p> <p><b><u>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</u></b> MIE ka regjistrin institucional të kërkesave dhe përgjigjeve. Ky regjistër gjendet edhe në faqen zyrtare të ministrisë. <a href="http://infrastruktura.gov.al/programi-i-transparences-6/">http://infrastruktura.gov.al/programi-i-transparences-6/</a></p> <p>Për periudhën <b><u>Janar – Dhjetor 2019</u></b> janë trajtuar në <b><u>total 166 kërkesa</u></b> për informacion.</p> <p>Aplikacioni për regjistrin qendror të kërkesave dhe përgjigjeve në portalin PYET <i>SHTETIN</i> është instaluar pranë MIE dhe po funksionon normalisht që nga muaji Maj 2018. Numri i kërkesave në portalin Pyet Shtetin.al për MIE ka qenë përgjithësisht 31 kërkesa nga muaji Janar- Dhjetor 2019.</p> <p>Rrugët kryesore të kërkesave për informacion vijojnë të jenë ato përmes protokollit dhe në adresën elektronike të Koordinatorit për të Drejtën e</p>
						Realizuar	
						Realizuar	

								<p>Realizuar</p> <p>Informimit, ose adresën zyrtare të MIE-it</p> <p><b>ISHSH:</b> Programi i transparencës përditësohet çdo 3 muaj sipas përcaktimeve të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky program është implementuar në ISHSH që prej vitit 2015 dhe manaxhohet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit në ISHSH.</p> <p>Ankesat dërgohen në adresën e koordinatorit <a href="mailto:anila.dedei@ins-shendetesor.gov.al">anila.dedei@ins-shendetesor.gov.al</a> e cila është e publikuar.</p> <p>Ka filluar puna për ngritjen e faqes së ISHSH.</p> <p>FSDKSH ka krijuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve sipas ligjit Nr. 119/2014.</p> <p>Pranë Zyrës së marrëdhënieve me publikun, përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019, janë trajtuar kërkesa dhe ankesa në total 2,222, tipologji të ndryshme.</p> <p><b>ISHP.</b> Është ngritur regjistri i kërkesave dhe ankesave i cili figuron edhe në faqen e ISHP.</p> <p>Për periudhën janar-dhjetor 2019 ka patur 11 (njëmbëdhjetë) kërkesa për informacion, të cilave i është kthyer</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>pergjigje brenda afatit.</p> <p><b><u>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</u></b> Të gjitha Institucionet e Turizmit dhe Mjedisit me përjashtim të Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura kanë regjistrin e kërkesave që përmban kohën hyrëse dhe statusin e kërkesës. Deri në Dhjetor 2019 numri i kërkesave të ardhura në këto institucione është 113 vetëm 3 prej tyre janë në process.</p> <p>Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura është në proces krijimi të këtij regjistri.</p> <p><b><u>Ministria e Kulturës</u></b>  Çdo institucion apo individ mund të dërgojë ankesat pranë Ministrisë së Kulturës në e-mail, <a href="mailto:info@kultura.gov.al">info@kultura.gov.al</a>  Njëkohësisht ankesat vijnë nga portali Shqipëria.al.  Për shkak të numrit të vogël të ankesave, ato delegohen direkt te drejtoritë përkatëse ku edhe marrin zgjidhje.</p> <p><b><u>MFE</u></b>  Koordinatori për të drejtën e informimit është përgjegjës për bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës së informimit. Është krijuar ky regjistër i kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe është bërë publikimi i tij, në zbatim të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” nëlinkun:</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p><a href="http://financa.gov.al/programi-i-transparences-4/">http://financa.gov.al/programi-i-transparences-4/</a> dhe është lehtësisht i aksesueshëm</p> <p>Ky regjistër ka regjistruar 101 kërkesa gjithsej për vitin 2019.</p> <p><b>MASR</b> Sistemi elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit është i ngritur në MASR dhe i ofron mundësinë çdo qytetari të mund të dërgojë në mënyrë të thjeshtë elektronike kërkesën/ankesën. Kjo masë është e realizuar. Përditësimi kryhet vazhdimisht. Për periudhën janar-dhjetor 2019 numri i kërkesave është 89.</p>
A 1. 4	Monitorimi i implementimit të ligjit	KMDIDP		Buxheti i shtetit / Pa kosto	Raport vjetor mbi zbatimin e ligjit, duke përfshirë analizën e ankesave të vlefshme të analizuar nga	Përmirësimi i aksesit në informacion	Realizuar	<p><b>KMDIDP</b></p> <p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, Zyra e Komisionerit ka vijuar me monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit duke shqyrtuar jo vetëm ankesat e depozituara por duke kryer gjithashtu inspektime, seanca dëgjimore si dhe duke marrë vendime urdhërimi apo sanksionimi sipas ligjit për rastet kur është konstatuar refuzim i padrejtë i vënies në dispozicion të informacionit. Janë shqyrtuar në total 786 ankesa të depozituara nga qytetarë por edhe nga organizata të shoqërisë civile. Nga këto ankesa 553 prej tyre</p>

					Zyra e Komisionerit			<p>janë zgjidhur me ndërmjetësim, 140 janë konstatuar si jashtë objektit, 34 jashtë afatit dhe 16 të paplota. Gjithashtu janë refuzuar 21 ankesa bazuar në kufizimet e së drejtës për informim në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Janë marrë 18 vendime, nga këto 11 Vendime Urdhërimi, 5 Vendime me Gjobë dhe 2 Vendime Rrëzimi të ankesës.</p> <p>Janë zhvilluar 28 seanca dëgjimore dhe janë kryer 85 inspektive.</p>
A 1. 5	Zhvillimi dhe implementimi i mjeteve për monitorimin dhe implementimin e Ligjit 119/2014	KMDIDP/ të gjitha institucionet		<p>Buxheti i shtetit / Pa kosto</p> <hr/> <p><b>312,520 lekë</b></p> <p><b>MM</b></p> <p><b>MBZHR</b></p> <p>40.000 lekë</p> <p><b>AZHBR</b></p> <p>100,000 lekë</p>	Numri i institucioneve që përdorin mjete vetë-vlerësuese	Përmirësimi i aksesit në informacion	Realizuar	<p><b><u>KMDIDP</u></b></p> <p>Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, kanë përfunduar implementimin e instrumentit të vetvlerësimit të transparencës. Është realizuar workshopi me temë “Sfidat dhe e ardhmja e “Regjistrat Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit” me Autoritetet Publike të cilat kanë instaluar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Qëllimi i këtij workshop-i ishte prezantimi i</p>

				AKU 383,500 lekë			<p>ecurisë së këtij instrumenti gjatë vitit të parë të zbatimit, problematikat e hasura deri më sot në përdorimin e tij, si dhe sfidat e shtrirjes të të gjitha Autoritetet Publike shqiptare. Gjatë workshop u realizua pyetësi i vetëvlerësimit të përdorimit të regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve. 27 autoritete përdorën mjetin e vetëvlerësimit.</p> <p><b><u>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</u></b>  Është emëruar koordinatori për informim, të dhënat janë bërë të aksesueshme në faqen Eëb të MEPJ. Është krijuar regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe është bërë publikimi i tij. Janë përmisuar rubrikat që i shërbejnë rritjes së transparencës dhe llogaridhënies.</p> <p><b><u>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</u></b>  Me qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion si dhe me synim nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoritetit publik, nëpërmjet caktimit të një nëpunësi si Koordinator për të drejtën e informimit, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për tu njohur me informacionin dhe dokumentat publike, duke bashkërenduar punën për plotësimin e kërkesave brenda afateve ligjore, dërgon kërkesat te një autoritet</p>
--	--	--	--	---------------------	--	--	--

								<p>tjetër publik; krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve; përgatit, publikon dhe përditëson Programin e Transparancës së ministrisë ku përcakton kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyrën e bërjes publike etj; raporton pranë Komisionierit për të Drejtën e Informimit lidhur me kërkesat, ankesat etj.</p> <p><b><u>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</u></b></p> <p>Po vazhdon evidentimin e kërkesa/ankesave, e konkretisht për periudhën raportuese janë evidentuar 15 ankesa/kërkesa të qytetarëve.</p> <p><b><u>AZHBR</u></b></p> <p>Nëpërmjet Koordinatorit për të drejtën e Informimit, ka bashkërenduar punën për plotësimin e kërkesa/ankesave brenda afateve dhe mënyrës së përcaktuar nga ligji, në funksion të monitorimit dhe zbatimit të Ligjit “Për të drejtën e Informimit”,.</p> <p>Çdo kërkesë, ankesë e palëve të interesuara, fermerë, subjekte, individë të ndryshëm, etj protokollohet në AZHBR sipas rregullave të protokollit. Sipas problematikës që kërkohet kërkesa/ankesa delegohet në drejtoritë/sectorët përkatës të cilët brenda afateve ligjore të përcaktuara në ligjin 119/2014, mbi të drejtën e</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

Realizuar



								<p>informimit e sqarojnë/informojnë palët e interesuara.</p> <p><b><u>AKU</u></b>  AKU ka regjistër për të gjitha kërkesat duke përfshirë edhe ato që vijnë nga adresa elektronike.</p> <p><b>Për periudhën Janar – Dhjetor 2019</b> kanë ardhur gjithsej <b>286 ankesa</b> nëpërmjet kanaleve të komunikimit si më poshtë;</p> <p><b>Nga e-mail zyrtar <a href="mailto:info@aku.gov.al">info@aku.gov.al</a></b> → 175 ankesa</p> <p><b>Rrjeti social Facebook</b> → 79 ankesa</p> <p><b>Numri i gjelbër dhe telefoni i zyrës</b> → 30 ankesa</p> <p><b>Aplikacioni online “Inspektori Digital”</b> → 2 ankesa</p> <p>Regjistri është i publikuar në faqen zyrtare. Janë informuar sipas rasteve të gjitha subjektet e interesuara.interestuara.</p> <p><b><u>Ministria e Mbrojtjes</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Janë caktuar koordinatorët për të Drejtën e Informimit në MM dhe strukturat vartëse;</li> <li>- Është zhvilluar një trajnim në MM me koordinatorët;</li> <li>- Vijon implementimi dhe zbatimi i ligjit, duke respektuar afatet në kthimin e përgjigjeve.</li> </ul> <p><b>ISHSH:</b> Programi i transparencës përditësohet çdo 3 muaj sipas përcaktimeve të Ligjit 119/2014 “Për të</p>
								Realizuar

								<p>drejtën e informimit”. Ky program është implementuar në ISHSH që prej vitit 2015 dhe manaxhohet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit në ISHSH.</p> <p>Ankesat dërgohen në adresën e koordinatorit <a href="mailto:anila.dedei@ins-shendetesor.gov.al">anila.dedei@ins-shendetesor.gov.al</a> e cila është e publikuar.</p> <p>Ka filluar puna për ngritjen e faqes së ISHSH.</p> <p><b>SHSSH:</b> ka caktuar sipas ligjit Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, duke vendosur në shërbim të qytetarëve numrat përkatës të telefonit, adresën e-mail: <a href="mailto:info@sherbimisocial.gov.al">info@sherbimisocial.gov.al</a>, dhe rubrikën Inbox në llogarinë e SHSSH në facebook për kthim përgjigje, apo Wall për publikime periodike të aktivitetit të SHSSH.</p> <p>Çdo informacion i pasqyruar në programin e transparencës, është i aksesueshëm online. Në mungesë të aksesit online, informacioni bëhet i disponueshëm nëpërmjet kërkesave sipas mënyrave të përcaktuara në Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, të cilave u jepet përgjigje brenda afateve ligjorë.</p> <p><b>ISHP:</b> Implementimi i programit të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>transparencës sipas Ligjit 119/2014 është aplikuar.</p> <p><b><u>Ministria e Kulturës</u></b>  Ministria e Kulturës monitoron periodikisht zbatimin e ligjit 119/2014 nga strukturat e saj, ngarkuar për zbatim të ligjit.  Referuar Urdhrit të Ministrit të Kulturës Nr. 155 Prot, datë 6.03.2018, Ministria ka caktuar Koordinator për të Drejtën e Informimit për Ministrinë e Kulturës.  Për periudhën Janar-Dhjetor 2019 janë trajtuar 29 kërkesa për informacion dhe janë administruar 4 ankesa, 2 prej të cilave janë në proces zgjidhjeje dhe 2 të tjerat janë zgjidhur brenda afateve të lëna nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit.  Portali për regjistrin e kërkesave është <a href="http://www.pyetshtetin.al">www.pyetshtetin.al</a></p> <p><b><u>MFE</u></b>  MFE ka detyrimin ligjor për të vënë në zbatim një program të plotë transparence i cili është i pasur me informacion dhe lehtësisht i aksesueshëm.  Secila drejtori brenda institucionit monitoron sipas fushës së saj të përgjegjësisë informacionet e publikuara në faqen e web-it si dhe angazhohet për përditësimin e tij në mënyrë periodike.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p><b><u>MASR</u></b></p> <p>Koordinatori për të drejtën e informimit është përgjegjës për bashkërendimin e punës për garantimin e të drejtës së informimit. Është krijuar regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe është bërë publikimi i tij, si dhe është publikuar programi i transparencës në zbatim të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”. Linku: <a href="http://arsimi.gov.al/regjistri-dhe-formati-i-kerkesave-per-informacion/">http://arsimi.gov.al/regjistri-dhe-formati-i-kerkesave-per-informacion/</a></p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

***Objektivi A.2 Rritja e transparencës në planifikimin, detajimin, menaxhimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore***

**Gjendja aktuale për këtë objektiv**

Indikatori i mëposhtëm referon te funksionalitetet e prezantuara së fundmi në sistemin e prokurimit publik, përkatësisht dorëzimi elektronik i regjistrave të parashikimit të prokurimit dhe realizimit.

Për këtë arsye nuk ka informacion bazë përderisa deri tani nuk është bërë asnjë matje lidhur me modifikimet e regjistrit.

**Treguesit e performances/Indikatori:**

**A.2.a: Përqindja e elementëve të modifikuar në Planet Vjetore të Prokurimit**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 50%, 35% dhe 20% respektivisht.

**Indikatori A.2.a, është realizuar në masën 100%.**

Planet e Prokurimit të përgatitura nga autoritetet kontraktuese përbëhen nga disa elementë. % e elementëve të modifikuar përgjatë vitit tregon saktësinë e autoriteteve kontraktuese në planifikimin e prokurimit. Në këtë kuptim, planifikimi më i mirë është i barabartë me modifikimet më të vogla.

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin ndërmjet numrit total të elementëve të modifikuar, mbi numrin total të elementëve të publikuar në planet vjetore të prokurimit. Treguesi do të matet nga formula më poshtë.

$$\% \text{ e elementëve të modifikuar} = \frac{\text{Numri total i elementëve të modifikuar}}{\text{Numri total i elementëve të publikuar në planin vjetor}} \times 100$$

#### **A.2.b: Pjesa e kontratave të dhëna përmes procedurave të negociuara pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: nën 20 %, 15 % dhe 10 % respektivisht.

##### **Indikatori A.2.b, është realizuar në masën 100%.**

APP ka marrë tashmë disa masa drejt përmirësimit të situatës dhe zvogëlimit të numrit të procedurave të tilla të cilat priten të tregojnë rezultatin e tyre në fund të 2018.

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin e numrit total të procedurave të negociuara pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës, mbi numrin total të procedurave (procedurat e negociuara + elektronike pa publikim paraprak). Treguesi do të matet nga formula më poshtë.

$$\% \text{ e procd te negociuara pa pub parap} = \frac{\text{Nr total. i procd pa pub paraprak te njoftimit te kontrates}}{\text{Nr total. i procd te dhena (procd elektronike te negociuara pa pub parap)}} \times 100$$

#### **A.2.c: Pjesa e kontratave të ndryshuara gjatë vitit**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 20 %, 15 % dhe 10 % respektivisht.

##### **Indikatori A.2.c, është realizuar në masën 100%**

Numri i lartë i kontratave të ndryshuara gjatë vitit, është një tregues i qartë i mangësive të autoritetit kontraktues në planifikimin e procedurës dhe përgatitjen e specifikimeve teknike si dhe në implementimin e kontratës.

Reduktimi në shpërndarjen e kontratave të ndryshuara gjatë vitit paraqet një shenjë të qartë të rritjes së transparencës në planifikimin, përpunimin, menaxhimin dhe kontrollin e buxheteve.

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin e numrit total të kontratave të ndryshuara, mbi numrin total të kontratave.

Treguesi do të matet nga formula e mëposhtme:

$$\% \text{ e kontratave të ndryshuara} = \frac{\text{Nr total i kontratave të ndryshuara}}{\text{Nr total i kontratave}} \times 100$$

Nr	Masa/aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën	Përshkrimi i arritjeve për periudhën
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019			janar-dhjetor 2019	janar-dhjetor 2019
A.2.1	Monitorimi i përgatitjes së regjistrit të parashikimeve dhe regjistrit të realizimeve për prokurimin publik në sistemin elektronik të prokurimit.	APP	Dhjetor	Buxheti i Shtetit <hr/> 8,150,400 lekë	% e elementëve të modifikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve vjetore	Përmirësimi i planifikimit të prokurimit	Realizuar 100%	<b><u>Agjencia e Prokurimit Publik</u></b> Përqindja e elementeve të ndryshuar në regjistrin e parashikimeve për periudhën janar-dhjetor 2019 është <b>15%</b>
A.2.2	Prodhimi i një raporti të brendshëm mujor i monitorimi të	APP	Dhjetor	Buxheti i Shtetit <hr/> 11,361,120	Raportet mujore  % e procedurav	Rritja e transparencës	Realizuar 100%	<b><u>Agjencia e Prokurimit Publik</u></b> Përqindja e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj totalit të procedurave të fituara në periudhën janar-dhjetor

	procedurave të negociuara pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës dhe përcjellja e feedbacks / paralajmërime për autoritetet kontraktuese			lekë	e të negociuara të kryera përkundër nr total të procedurav e të dhëna. (elektronik + të negociuara pa publikim paraprak)			2019, është <b>3.2%</b> . Për indikatorin A.2.b. për vitin 2019 rezulton se ky objektivi është realizuar plotësisht.
A .2 .3	Prodhimi i një raportimi gjashtë-mujor për monitorimin e implementimin e kontratës dhe ndryshimeve të saj dhe dorëzimi i përgjigjeve/reagimeve/paralajmërimeve tek autoritetet publike	MFE/APP/CPA	Qershor	Buxheti i Shtetit <hr/> 9,173,760 lekë	Raportet gjashtë-mujore  Paraqitja e përgjigjeve/reagimeve/paralajmërimeve  Nr. mesatar i ndryshimeve për kontratë	Përmirësimi i implementimit të kontratës	Realizuar  100%	<b><u>Agjencia e Prokurimit Publik</u></b>  Përqindja e ndryshimeve të kontratave nga të dhënat e administruara për periudhën Janar-Dhjetor është <b>1.6%</b> .  Ky objektivi është realizuar plotësisht.

***Objektivi A.3 Fuqizimi i infrastrukturës elektronike të institucioneve publike***

**Gjendja aktuale për këtë objektivi**

Numri i shërbimeve elektronike të niveleve 3 dhe 4 të autenticitetit bazohet në 4 fazat e UN (Kombeve të Bashkuara) të zhvillimit të shërbimeve online sipas përkufizimeve të mëposhtme:

**Faza 3:** ëbsite-t e shërbimeve transaksionale qeveritare janë angazhuar në një komunikim dy palësh me qytetarët e tyre, duke përfshirë kërkesat dhe ofertat e dhëna mbi politikën qeveritare, programet, rregullat, etj. Për të realizuar me sukses këtë shkëmbim kërkohen disa forma të autenticitetit elektronik të identitetit të qytetarëve. Ëëbsitet qeveritare zhvillojnë transaksionet jo-financiare, Psh. të plotësosh taksat online ose të aplikosh për certifikata, licensa dhe leje. Ata gjithashtu merren me transaksione financiare, Psh ku paratë janë të transferuara në një rrjet të sigurt.

**Faza 4:** Shërbimet e lidhura të ëbsite-ve qeveritare kanë ndryshuar mënyrën sesi qeveritë komunikojnë me qytetarët e tyre. Ata janë proaktiv në kërkimin e informacionit dhe opinioneve nga qytetarët që përdorin ëeb 2.0 dhe mjete të tjera interaktive. Shërbimet elektronike dhe zgjidhjet elektronike kalojnë përmes departamenteve dhe ministrive në mënyrë konstante, informacioni, të dhënat dhe njohuritë janë transferuar nga agjensitë qeveritare përmes aplikimeve të integruara. Qeveritë kanë kaluar nga një qeveri-në krye (qëndrore) në një qasje me qytetarin në qëndër ku shërbimet elektronike janë përqëndruar tek qytetarët midis ngjarjeve të ciklit jetësor dhe grupeve të segmentuara për të siguruar shërbime të përshtatshme. Qeveritë krijojnë një mjedis që fuqizon qytetarët për të qenë më të përfshirë në aktivitetet qeveritare dhe për të pasur një zë në marrjen e vendimeve.

Vlera bazë për vitet : 2017-të është 527 shërbimeve elektronike në dispozicion dhe plotësisht funksionale, duke monitoruar raportin e disponueshëm nga portali elektronik i Shqipërisë.

#### **Treguesit e performances/ Indikatori:**

#### **A3 - Numri i shërbimeve elektronike funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike**

##### **Objektivi A3, i arritur me 100% pasi në total janë 601 shërbime.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë:

Për vitin 2018, numri i shërbimeve elektronike të nivelit 3 & 4 të autenticitetit do të jetë 562, rritur me 35 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2017.

Për vitin 2019, numri i shërbimeve elektronike të nivelit 3 & 4 të autenticitetit do të jetë 582, rritur me 20 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2018.

Për vitin 2020, numri i shërbimeve elektronike të nivelit 3 & 4 të autenticitetit do të jetë 602, rritur më 20 shërbime elektronike krahasuar me vitin 2019.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit total të shërbimeve elektronike të aksesueshme, në dispozicion për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike.



Nr	Masa/aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/ Raportues	Kohëzgjatja/ Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
A .3 .1	Rritja dhe përmirësimi i raportimeve në shërbimet elektronike funksionale në portalin elektronik e-Albania.	AKSHI	Fund i vitit 2019	Për tu vlerësuar pas Procesit të Derregullimit, i cili është duke u zhvilluar dhe pasi të ketë një përshkrim ekzakt të llojeve të shërbimeve elektronike të kërkuara për zbatim.	Nr i shërbimeve elektronike të reja të niveleve 3 dhe 4 dhe funksionale	Korrupsion më i ulët për shkak të shmangjes së kontakteve direkte midis qytetarëve, bizneseve dhe punonjësve të institucioneve publike. Numri i	Realizuar	<b>Lista e shërbimeve të reja elektronike të shtuara gjatë kësaj periudhe:</b> AKSHI ka identifikuar listën e shërbimeve prioritare që do implementohen në portalin e-Albania, për të cilat ka nisur dhe puna për zhvillimin e tyre dhe janë shtuar <b>10 shërbimet elektronike</b> të mëposhtme: <b>a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</b> - Aplikim për të fituar të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të peshkimit/akuakulturës në ujërat e brëndshme <b>b) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</b> - Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi (eSig25)

					shërbime ve elektroni ke funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet publike, rritja e impaktit për korrupsion më të ulët si një rezultat i shmangies së kontakteve direkte midis qytetarëve, bizneseve dhe punonjësve të institucio	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Çertifikatë Rezidence Tatimore</li> <li><b>c) Bashkia Tiranë-DPTTV</b></li> <li>- Vërtetim likuidimi të taksave dhe tarifave vendore - Bashkia Tiranë</li> <li><b>d) Instituti i Sigurimeve Shoqërore</b></li> <li>- Deklaratë për konfirmimin e kreditimit të llogarisë dhe rregullueshmërinë e pagesave në bankat e nivelit të dytë</li> <li>- Vërtetim i pagesës së kontributeve vullnetare</li> <li><b>e) Qendra Kombëtare e Biznesit</b></li> <li>- Lëshim i titullit të licencës/lejes</li> <li><b>f) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit</b></li> <li>- Aplikim për Çertifikatë Elektronike Test</li> <li>- Aplikim për pajisje me nënshkrim elektronik për titullarët e institucioneve</li> <li>- Pajisja me nënshkrim elektronik për nëpunësit qeveritarë</li> </ul> <p>2,813,000 dokumente me vulë elektroni ke të gjeneruara në periudhën janar – dhjetor 2019, përmes modulit të e-albanias dhe portalit e-albania, duke reduktuar kështu burokracitë dhe duke eliminuar në mënyrë të drejtpërdrejtë kontaktin qytetar - administratë. 302,068 përdorues të regjistruar në portalin e-albania për periudhën në fjalë.</p>
--	--	--	--	--	--	--

						neve publike.		Në total mbi 1 milion përdorues të portalit, të cilët mund të përdorin shërbimet elektronike të tij duke reduktuar prezencën fizike në sportelet e institucioneve. Mbi 7.6 milionë përdorime të shërbimeve elektronike të portalit nga qytetarët, bizneset dhe punonjësit e administratës çka nënkupton se 7.6 milionë vizita në zyrat e administratës janë eliminuar.
--	--	--	--	--	--	---------------	--	---

***Objektivi A.4 Përmirësimi i trajtimit të denoncimeve ndaj korrupsionit***

**Gjendja aktuale për këtë objektiv**

Nga analizat e punës të Policisë së Shtetit evidentohet një numër i madh i ankimeve të paraqitura nga qytetarët për të cilat policia e shtetit vihet në dijeni nëpërmjet portaleve, nëpërmjet postës elektronike dhe postës së shkruar. Nga analizimi i të dhënave evidentohet se në pjesën më të madhe të referimeve e zënë këto ankime. Në këtë kontekst nga strukturat për hetimin e korrupsionit në Policinë e Shtetit po ju kushtohet rëndësi trajtimit me përparësi dhe profesionalizëm të këtyre rasteve.

**Treguesit e performances/ Indikatori:**

**A.4 Numri i hetimeve të korrupsionit të ardhura nga denoncimet e qytetarëve.**

***Objektiv A.4, i arritur në masën 100%***

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: (2018) Përmirësimi i procesit të brendshëm të monitorimit të Policisë së Shtetit me qëllim për të marrë të dhëna të zbërthyer (2019) 5% rritur, në lidhje me 2018; (2020) 5% rritur, në lidhje me 2019.

Evidentimi dhe goditja e rasteve të korrupsionit, si mase për të parandaluar dhe ulur numrin e përfshirjes së zyrtarëve publik në veprime korruptive. Evidentimi dhe analizimi i fushave me risk të korrupsionit dhe marrja e masave parandaluese.

Që nga 2017, të dhënat në dispozicion të Policisë së Shtetit tregojnë numrin total të hetimeve dhe numrin total të hetimeve të gjeneruara nga iniciativa e

policisë. Diferenca ndërmjet këtyre shifrave paraqet numrin total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve dhe institucioneve të tjera. Plani i Veprimit duhet të japë përparësi një aktiviteti që krijon një sistem për të ndjekur numrin e hetimeve të gjeneruara në mënyrë specifike nga denoncimet e qytetarëve. Pasi ky sistem të jetë vendosur, Plani i Veprimit do të përcaktojë prioritetin e krijimit të një statistike me matjen e përqindjes së këtyre hetimeve, të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve të paraqitura përmes portaleve në internet.

Prandaj në këtë fazë të dhënat bazë janë të disponueshme vetëm në numrin e përgjithshëm të hetimeve të krijuara nga qytetarët dhe denoncimet e institucioneve të tjera. Treguesi do të vlerësohet duke matur në fillim përmirësimin e procesit të monitorimit të brendshëm të Policisë së Shtetit me qëllim marrjen e të dhënave të zbërthyera (**proces**) dhe më pas rritjen e numrit total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve (**performanca**).

Është vendosur një nën-tregues shtesë për vitet 2019 dhe 2020, për të matur përqindjen e hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve të cilat janë dorëzuar përmes portaleve online.

**Nën-indikator A.4.a.1:** Raporti i hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve nëpërmjet portaleve online, mbi numrin total të hetimeve të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve.

Nr	Masa/aktiviteti	Institucioni përgjegjës/ Raportues	Kohëzgjatje /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
A.4.1	Përmirësimi i efikasitetit dhe trajtimi me përparësi dhe nga struktura të specializuara për të marrë të dhëna të zbërthyera mbi numrin e	Policia e Shtetit		Buxheti i shtetit	Përmirësimi i procesit të brendshëm të monitorimit	Rritja e besimit të qytetarëve tek strukturat ligjzbatuese të anti-korrupsio	Realizuar	Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, nga strukturat Kundër Korrupsionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, janë evidencuar: <b>1286</b> vepra penale (ku përfshihen rastet e korrupsionit dhe veprat penale të zyrtarëve në detyrë). Janë implikuar <b>1715</b> autorë të dyshuar, nga të cilët: 238 të arrestuar/ndaluar, 1457 të proceduar në gjendje të lirë dhe 20 të shpallur në kërkim. Krahasuar me

	hetimeve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve					nit e për rrjedhojë rritjen e denoncimeve nga qytetarët.		vitin 2018, gjatë vitit 2019 janë evidentuar: 307 vepra penale më shumë për korrupsion e krime të zyrtarëve në detyrë, 321 autorë më shumë, 32 Autorë të arrestuar më shumë. Janë proçeduar 549 Autorë më shumë, në gjëndje të lirë, 293 autorë më shumë, shpallur në kërkim 4 autorë më pak. <i>(Për të gjitha rastet janë kryer veprimet policore dhe hetimore dhe janë referuar në Prokurori)</i>
A.4.2	Kryerja e trajnimeve të përbashkëta në fushën e korrupsionit dhe të krimeve në detyrë mes institucioneve ligjzbatuese	Prokuroria Policia e Shtetit		Buxheti i shtetit	Numri i trajnimeve	Rritja e aftësive profesionale të burimeve njerezore që do të merren me trajtimin e rasteve të denoncuar nga qytetarët	Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Gjatë kësaj periudhe janë realizuar: 12 trajnime/seminare, në fushën e Krimeve Ekonomike dhe Financiare, Korrupsionit dhe krimeve në detyrë. Me 34 përfitues nga burimet njerezore që merren me trajtimin e rasteve të denoncuar nga qytetarët, apo hetime penale në këtë fushë. Trajnimet janë kryer nga: 1. Këshlli i Europës; 2. Ambasada Amerikane; 3. Akademia e policisë; 4. Zagreb, Kroaci; 5. Budapest, Hungari; 6. Shkup.
A.4.3	Kryerja e takimeve dhe analizave të përbashkëta mes agjensive ligjzbatuese	Prokuroria Policia e Shtetit	Tremujori i 2-të	Buxheti i shtetit	Numri i takimeve, analizave	Rritja e kordinimit të struktura ve ligjzbatu	Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Gjatë kësaj periudhe janë kryer <b>227</b> takime dhe analiza të përbashkëta me Prokurorinë, dhe Agjencitë/Instucione të tjera ligjzbatuese, lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimeve, si dhe të

	lidhur me trajtimin e ankesave të qytetarëve.					ese lidhur me çështjet e gjeneruar nga denonci met e qytetarëve		proçedimeve penale.
A.4.4	Rritja e transparencës për publikun nga institucionet ligjzbatuese.	Prokuroria Policia e Shtetit		Buxheti i shtetit _____	Raporti i ankesave të publikuara në faqet e internetit të institucioneve kundrejt ankesave të pranuar gjithsej	Rritja e përgjegjshmërisë së institucioneve për kryerjen e detyrave funksionale	Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Nga Drejtoria e Standarteve Profesionale, janë regjistruar <b>928</b> ankesa të ardhura në Platformën, “Zyra e Bashkëqeverisjes”, në Kryeministri. Janë verifikuar dhe kthyer përgjigje <b>908</b> ankesa Në ankesat e verifikuara përfshihen edhe ankesa për korrupsion, të cilat janë drejtuar për zgjidhje sipas kompetencave në organet ligjzbatuese në Polici dhe Prokurori.  -20 ankesa e tjera janë në proces verifikimi dhe në pritje të marrjes së përgjigjes sipas afateve.
A.4.5	Ngritja nga institucionet e grupeve, ose strukturave, audituese me objekt inspektimin për marrjen, rregjistrimin, trajtimin e	Të gjithë institucionet		Buxheti i shtetit _____ 10,243,912 lekë <b>1,835,070 lekë</b>	Numri i institucioneve që kanë ngritur grupe apo struktura për trajtimin e ankesave të qytetarëve	Rritja e llogaridhënies nga punonjësit e administratës shtetërore e lidhur me	Realizuar  Realizuar	<b><u>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</u></b> Ankesat e qytetarëve trajtohen nga Drejtoritë përkatëse në MEPJ /DBNJ sipas specifikave të tyre. <b><u>Policia e Shtetit</u></b> Në të gjitha strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë dhe Komisariateve të Policisë, janë të ngritura dhe funksionojnë

	<p>ankesave nga qytetarët për punonjësit e institucioneve shtetërore.</p>			<p><b>MM</b> <b>AZHBR</b> 80,000 lekë</p> <p><b>AKU</b> 3,675,957 lekë</p>	<p>për punonjësit shtetëror.</p>	<p>ankesat e qytetarëve.</p>		<p>zyrat e pritjes të qytetarëve, për marrjen, regjistrimin, trajtimin e ankesave nga qytetarët për punonjësit e institucioneve shtetërore. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, funksionon struktura e Sektorit të Disiplinës dhe Ankesave, për marrjen, regjistrimin, trajtimin e ankesave nga qytetarët për punonjësit e institucioneve shtetërore.</p> <p>Policia e Shtetit, në zbatim të detyrimeve ligjore bashkëpunon me Zyrën e Bashkëqeverisjes, në Kryeministri për marrjen/rregjistruar/ trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave nga qytetarët për punonjësit e institucioneve shtetërore.</p> <p>Çdo ankesë trajtohet sipas objektit, duke i referuar/dërguar institucioneve ligjzbatuese, apo të tjera. Pas kryerjes së veprimeve administrative, apo hetimore, ju është kthyer përgjigje qytetarëve.</p> <p>Per periudhen Janar – Dhjetor 2019, nga SH.Ç.B. A janë marrë dhe trajtuar 6341 telefonata në linjën e gjelbër 0800 90 90 dhe 1731 ankesa nga të gjitha portat e mundshme që SH.Ç.B. A ka vënë në dispozicion të publikut.</p> <p>Pas hetimit administrativ të ankesave ka rezultuar se:</p> <p>Për 218 punonjës policie janë evidentuar shkelje të karakterit administrativ dhe është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor nga Drejtoria e Standardeve Profesionale,</p>
--	---	--	--	--	----------------------------------	------------------------------	--	---

							<p>në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.</p> <p>Për 6 punonjës policie janë gjetur shkelje ku janë konstatuar elementë të veprës penale, duke bërë referimin e materialeve pranë organit të Prokurorisë.</p> <p>Në rastet e tjera veprimet e punonjësve të policisë kanë qenë konform procedurave standardeve të punës.</p> <p><b><u>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:</u></b></p> <p>Nuk ka raportuar për periudhën Janar-Dhjetor 2019.</p> <p><b><u>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</u></b></p> <p>Në strukturën e saj ka ngritur e miratuar njësinë për sinjalizimin, mbrojtjen e sinjalizuesve e konfliktit të interesave, në përbërje të Drejtorisë Auditimit të Brendshëm.</p> <p>Nga DAB është përgatitur Rregullorja “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit, për hetimin administrativ të kërkesave të sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në MBZHR”, e dërguar për miratim në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit Interesave.</p> <p>Nuk janë paraqitur ankesa për punonjësit e institucionit.</p> <p><b><u>AZHBR</u></b></p>
--	--	--	--	--	--	--	--



							<p>Në zbatim të Ligjit nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” në strukturën e AZHBR është ngritur njësi për “Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Gjithashtu në zbatim të ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” pranë këtij sektorit ndodhet “Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Të dyja këto struktura të ngritura pranë AZHBR-së janë përgjegjëse për marrjen, regjistrimin dhe trajtimin e ankesave të paraqitura nga qytetarët.</p> <p>Për periudhën raportuese nuk janë paraqitur ankesa për punonjësit e institucionit.</p> <p><b><u>AKU</u></b></p> <p>Ankesat trajtohen nga Sektori i Auditimit në kuadrin e denoncimit, në bashkëpunim me strukturat e tjera inspektuese sipas çështjes konkrete të denoncuar. Kjo për të gjitha rastet, si nga ana kur ato paraqiten nga Platforma, por edhe me mjete të tjera. Trajtim Ankesash nga Platforma e Bashkëqeverisjes për periudhën Janar - Dhjetor 2019:</p> <p>Janë trajtuar rreth <u>65</u> raste Problematikat kanë të bëjnë më së shumti me: - Pretendime në lidhje me masat</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>administrative që kanë marrë inspektorët, Ankesë nga qytetarët për produkte të tregtuara nga subjekte të tjerë pa licencë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ankesa për largim nga detyra</li> <li>- Kërkesa për Punësim</li> <li>- Ankesa në lidhje me thyerjen e kodit të etikës nga ana e punonjësve të AKU-së (inspektorëve).</li> </ul> <p>Janë trajtuar të gjitha ankesat dhe janë kthyer përgjigje brenda afatave platformës së bashkëqeverisjes.</p> <p><b><u>Komisioni ankimimit.</u></b></p> <p>Për periudhën Janar - Dhjetor 2019 janë paraqitur gjithsej <b>437</b> ankesa administrative për masat e marra ndaj subjekteve (gjoba të aplikuara). Janë shqyrtuar <b>230</b> ankesa nga komisioni i ankimimit nga ku ka rezultuar <b>220</b> raste është vendosur rrëzimi i kërkesës ankimore dhe lënia në fuqi e akteve administrative objekt ankimi, në <b>5</b> raste, është vendosur mos pranim i ankimimit në <b>4</b> raste është pranuar kërkesa ankimore dhe janë shfuqizuar aktet objekt ankimimi, në <b>1</b> rast është bërë pranimi i pjesshëm i kërkesës ankimore.</p> <p><b><u>Ministria e Mbrojtjes</u></b></p> <p>Në Drejtorinë e Inspektimit të Përgjithshëm është ngritur dhe funksionon Sektori i Kërkesë - Ankesave dhe Informimit, i cili administron, rregjistron, trajton, ndjek dhe informon për të gjitha ankesat që vijnë në adresë të</p>
						Realizuar	
							Realizuar

							<p>Ministrin të Mbrojtjes, duke e informuar atë dhe publikun për zgjidhjet e dhëna. Gjithashtu edhe në strukturat vartëse është përcaktuar personeli që realizon të njëjtat detyra për strukturat ku bëjnë pjesë.</p> <p><b><u>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</u></b></p> <p><b><i>MSHMS:</i></b> Ka strukturë audituese dhe ka kryer auditimet sipas planit të miratuar. Ka strukturë për ankesat e qytetarëve në nivel sektori (varësi e Drejtorisë Burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse. Të dhëna i disponon ky sektor).</p> <p><b><i>ISHP:</i></b> Për marrjen, regjistrimin e ankesave dhe ndjekjen e procesit deri në kthimin e përgjigjeve brenda afatit janë përcaktuar punonjësit përkatës të institucionit.</p> <p><b><i>ISHSH:</i></b> Çdo ankesë e ardhur drejtohet për trajtim sipas problematikës strukturës përkatëse.</p> <p>Në degët rajonale të ISHSH trajtimi i ankesave bëhet nga një punonjës i caktuar.</p> <p><b><i>SHSSH:</i></b> Ka strukturë audituese dhe Njësi Sinjalizimi e cila ka kryer trajnimin nga ILDKPKI</p> <p>-Çdo ankesë e ardhur drejtohet për trajtim sipas problematikës strukturës përkatëse.</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>Për periudhën Janar- Dhjetor 2019 nga Platforma e Bashkëqeverisjes janë trajtuar 235 ankesa për NE, 563 ankesa për AK dhe 357 ankesa me problematika të ndërthurura.</p> <p><b><u>MASR:</u></b></p> <p>Ekziston zyra e pritjes së qytetarëve në ambientet e Ministrisë e cila funksionon sipas orarit zyrtar dhe orienton qytetarët për çështje që mbulohen nga MASR. Gjithashtu ngrihen grupe inspektimi pranë MASR-së për trajtimin e ankesave nga qytetarët për punonjës në sistemin arsimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.</p> <p><b><u>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:</u></b></p> <p>Zbatimi i Ligjit nr.60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.</p> <p>Është hartuar dhe miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 29.12.2017.</p> <p><b><u>Ministria e Kulturës</u></b></p> <p>STRUKTURAT</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njësia e Transparencës dhe Antikorrupsionit</li> <li>2. Task Forca për menaxhimin e sezonit turistik veror 2019.</li> </ol>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>3. Njësia e Monitorimit të Biletarisë</p> <p>1. Pranë Ministrisë së Kulturës, funksionin Njësia e Transparencës dhe Antikorrupsionit përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Personi përgjegjës për Antikorrupsion</li> <li>• Struktura përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të Interesit</li> <li>• Njësia përgjegjëse për shqyrtimin e sinjalizimeve.</li> </ul> <p>1. Në kuadër të sezonit turistik veror 2019 është miratuar Udhëzimi nr. 2223/6 datë 30.04.2019 “Për mënyrën e funksionimit dhe përgjegjësitë e institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe artit gjatë sezonit turistik veror 2019” ku në kapitullin VII. Etika e Shërbimit është cituar si detyrim “Vendosja pranë biletarive e posterit anti-korrupsion si dhe materialet promociionale”.</p> <p>2. Me Urdhër nr. 209, dt. 17.04.2019, të Ministrit të Kulturës “Për krijimin e Task-Forcës të Ministrisë së Kulturës për menaxhimin e sezonit turistik veror 2019” është funksionalizuar Task Forca e MK për sezonin turistik veror (1 maj - 15 tetor 2019) e cila inspekton të gjitha masat e marra për mbarëvajtjen e sezonit turistik.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>3. Është miratuar Urdhri nr.730, datë 19.12.2019 “Për miratimin e rregullores mbi funksionimin e sistemit të biletarisë në institucionet e trashëgimisë kulturore”. Nëpërmjet kësaj rregulloreje janë përcaktuar dhe standartizuar procedurat për funksionimin e sistemit të biletarive me qëllim përmirësimin e shërbimit dhe performances në sitet e trashëgimisë kulturore. Kjo rregullore përmirëson gjithashtu procesin e menaxhimit dhe rregullimit të hyrjes me biletë në sitet e trashëgimisë duke shmangur dhe krijuar kushtet për sjellje abuzive pranë pikave të shitjes së biletave në sitin e trashëgimisë.</p> <p>3. Bazuar në këtë rregullore ngrihet Njësia e monitorimit të Biletarisë, e cila është dhe njësia që do të përgjigjet për menaxhimin e problematikave në sistemin e biletarisë. Procesi i raportimit kalon nga Njësia e Monitorimit, tek kompania përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe më pas tek Sekretari i Përgjithshëm në MK. Nëpërmjet këtij mekanizmi,</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>krijohen premisa për zgjidhje të shpejta të problematikave, lidhjet procedurale të njoftimit përmes rrugëve administrative nga Ministria e Kulturës të institucioneve që administrojnë sitet, për parandalimin e çdo tentative abuzive në shitjen e biletave, nga personat e punësuar në sportel apo dhe drejtuesit e tyre.</p> <p><b>INSPEKTIMET</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Inspektimet për performancën e siteve të trashëgimisë</li> <li>2. Inspektimet për funksionimin e sistemit të biletarisë</li> </ol> <p>Gjatë 2019, MK ka kryer Inspektime në institucionet e mëposhtme ku janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe”</li> <li>2. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës</li> <li>3. Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Vlorë</li> <li>4. Parku Kombëtar Butrinti.</li> <li>5. Parku Arkeologjik Apoloni</li> <li>6. Parku Arkeologjik Shkodër</li> <li>7. Muzetë në Krujë</li> <li>8. Muzeu Marubi</li> <li>9. Muzeu Historik Kombëtar</li> </ol>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>10. Muzeu Onufri Berat  11. Kalaja Berat  12. Kalaja Gjirokastrë</p> <p>Për të rritur performancën e shërbimeve në sportelet e siteve të trashëgimisë dhe të muzeve, si edhe për të shmangur abuzimet me shitjen e biletave, gjatë muajit Shtator, MK organizoi Inspektime në 10 site dhe muze që funksionojnë me biletari elektronike. Raporti i grupit të inspektimit propozoi ngritjen e një njësie të përhershme monitorimi pranë MK, si edhe miratimin e rregullores së funksionimit të sistemit të biletarisë, e cila është në proces hartimi dhe pritet të miratohet brenda muajit Tetor.</p> <p>Është miratuar Urdhri nr.715, datë 10.12.2019 “Për miratimin e formatit, çmimit, kategorisë, dhe mënyrës së emetimit të biletave për muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publikë, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike në varesi të Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë” i cili bën një kategorizim të formatit të biletave, si dhe çmimit të tyre për çdo sit dhe muze. Gjithashtu, ky urdhër përcakton mënyrën e emetimit të biletave sipas një formati standart, pjesë përbërese e këtij urdhri. Ky urdhër rrit nivelin e transparencës, pasi parashikon detyrimin për publikim të çmimeve të miratuara të biletave për vizitorët.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---



								<p><b><u>MFE</u></b>          Ekziston zyra e pritjes së qytetarëve në ambjentet e Ministrisë e cila funksionon sipas orarit zyrtar dhe orienton qytetarët për çështje që mbulohen nga MFE.          Pranë ambjenteve të MFE-së janë alokuar tre persona nga stafi i bashkëqeverisjes që në bashkëpunim me kabinetin, merren me shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

***Objekti A.5 Forcimi i regjimit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë dhe rasteve të konfliktit të interesave***

**Gjendja aktuale për këtë objekt**

Ndryshimet e fundit në Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nënpunësve Publikë”, duke ju dhënë mundësinë për të kompletuar dhe plotësuar deklarimin e pasurisë në mënyrë elektronike nga subjektet e ligjit (deklaruesit dhe personat e afërt me ta). Në tetor të 2016-ës, një projekt 3 vjeçar « Aksioni kundër kimit ekonomik në Shqipëri për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë » u lançua përmes programit « Horizontal Facility » financuar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi European, ku një nga institucionet përfituese është ILDKPKI.

Një nga objektivat kryesorë të Projektit është të sigurojë asistencë teknike dhe financiare për krijimin e një sistemi të ri elektronik për ILDKPKI për deklarimin dhe kontrollin financiar të pasurive dhe konfliktit të interesit. Paralelisht, brenda kornizës të USAID - projekti i financuar 2-vjeçar « Transparenca në Sistemin Shëndetësor », ku një nga komponentët përsëri i është dedikuar ILDKPKI-së dhe sistemit të deklarimeve elektronike për interesat private, deri tani është siguruar suporti teknik dhe financiar, duke mundësuar dezajn-in dhe ndërtimin e programimit për sistemin e deklarimit online. Rezultatet e pritura të çdo projekti që janë aktualisht nën zbatim kryesisht fokusohen në :

- Përmirësimi i performancës së ILDKPKI-së në regjistrimin dhe administrimin e deklaratave të pasurisë, obligimet financiare të zyrtarëve publikë dhe të të zgjedhurve, investigimet administrative, si dhe publikimi i të dhënave të interesave private për shoqërinë civile dhe publike.
- Forcimi i kornizës legislative dhe përmirësimi i procedurave të brendshme të ILDKPKI-së, të kontrollit administrativ, hetimeve dhe auditimeve.
- Ndërtimi i kapacitetit (trajnimi) i inspektorëve të ILDKPKI-së në përdorimin e sistemit të ri IT të lidhur me dhënien, publikimin dhe kontrollin financiar të deklarimit të pasurive.
- Rishikimi i kapacitetit dhe suportit përmes mjeteve komunikuese dhe udhëzimeve në dorëzimin elektronik, publikimin dhe aksesin online të

deklaratave të pasurisë.

### **Treguesit e performances/ Indikatori:**

#### **A.5.a: Sistemi online për deklarimin e pasurisë është funksional nga 2020**

##### ***Indikatori A.5.a, i arritur në masën 100% për vitin 2019***

Përdorimi i plotë i sistemit online për deklarimin e pasurive përfaqëson një hap vendimtar përpara përforcimin e regjimit të zbulimit, të transparencës dhe kontrollit efektiv të pasurisë të zyrtarëve publikë, po ashtu edhe rastet e konfliktit të interesit.

Treguesi do të vlerësohet duke matur përfundimin e hapave të përkohshëm për funksionalizimin e plotë të sistemit të deklarimit të pasurive online (procesi), dhe në 2020, përdorimi i tij efektiv (performanca).

**Në 2018:** Përfundimi i procedurave të prokurimit dhe kontrata e nënshkruar.

Dizajni i sistemit dhe përgatitja e dokumentacionit.

Zhvillimi i sistemit dhe përgatitja e infrastrukturës.

**Në 2019:** Zbatimi, virtualizimi/përfundimi i sistemit operativ, instalimi i database (baza e të dhënave) dhe themelimi i aplikimit.

Rregullimi i viruseve dhe modifikimi/ritestimi.

Testimi i integruar dhe dorëzimi (kthimi).

Materialet e trajnimit dhe trajnimi i përdoruesve

Pranimi final dhe sistemi i plotë operativ.

**Në 2020:** Sistemi është plotësisht funksional dhe pritet që 80% e subjekteve të deklaruar të paraqesin deklarimin e pasurive online.

#### **A.5. b: Zbatimi i Ligjit për Sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve**

##### ***Indikatori A.5.b, i arritur në masën 100% për vitin 2019.***

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 70 %, 80% dhe 85 % respektivisht.

Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesit (Nr. 60/2016) u miratua në Qershor 2016 dhe hyri në fuqi në 1 Tetor 2016, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara në nenin 10, i cili hyri në fuqi më 1 korrik 2017. Në Shqipëri, duhet të raportojnë 31 institucione publike qendrore dhe 60 njësi të qeverisjes vendore me më shumë se 80 punonjës. Kohëzgjatja e procedurës hetimore administrative, sipas nenit 13 të ligjit, është vendosur 60 ditë. Neni 22 i ligjit paraqet detyrimet e raportimit. Ligji parasheh krijimin e mekanizmave të raportimit të brendshëm dhe të jashtëm që janë përgjegjës për të mbrojtur

bilbilfryrësit nga pasojat e raportimit të tyre. Efektet ligjore të ligjit u shtynë ne kohë. Për sektorin public, ligji kishte efekt ligjor prej 1 tetorit 2016 dhe për sektorin privat nga 1 korriku 2017. Sipas dispozitave të ligjit, në veçanti Nenit 22, “Raportimi” parasheh detyrimin e njësive përgjegjëse që çdo vit të dorëzojnë në ILDKPKI një raport me shkrim mbi raportet e regjistruara të bilbilfryrës, mjetet e aplikuara për hetimin administrativ të dhënies së informacionit shpjegues dhe mbrojtja e informatorëve. Për më tepër, ligji parashikon, ne nenet 13 dhe 14, procedurën e hetimit administrativ dhe vendimin për mos-inicimin dhe ndërprerjen e hetimit administrativ. Procedura e hetimit administrativ vendos afate konkrete kohore brenda të cilave duhet të lidhet, pra jo më shumë se 60 ditë nga data e fillimit të procedurës hetimore administrative, përveç nëse nevojitet një periudhë më e gjatë për shkak të rrethanave. Nga ana tjetër, në nenin 7 të ligjit parashikohet që raporti i bilbilfryrës duhet të dokumentohet me shkrim / regjistruar në çfarëdo mënyre. Njësia përgjegjëse ose ILDKPKI (në varësi të llojit të mekanizmit raportues të zgjedhur) në bazë të raportit / zbulimit, duhet të vendosë nëse do të fillojë ose jo hetimi administrativ.

ILDKPKI ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar krijimin e njësive përgjegjëse brenda autoriteteve publike qendrore dhe vendore me më shumë se 80 punonjës dhe raportin e tyre për të hartuar Regjistrin Kombëtar të Njësive përgjegjëse, si dhe emrat dhe pozicionin i personit përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, gjithsej 163 njësi përgjegjëse në sektorin publik. Ndërsa, duke filluar nga 1 korriku 2017, ILDKPKI ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar krijimin e njësive përgjegjëse brenda njësive të sektorit privat me më shumë se 100 punonjës, me qëllim të përpilimit të Regjistrit Kombëtar të njësive përgjegjëse në sektorin privat, së bashku me emrat dhe pozitën e personit përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Siç flasim, ekzistojnë 446 njësi përgjegjëse të krijuara brenda sektorit privat. Për sa i përket janarit 2018, ILDKPKI ka pranuar dhe administruar 161 raporte vjetore nga njësitë përgjegjëse në sektorin publik, ndërsa njësitë përgjegjëse në sektorin privat do të dorëzojnë raportet e tyre vjetore duke filluar nga janari 2019.

Deri në vitin 2018: 70% e zbulimeve të raportuara nga palët e dyshimta të vitit 2017 dhe 2018, të iniciuara për hetime administrative, përfundohen brenda afatit ligjor.

Deri në vitin 2019: 80% e raporteve të jashtme të vitit 2017 dhe 2018, të iniciuara për hetime administrative, përfundohen brenda afatit ligjor.

Deri në vitin 2020: 85% e zbulimeve të raportuara jashtë bilbiltit të 2017 dhe 2018, të iniciuara për hetime administrative janë plotësuar deri në afatin ligjor.

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin ndërmjet numrit total të zbulimeve të jashtme të raportuara dhe plotësuar nga sinjalizuesit brenda afatit ligjor, mbi numrin total të zbulimeve të iniciuara, të raportuara nga jashtë. Formula specifike e përdorur për këtë tregues është:

$$S_{\text{rap.}} = \frac{\text{Numri i zbulimeve të jashtme të raportuara nga sinjalizuesit brenda afatit ligjor}}{\text{Numri total i zbulimeve të jashtme të raportuara nga sinjalizuesit}} \times 100\%$$

N r	Masa/Aktivitete	Institucioni Përgjegjës/ Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
A.5.1	Përfundimi i procedurës së prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës për zhvillimin e softëare	ILDKPKI		USAID	Procedura e prokurimit e përfunduar dhe kontrata e nënshkruar me të përzgjedhurit		Përfunduar në vitin 2018	
A.5.2	Përfundimi i procedurës së prokurimit dhe nënshkrimi i kontratës për infrastrukturën hardëare	ILDKPKI		KE & BE (Horizontal Facility)	Procedura e prokurimit e përfunduar dhe kontrata e nënshkruar me të përzgjedhurit		Përfunduar në vitin 2018.	

A .5 .3	Dizanjimi i softëare dhe përgatitja e dokumentacionit	ILDKPKI		USAID USD 24,500 <hr/>	<p>Raportet e monitorimit të dorëzuara në Grupin e Punës për miratim</p> <p>Dokumenti i dizajnit të sistemit finalizohet dhe dorëzohet në Grupin e Punës për miratim;</p> <p>Dokumenti në studimit të kërkesave të sistemit të dorëzuar dhe miratuar nga Grupi i Punës.</p>		Përfunduar në vitin 2018.	
---------------	---	---------	--	------------------------------	---	--	---------------------------	--

A .5 .4	Zhvillimi i Sistemit dhe krijimi i infrastrukturës	ILDKPKI		KE & BE (Horizontal Facility) USD 122,499.5	Hardëare i konfiguruar dhe i instaluar		Përfunduar në vitin 2018.	
A .5 .5	Zbatimi, virtualizimi/përfundimi i sistemit operativ, instalimi i bazës së të dhënave dhe aplikimit	ILDKPKI	Tremujori i 1-rë	USAID & KE & BE (Horizontal Facility) USD 24,500  <b>258,975 EUR disbursuar Keshilli Evropes</b>	Baza e të dhënave dhe aplikimi të instaluar dhe themeluar		Realizuar	<b><u>ILDKPKI</u></b> Kompania zbatuese e projektit ikubINFO e cila është përgjegjëse për pjesën e software të sistemit gjatë muajit shkurt 2019 ka përfunduar procesin e instalimit të bazës së të dhënave dhe aplikimit. Ky proces është kryer në vijim të përfundimit të virtualizimit dhe përfundimit të sistemit operativ të zbatuar nga kompania Infosoft përgjegjëse për instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve elektronike hardware. Të dyja këto veprime operacionale, janë shoqëruar me asistencë teknike dhe trajnime për stafin teknik dhe përdorues të tjerë të sistemit, pjesë e stafit të ILDKPKI-së.
A .5 .6	Rregullimi i viruseve dhe modifikime/ritestimi	ILDKPKI	Tremujori i 1-rë	USAID & KE & BE (Horizontal Facility)	Veprimet/operacionet e performuar		Realizuar	<b><u>ILDKPKI</u></b> Në përfundim të instalimit të bazës së të dhënave dhe aplikimit, stafi teknik i kompanisë zbatuese ikubINFO, në

				<p>USD 24,500</p> <hr/> <p>USD 24,500</p>	<p>a nga stafi teknik. Të gjitha të metat/virus et e rregulluara dhe zgjidhja/m etoda e zgjidhjes së problemit në vend</p>			<p>bashkëpunim me ILDKPKI-në mundësuan organizimin dhe sigurimin e trajnimit të përdoruesve kryesorë të sistemit, duke prezantuar versionin më të fundit të të gjitha proceseve të përkthyer në hapa teknike në system, me qëllim identifikimin e hapësirave apo nevojës për përmirësim të sistemit. Gjatë sesioneve trajnuese, u identifikuan në përgjithësi, sipas moduleve të prezantuara, mangësitë që paraqiste sistemi dhe bazuar në këto gjetje, kompania zbatuese i reflektoi dhe i sistemoi ato. Gjithsesi, ky proces për periudhën raportuese, ka vijuar me testime dhe ritestime më të detajuara, të cilat janë kryer në kuadër të testeve të integruara që janë mbajtur nga stafi teknik i ikubINFO dhe ILDKPKI, si dy hapa që nderlidhen fort me njëri-tjetrin dhe në mënyrë të pashkëputur. Ky process ka përfunduar në qershor të vitit 2019.</p>
A.5.7	Teste të integruara dhe dorëzimi	ILDKPKI	Tremujori i 1-rë	<p>USAID &amp; KE &amp; EU (Horizontal Facility)</p> <hr/> <p>USD 24,500</p> <p>USD 24,500</p>	<p>Testimi final i dhënë dhe raportet e testimit të dorëzuara për miratim në</p>		Realizuar	<p><b><u>ILDKPKI</u></b> Në vijim të paraqitjes së informacionit në aktivitetin A.5.6, stafet përkatëse të ikubINFO dhe ILDKPKI, kanë përfunduar testet e integruara të sistemit duke analizuar çdo proces dhe secilin modul të sistemit online të deklarimit të</p>

					Grupin e Punës. Kodi burimor i dorëzuar			interesave private. Në përfundim të çdo seance testimi, janë mbajtur shënime të gjitha mangesitë dhe problemet e evidentuara, janë regjistruar në minutat e takimit. Me pas, kompania zbatuese ikubINFO ka kryer rregullimet e nevojshme në sistem, ja ka riparuar grupit të punës edhe njëherë për të parë nëse funksionalitetet janë në rregull dhe më pas është vijuar me miratimin e gjithë grupit të punës si dhe me pranimin e tyre. Ky proces ka filluar që prej muajit mars 2019 dhe ka përfunduar në mes të muajit qershor 2019.
A .5 .8	Materialet e trajnimit dhe trajnimi i përdoruesve	ILDKPKI	Tremujori i 2-të	USAID USD 24,500 <hr/> USD 24,500	Materialet e trajnimit të prodhuara dhe trajnimi i përdoruesve e Raportet e ndërtimit të kapaciteteve të dorëzuara në Grupin e Punës.	Përdoruesit e trajnuar të sistemit nisin të punojnë me sistemin e ri të deklarimit të pasurive	Realizuar	Kompania zbatuese e hardware Infocsoft Systems, ka hartuar materialet e trajnimit për infrastrukturën e rrjetit që ka hostuar sistemin e ri elektronik, si dhe infrastrukturën SimpliVity. Bazuar në këto materiale trajnimi, Infocsoft ka organizuar gjatë muajit shkurt 2019, trajnimin e posaçëm për stafin teknik të ILDKPKI-së. Trajnimi konsistoi në njohjen me karakteristikat, veçoritë dhe përdorimin e infrastrukturës së serverave dhe rrjetit, ndërtuar për hostimin e sistemit elektronik të ILDKPKI. Kjo infrastrukturë është e ngritur mbi platformën e virtualizimit të HPE SimpliVity.



								<p>Gjithashtu, kompania zbatuese e software, ikubINFO ka përgatitur manualët dhe materialet e trajnimit të dedikuara sipas moduleve dhe roleve që parashikon sistemi. Bazuar në këto materiale trajnimi, janë organizuar rreth 8 raunde trajnimesh me pjesëmarrjen e të gjithë stafit të ILDKPKI-së të cilët do të jenë përdorues të sistemit.</p> <p>Çdo sesion trajnimi është shoqëruar me evidencat përkatëse siç janë agjenda dhe lista e pjesëmarrësve.</p> <p>Një tjetër aktivitet i ndërmarrë nga ikubINFO në bashkëpunim me ILDKPKI dhe mbështjetjen e USAID është organizimi i trajnimeve për Autoritetet Përgjegjëse mbi funksionimin e sistemit elektronik. Këto trajnime u organizuan gjatë periudhës 16.04.2019 - 13.05.2019 ku janë trajnuar 366 persona, përfaqësues të AP-ve si në nivel qendror edhe në nivel vendor.</p>
A .5 .9	Pranimi final dhe sistemi i plotë operativ	ILDKPKI	Tremujori i 2-të	USAID & KE & BE (Horizontal Facility)	Pranimi testit të përdoruesit dhe raporti final i dorëzuar për miratim në Grupin e		Në proces	<p>Skenarët përfundimtarë të testimeve nga përdoruesit dhe pranimi të funksionaliteteve të sistemit u kryen gjatë dy javëve të para të muajit qershor 2019. Në vijim, kompania ikubINFO hartoi dhe paraqiti për miratim raportin përfundimtar i cili u rishikua dhe u miratua nga Grupi Punës brenda muajit Qershor.</p>

					<p>Punës. Lancimi i sistemit online</p>			<p>Gjithsesi, deri në lançimin e sistemit live për deklaruesit, ILDKPKI-së do t'i nevojitet kohë për të përgatitur dhe përditësuar kuadrin nënligjor të nevojshëm, pilotimin dhe vazhdimin e trajnimit për përdoruesit që kanë mbetur pa u trajnuar nga faza e parë. Për këtë, ILDKPKI gjatë periudhës raportuese, ka vijuar punën në drejtim të përmbylljes së procesit të regjistrimit të sistemit si bazë të dhënash shtetërore pranë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Ky regjistrim është kryer në fund të muajit shtator 2019. Puna po vijon për miratimin e aktit ligjor të krijimit të bazës së të dhënave shtetërore. ILDKPKI në fillim të muajit tetor 2019 ka hartuar draft VKM-në për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore e cila është dakordësuar dhe konfirmuar paraprakisht me AKSHI-n për të vijuar më tej me diskutimin me Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me marrjen e iniciativës ligjore për paraqitjen e këtij akti pranë Këshillit të Ministrave për miratim. Gjithashtu me miratimin e fondeve buxhetore për vitin 2020, është parashikuar fondi i nevojshëm për sigurimin e kontratës së mirëmbajtjes së sistemit, si një kërkesë e domosdoshme nga</p>
--	--	--	--	--	---	--	--	--

								VKM nr.710/2013. Procedurat e prokurimit pritet të zhvillohen brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020.
A.5.1.0	Deklarimi i pasurisë nga subjektet e ligjit (deklaruesit dhe personat e lidhur me ta) përmes sistemit online	ILDKPKI		Pa kosto Fondet e OSCE 7.000 Euro	Deklarimi i aseteve në mënyrë elektronike plotësuar nga subjektet e ligjit (deklaruesi dhe personat e lidhur me të)	Përmirësimi i regjimit të deklarimit të pasurive dhe rritja e transparencës.	T1 2020	
A.5.1.1	Përpunimi dhe përfundimi i fushatës për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me zbatimin e ligjit ligjit për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesit	ILDKPKI		Fondet e BE-së përmes Projektit të Binjakëzimit	Materialet reklamuese të prodhuara dhe të shpërndara (p.sh. fletushka, spote televizive etj.)	Zbatimi efektiv i ligjit të bilbilfryrësuesit	Përfunduar në vitin 2018.	
A.5.1.2	Forcimi i kapaciteteve të njësive përgjegjëse në institucionet	ILDKPKI	Tremujori i 1-rë	Fondet e BE-së përmes Projektit të Binjakëzimit	Plani dhe materialet e trajnimit të perfunduar	Zbatimi efektiv i ligjit të bilbilfryrësit	Realizuar	ILDKPKI me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave kundër korrupsionit”, në zbatim të parashikimeve lidhur me

	publike lidhur me detyrimet e tyre sipas ligjit per Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesit				a. Sesionet e trajnimit me njësité përgjegjëse të kryera.			organizimin e sesioneve trajnuese për njësité përgjegjëse pranë institucioneve publike, mbi detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre për zbatimin e ligjit, si fillim përfundoi procesin e rishikimit dhe finalizimit të kurrikulave trajnuese pranë ASPA-s si dhe identifikimin e trupes trajnuese. Gjithashtu, u përfundua hartimi i kalendarit të sesioneve trajnuese te cilat u zhvilluan gjatë periudhës janar- shkurt 2019. 14 sesione trajnuese u zhvilluan pranë ASPA-s për njësité përgjegjëse në sektorin publik, si në nivel qëndor dhe atë vendor me pjesëmarrjen e 217 anetarëve nga njësité përgjegjëse.
A .5 .1 3	Forcimi i kapaciteteve të njësive përgjegjëse në sektorin privat lidhur me detyrimet e tyre sipas ligjit per Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesit	ILDKPKI		Fondet e OSCE EUR 7,000 <hr/> EUR 3,000	Plani dhe materialet e trajnimit te perfunduar a.  Sesionet e trajnimit me njësité përgjegjëse të kryera.	Zbatimi efektiv i ligjit të bilbilfryrës it	Realizuar	Në bashkëpunim me OSBE-në, gjatë periudhës 18-28 qershor 2019, u organizuan 8 sesione trajnimit për Njësité Përgjegjëse pranë subjekteve private ku morën pjesë dhe u trajnuan 95 persona. Për këtë fazë të dytë të trajnimeve, u përdor kurrikula ekzistuese e hartuar për trajnimet e organizuara në nëntor 2018 me sektorin privat.

**Objekti A.6 Forcimi i regjimit të kontrolleve mbi financimin e partive politike**

**Gjendja aktuale për këtë objektiv**

Bazuar në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin Nr.8580, datë 15.2.2000 "Për Partitë Politike" KQZ është organi përgjegjës për monitorimin dhe mbikqyrjen e

financimit të partive politike për fushatat elektorale si dhe për vitin kalendarik. Gjatë 2017, KQZ monitoroi financimin e fushatave elektorale për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet parlamentare të 2017. Në fund të procesit të zgjedhjeve, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, dorëzuan raportet financiare të fushatave zgjedhore. KQZ i rishikoi/verifikoi/kontrolloi raportet financiare, raportet e monitorimit si dhe raportet e auditit për 18 parti politike në zgjedhjet parlamentare të 2017 dhe vendosi një sanksion administrativ (gjobë) për 7 parti politike. Bazuar në ligjin “Për partitë politike”, Brenda 31 marsit të vitit të ardhshëm, partitë politike duhet të dorëzojnë në KQZ raportet financiare për vitin kalendarik.

Ngritja e mekanizmit ad-hoc për mbikëqyrjen e financimit të partive politike, u miratua nga Parlamenti i Shqipërisë sipas ligjit “Për buxhetin e vitit 2017”.

*Më 30 qershor 2019 u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Në vitin zgjedhor, mbikqyrja financiare e partive politike, fillon me rregjistrimin e subjekteve zgjedhore në zgjedhje, emërimin e auditëve ligjorë dhe ekspertëve financiarë për monitorimin e fushatës, monitorimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore, hartimi dhe dorëzimi i raporteve financiare nga partitë politike, audituesit ligjorë dhe monitoruesit e shpenzimeve të fushatës, publikimi i raporteve financiare, verifikimi i raporteve dhe vendosja e sanksioneve, për rastet e shkeljeve të konstatuara. Gjatë periudhës prill-qershor 2019, u rregjistruan si subjekt zgjedhor gjithsej 36 parti politike, të cilat morën pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019. KQZ emëroi 34 auditues ligjorë, të cilët do të kryejnë monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e organeve vendore të vitit 2019 (shih vendimi i KQZ-së nr.740, datë 31.05.2019).*

*i) Ekspertët financiar kishin detyrimin të depozitonin në KQZ çdo javë raportet e ndërmjetme për rezultatet e monitorimit të fushatës zgjedhore. Janë dorëzuar në KQZ: 33 raporte monitorimi të ndërmjetëm për javën e parë të fushatës zgjedhore, 34 raporte monitorimi të ndërmjetëm për javën e dytë të fushatës zgjedhore, 34 raporte monitorimi të ndërmjetëm për javën e tretë të fushatës zgjedhore dhe 31 raporte monitorimi të ndërmjetëm për javën e katërt të fushatës zgjedhore. KQZ ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet e monitorimit të ndërmjetëm të fushatës zgjedhore në adresën: <http://cec.org.al/raporte-te-monitorimit-te-fushates-zgjedhore/>*

*ii) Afati i fundit i dorëzimit të raporteve financiare për fushatë zgjedhore 2019 ishte data 26.09.2019 (jo më vonë se 60 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve). 22 parti nga 36 parti që ishin regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhje kanë dorëzuar raport financiar për fushatën zgjedhore. KQZ ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet financiar të fushatës zgjedhore në adresën <http://cec.org.al/raportet-financiare-fushaten-zgjedhore-2019/>*

*iii) Në bazë të vendimit nr.740 datë 31.05.2019 u emëruan 34 ekspertë të cilët monitoruan dhe audituan 36 parti politike për fondet dhe shpenzimet e fushatës zgjedhore 2019 dhe 16 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit.*

*iv) Afati i fundit i dorëzimit të raporteve të monitorimit përfundimtar nga ekspertët financiarë ishte data 26.11.2019 (jo më vonë se 4 muaj nga data e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve). Ekspertët financiar kanë depozituar në KQZ 35 raporte të monitorimit përfundimtar të fushatës zgjedhore. KQZ ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet financiare të fushatës zgjedhore në adresën: <http://cec.org.al/raportet-e-monitorimit-perfundimtar-te-fushates-zgjedhore-2019/>*

*v) Afati i fundit i dorëzimit të raporteve të auditimit të fushatës zgjedhore ishte data 16.12.2019 (jo më vonë se 20 ditë nga dorëzimi i raportit të monitorimit përfundimtar). Audituesit kanë dorëzuar në KQZ 35 raporte auditimi. Audituesit kanë certifikuar financimin e fushatës zgjedhore për 35 parti*

politike. KQZ ka publikuar në faqen zyrtare të internetit raportet auditimit të fushatës zgjedhore në adresën: <http://cec.org.al/raportet-e-auditimit-te-partive-politike/>.

Fondet për auditimin financiar të fushatës dhe për monitorimin e shpenzimeve të fushatës, (pagesa e audituesve ligjorë) mbulohet nga buxheti i shtetit.

### **Treguesit e performances/ Indikatori:**

#### **A.6.a: Numri i raporteve të auditimit të partive politike të publikuara, të çertifikuara nga auditori i jashtëm**

**24 raporte të auditimit të partive politike të publikuara dhe të çertifikuara nga auditori i jashtëm. Indikatori A.6.a është arritur 67%.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 75%, 75%, 80%

Sipas legjislacionit (duke përfshirë Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike) të gjitha informacionet e mbledhura nga KQZ-ja (p.sh. raportet financiare, raportet e monitorimit dhe auditimit) administrohen me qëllim transparencën, kontrollin dhe mbikëqyrjen. Regjimi kontrollues për financimin e partive politike kërkon para së gjithash përfundimin e raporteve të auditimit të jashtëm mbi financimet e pranuar nga secila parti politike. Kjo vlerësim i jashtëm i nivelit të parë do të forcojë rolin kontrollues efektiv të KQZ-së dhe besueshmërinë e analizës së nivelit të dytë të kryer nga institucioni.

Ky tregues do të tregojë nivelin e transparencës në financimin e partive politike. Duke e matur këtë indikator/tregues, KQZ do të ketë mundësinë të propozojë rekomandime për ndryshimë në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin “Për Partitë Politike” në çështjet e financimit të partive politike, përmirësimin e modelit të raportimit si dhe ndërtimin e kapaciteteve për kontabilistët e partive politike, ekspertët financiarë si dhe struktura e specializuar e KQZ.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit të përgjithshëm të raporteve të auditimit nga partitë politike të cilat janë të çertifikuara nga auditorë të jashtëm dhe të pranuar nga KQZ-ja.

*Komision Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 21 pika 20, nenit 23, pika 1, gërma a, nenit 91, pika 4 i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 15/2 pika 1 dhe 2, gërma ç dhe d, nenit 24/2 i Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të KQZ-se nr. 1, datë 11.04.2019 duhet të përfundojë verifikimin e raporteve financiare të partive politike brenda datës 15 shkurt 2020.*

*Në përfundim të verifikimit në rast se KQZ, konstaton shkelje të dispozitave ligjore dhe akteve normative të nxjerra nga KQZ, kur nuk përbën vepër penale, zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 172, nenin 173 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar dhe nenit 24/2, pika 7 të nenit 23/4 të ligjit nr. 8580/2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar. KQZ, në vendosjen e sanksioneve bazohet në parimin e proporcionalitetit.*

#### **A.6.b: Gama e sanksioneve të vendosura për rastet e identifikuar (në kontekstin e shkeljeve që parashikon kodi zgjedhor)**

**Për vitin 2019: rezultati i këtij indikator nuk mund të raportohet në këtë moment, pasi KQZ nuk i ka identifikuar dhe sanksionuar në mbledhje publike rastet e shkeljes së ligjit për zgjedhjet 2019. Afati përfundimtar është data 15 shkurt 2020.**

**Indikatori A.6.b nuk është realizuar.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 25%, 25%, 30%.

*Komision Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 21 pika 20, nenit 23, pika 1, gërma a, nenit 91, pika 4 i Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 15/2 pika 1 dhe 2, germa ç dhe d, nenit 24/2 i Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar dhe Udhezimit të KQZ-se nr. 1, date 11.04.2019 duhet të përfundoj verifikimin e raporteve financiare te partive politike brenda datës 15 shkurt 2020.*

*Ne përfundim të verifikimit në rast se KQZ, konstaton shkelje të dispozitave ligjore dhe akteve normative të nxjerra nga KQZ, kur nuk përbën vepër penale, zbaton sanksionet e parashikuara në nenin 172, nenin 173 të Kodit Zgjedhor, i ndryshuar dhe nenit 24/2, pika 7 të nenit 23/4 të ligjit nr. 8580/2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar. KQZ, në vendosjen e sanksioneve bazohet në parimin e proporcionalitetit.*

Përmes këtij treguesi, ne kemi qëllim të vlerësojmë shkallën/nivelin e shkeljes së ligjit nga partitë politike dhe vendosjes së sanksioneve në mënyrë proporcionale me shkeljen e identifikuar.

Ndikimi efektiv operacional i regjimit kontrollues mund të vlerësohet duke matur verifikimin e shkeljeve të konstatuara dhe sanksioneve përkatëse të vendosura për çdo shkelje, në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen në përqindje të sanksioneve të dhëna, mbi rastet e identifikuara. Formula specifike e përdorur për treguesin do të jetë:

$$R_{\text{san.}} = \frac{\Sigma \text{ numrit tw sanksioneve tw dhwna}}{\Sigma \text{ numrit tw shkeljeve tw identifikuara}} \times 100\%$$

**A.6.c: Financat e partive politike të audituara në përputhje me rekomandimet e BE/ACFA**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 5, 5, 5

**Për vitin 2019: rezultati është 2 nga 5 parti politike Kjo pasi në zgjedhjet e vitit 2019, 3 nga 5 partitë më të medha nuk morën pjesë në zgjedhje.**

**Indikatori A.6.b është realizuar 40%.**

Amendimi dhe zbatimi i Kodit Zgjedhor të miratuar dhe Ligjit për Partitë Politike, si dhe aktet nënligjore në përputhje me rekomandimet e BE dhe ACFA, do të rezultojnë në:

- thjeshtimi i raportimit financiar dhe kërkesave të auditimit, raportimi dhe publikimi i raportit financiar të KQZ-së;

- masat për krijimin e strukturës përkatëse për kontrollin dhe verifikimin e pavarur të raporteve të auditimit;
- Përmirësimet e procedurës së brendshme dhe përgjegjësitë e qarta të stafit të KQZ-së për të kontrolluar financimin e partive politike.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit total të raporteve financiare vjetore dhe nëse është e aplikueshme, raportet financiare të fushatave dhe raportet finale të auditit për 5 partitë politike më të mëdha në lidhje me vitin e kaluar.

N r	Masa/aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/Raportues	Kohëzgjatja/Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
A.6.1.1	Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore lidhur me afatin e periudhës raportuese në emër të partive politike për vitin kalendarik.	KQZ		Buxheti i Shtetit/Donatore  408,000 lekë PBA 400,000 Donatorë	Ndryshimet ligjore të miratuara.  Numri i raporteve të auditimit të partive politike të publikuara, të certifikuara nga auditori i jashtëm	Rritja e transparencës	Në proces	Eshtë ngritur Komisioni i Posacëm Parlamentar Reformën Zgjedhore. Deri në Dhjetor 2019 nuk janë miratuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”.



A .6 .1 .2	Draftimi dhe miratimi i modelit standard për raportimin financiar për vitin kalendarik.	KQZ	Mars	Buxheti i Shtetit/ Donatore <hr/> 408,000 lekë PBA 400,000 Donatorë	Modeli standard i miratuar	Rritja e transparencës	Realizuar	Në përfundim të reformës zgjedhore dhe miratimit të amendamenteve të reja në Kodin Zgjedhor në lidhje me financimin e partive politike, KQZ do të miratojë modelin standart për raportimin vjetor financiar të partive politike. Administrata e KQZ-së, në bashkëpunim me ekspertët e NDI, të financuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe ka përfunduar draftimin e modelit standart për raportimin vjetor. Modeli i raportimit, u miratua me vendimin e KQZ-së 152, datë 11.04.2019, “Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore”. Gjatë vitit 2019, u zhvilluan seanca trajnimi për përdorimin e raporteve të miratuara.
A .6 .1 .3	Ndërtimi i kapacitetit profesional për personat përgjegjës për financimin e partive politike	KQZ	Mars	Buxheti i Shtetit/ Donatore <hr/> 408,000 lekë	Trajnime të kryera	Rritja e transparencës	Në proces	Për periudhën janar – dhjetor 2019, janë kryer këto trajnime: 5-9 Shkurt 2019 (Ekspertë e NDI), “Sistemi i kontrollit të cilësisë për çështje hartimi i metodologjisë për kontrollin dhe mbikqyrjen financiare të partive politike” 7-9 mars 2019 Qyentin Reed ekspert

				<p>PBA</p> <p>300,000</p> <p>Donatorë</p>			<p>KiE</p> <p>18-19 Prill 2019 (Ekspertë e NDI),  “Tryezë mbi njohjen e ndryshimeve të formatit standart të raportimit të partive politike për fushatën elektorale si dhe deklaratimet e të ardhurave e shpenzimeve të kandidatëve për kryetarë bashkie”</p> <p>2-3 maj 2019 Ekspertë nga Këshilli i Evropës, Instituti i Ekspertëve Kontabël të autorizuar (IEKA) Ekspertë financiarë dhe “Rishikimi i legjislacionit për financimin e partive politike dhe kuadri institucional”.</p> <p>Trajnim i stafit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me ekspertin e NDI, Lisa Klein eksperte ndërkombëtare e financave politike, ish drejtore e financimit të partive politike në Angli.:  Më datë 24 Korrik 2019 me temë “Monitorimi i ndërmjetëm i fushatës zgjedhore”</p> <p>Më 10 Tetor -11 Tetor 2019 me temë “Raportet financiare të partive politike dhe raportet e monitorimit dhe auditimit të fushatës zgjedhore”</p> <p>Më 11 Dhjetor – 12 Dhjetor 2019 me temë; “Ndryshimet e Kodit Zgjedhor në kuadër të Reformës Zgjedhore dhe Verifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore”</p> <p>Struktura e Posaçme në KQZ është</p>
--	--	--	--	---	--	--	--

								ngritur. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve është një proces në vazhdimësi.
A .6 .2 .1	Integrimi i legjislacionit në lidhje me sanksionet e vendosura	KQZ		Buxheti i Shtetit/ Donatore <hr/> 408,000 lekë PBA	% e sanksioneve të vendosura për rastet e identifikuar  Legjislacioni i aprovuar	Rritja e ndëshkimit	Në proces	Eshtë ngritur Komisioni i Posacëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.  Deri në Dhjetor 2019 nuk janë miratuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”
A .6 .2 .2	Draftimi dhe miratimi i formatit standard për raportimin nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë. (seksion i veçantë për identifikimin e shkelejeve të konstatuara)	KQZ	Mars	Buxheti i Shtetit/Donatore <hr/> 408,000 lekë PBA	Modeli standard i miratuar	Rritja e ndëshkimit	Realizuar	Në përfundim të reformës zgjedhore dhe miratimit të amendamenteve të reja në Kodin Zgjedhor në lidhje me financimin e partive politike, KQZ ka miratuar modelin standart për raportimin nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë. (seksion i veçantë për identifikimin e shkelejeve të konstatuara). Administrata e KQZ-së, në bashkëpunim me ekspertët e Këshillit të Europës ka përfunduar draftimin e modelit standart për raportimin nga ekspertët monitorues dhe audituesit ligjorë. (seksion i veçantë për identifikimin e shkelejeve të konstatuara). Modeli i raportimit dhe udhëzuesit, u miratua me vendimin e KQZ-së 256, datë 08.05.2019, “Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të

								standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.  Gjatë vitit 2020, do të zhvillohen seanca trajnimi për përdorimin e raporteve të miratuara.
A .6 .3 .1	Thjeshtimi i raportimit financiar dhe kërkesave të auditimit, raportimi dhe publikimi i raportit financiar të KQZ-së;	KQZ	Mars	Buxheti i Shtetit/ Donatore <hr/> 408,000 lekë PBA	Udhëzimet e përditësuar a të raportimit financiar		Realizuar	Modelet e raportimit, u miratuan me vendimin e KQZ-së 152, datë 11.04.2019, “Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore”. Gjatë vitit 2019, u zhvilluan seanca trajnimi për përdorimin e raporteve të miratuara.
A .6 .3 .2	Masat për të ngritur një strukturë përkatëse për kontrollin e pavarur dhe verifikimin e raporteve të auditimit	KQZ		Buxheti i Shtetit/ Donatore <hr/> 408,000 lekë PBA			Realizuar	KQZ ka ngritur strukturën e posacme, për kontrollin e pavarur dhe verifikimin e raporteve të auditimit. Sektori i verifikimit dhe mbikqyrjes së financimit të partive politike, në Drejtorinë e Financës përbëhet nga tre punonjës, shefi i sektorit dhe dy specialistë. Gjithashtu janë rekrutuar dy specialistë, jurist, pranë Drejtorisë Juridike, për verifikimin e raporteve financiera dhe raporteve të auditimit, evidentimin e shkeljeve të konstatuar dhe vendosjen e sanksioneve proporcionale. Struktura e

								Posaçme në KQZ është ngritur. Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve është një proces në vazhdimësi.
A.6.3.3	Përmirësimi i procedurës së brendshme dhe përgjegjësi të qarta të stafit të KQZ për kontrollin e financimit të partive politike	KQZ	Mars	Buxheti i Shtetit/ Donatore  408,000 lekë PBA	Procedura Standard Operative e krijuar / e azhurnuar		Realizuar	KQZ në rekomandimet drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, ka hartuar dhe draft amendimet në Kodin Zgjedhor për përcaktimin e procedurave dhe metodologjinë për kontrollin financiar të partive politike. Metodologjia e kontrollit dhe verifikimit u miratua nga KQZ me udhëzimin nr. 1, datë 11.04.2019. Gjatë viteve 2020 do të zhvillohen seanca trajnimi për strukturën e posaçme në KQZ, dhe gjithë palët e interesuara në lidhje me këtë metodologji. Në rast të ndryshimeve ligjore metodologjia mund të rishikohet në vitin 2020. Në këtë rast seanca trajnimi do të kemi edhe gjatë viteve 2021, 2022, 2023.

***Objektivi A.7 Përmirësimi i efikasitetit të auditimit dhe inspektimit të brendshëm dhe përdorimi sistematik i analizave të riskut***

**Treguesit e performances/Indikatorit:**

***A.7.a: Raporti i rekomandimeve të auditimit të brendshëm të pranuar dhe të zbatuara nga entitetet publike***

***Në këtë moment nuk mund t'ju dërgojmë informacion se sa ka arritur indikatorit A.7.a për vitin 2019.***

***Këto të dhëna analizohen nga Raportet Vjetore të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019, të cilat sipas përcaktimeve ligjore duhet të konsolidohen në Maj të viti pasardhës (Raportim nga MFE).***

***Gjatë vitit 2018, nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm janë dhënë 7910 rekomandime dhe janë pranuar nga subjektet e audituara 7897 rekomandime ose 78.4% e tyre.***

*Gjatë vitit 2018, nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm janë pranuar nga subjektet e audituara 7897 rekomandime dhe janë zbatuar 4501 rekomandime ose 57% e tyre.*

Ky tregues tregon shkallën e zbatimit të rekomandimeve të prodhuara nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm. Treguesi do të matet nëpërmjet nën-treguesve:

**Nën-treguesi a.1:** Rekomandimet e nxjerra nga IAs dhe të pranuar nga institucionet.

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Trend rritës

**Viti 2018 - 99,8% e rekomandimeve të pranuar.**

Numri i rekomandimeve të prodhuara nga auditorët e brendshëm dhe të pranuar nga insitucionet.

**Nën-tregues a.2:** Numri i rekomandimeve të nxjerra nga IA dhe të implementuara/zbatuara nga insitucionet

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Trend rritës

**Viti 2018 - 57% e rekomandimeve të zbatuara.**

Numri i rekomandimeve të prodhuara nga auditorët e brendshëm të implementuara nga institucionet.

**Rekomandimet kryesore të dhëna nga audituesit e brendshëm janë:**

- Fokusuar në përmirësimin e sistemeve dhe kuadrin rregullator, si dhe të karakterit organizativ.
- Për përmirësimin e sistemeve që lidhen me hartimin e regjistrit të aseteve, hartimin e regjistrit të risqeve, hartimin dhe miratimin e gjurmëve të auditimit për proceset e punës, rritjen e cilësisë së planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit, ruajtja e aseteve, etj.
- Të karakterit organizativ lidhen me miratimin ose përmirësimin e rregulloreve të brendshme, miratimin e manualeve të proceseve të punës, rishikimin e përshkrimeve të punës për çdo punonjës, ndarjen e qartë të detyrave, miratimin e rregullave të brendshme për delegimin e detyrave, etj.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen në përqindje të të dy raporteve. Formulatat specifike të përdorura për treguesin do të jenë:

- Nën-treguesi A.7.a.1: Raporti i rekomandimeve të lëshuara nga IA mbi numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të pranuar nga institucionet;

$$R \text{ A}\dot{c}. = \frac{\text{Shuma (e numrit te rekomandimeve te pranuar nga menaxhimi)}}{\text{shuma(numri I rekomandimeve te leshuara nga njesia e Auditimit te brendshem X 100\%}}$$

- Nën-treguesi A.7.a.2: Raporti i rekomandimeve të zbatuara, nga institucionet mbi numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të pranuar.

R Impl. = Shuma (numri I rekomandive te zbatuara nga institucionet Brenda dy viteve) / Shuma (numri I rekomandimeve te pranuar) X 100%

#### **A.7.b. Numri i rasteve që rezultojnë nga auditimi i brendshëm të cilat janë referuar inspektimet financiare**

##### **5 raste te referuara per inspektim financiar publik nga strukturat e auditimit. (Raportim nga MFE).**

Hartimi i raportit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik është një detyrim ligjor dhe i paraqitet Zyrtarëve Autorizues dhe Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë deri më 31 mars të vitit pasardhës. Hartimi i raportit vjetor të aktiviteteve të Inspektimit Financiar Publik synon të paraqesë aktivitetet e Inspektimit Financiar Publik, objektivat dhe performancën e Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik dhe objektivat e përcaktuara për periudhën në vijim, zbatimin e objektivit strategjik të qeverisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe masa zbatuese për arritjen e strategjisë dhe objektivave.

**Nën-tregues:** Rastet/informacioni që rezulton nga auditimi i brendshëm të cilat janë referuar për inspektime financiare në lidhje me një ngjarje e cila mund të jetë subjekt i inspektimit financiar publik dhe jo raportet e plota të auditimit të brendshëm ose kontrolli dhe menaxhimi financiar.

*(Aty ku auditimi i brendshëm apo strukturat e menaxhimit kanë identifikuar pa rregullësi të cilat çojnë drejt keqmenaxhimit serioz financiar, vjedhjes mashtrimit, shkatërrimit të pronës apo korrupsion, duhet të informojnë oficerin kryesor të autorizuar/ngarkuar, të shpjegojë gjurmën e auditimit të dyshuar për parregullsi bashkë me fotokopjet e dokumentacionit për këtë gjurmë të auditimit).*

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Trend rritës

Numri i informacionit të nxjerrë nga auditorët e brendshëm, pranuar nga inspektimet financiare/NAO. Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit të rasteve që rezultojnë nga auditimet e brendshme të cilat i referohen inspektimeve financiare.

#### **A.7.c. Numri i referimeve në prokurori që rezultojnë nga inspektimet financiare**

##### **Në përfundim të 7 misioneve të inspektimit, 2 raste janë referuar në Prokurori, ndërsa 5 inspektime janë në proces vendimmarrje/hartimi raporti, ndaj nuk mund të shprehemi ende lidhur me rezultatin e tyre. (Raportim nga MFE).**

**Nën-tregues** Numri i raporteve përfundimtare të inspektimit të nxjerra/leshuara nga Drejtoria e Inspektimit Publik Financiar të referuara në prokurori.

Aty ku e dhëna çon drejt një dyshimi të arsyeshëm për ekzistencën e një veprë, (referuar gjetjeve në raportet përfundimtare të inspektimit) Oficeri kryesor i autorizuar informon Ministrinë e Financave dhe e raporton ngjarjen në prokurori.

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: trend rritës

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit të referimeve në prokurori që rezultojnë nga inspektimet financiare.

**A.7.d. Numri i inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë**

**Janë inspektuar 30 subjekte, nga kryerja e 11 misioneve të inspektimit.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: trend rritës

Përmirësimi i kapaciteteve profesionale dhe rritja e llogaridhënies dhe integritetit të inspektorëve financiarë publikë nëpërmjet trajnimit dhe plotësimit të personelit të DIFP-së duke plotësuar vendet e lira të punës.

Numri i inspektimeve të varura nga numri i rasteve të pranuar rrit numrin e sinjaleve për inspektimin financiar publik nëpërmjet:

- Informimi dhe ndërgjegjësimi i autoritetit të nivelit 3 të lartë të menaxhimit si dhe të publikut. Takimi me nivelin e lartë drejtues (Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Auditimit).
- Takimet ose bashkëpunimi institucional me strukturat e përfshira në luftën kundër korrupsionit;

Performanca do të vlerësohet duke matur numrin total të inspektimeve financiare të kryera nga Njësia e Inspektimit Financiar të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

N r	Masa/Aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/ Raportues	Kohëzgjatja/ Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
A .7 .a .1	Rritja e kapaciteteve të auditit të brendshëm përmes zhvillimit të trajnimeve vazhduese profesionale të	MFE	Dhjetor	3000 Euro ('18) 3000 Euro ('19) <b><u>2,300,000 lekë</u></b> 3000 Euro ('20)	100% e auditit të brendshëm	Menaxhim më i mirë i fondeve publike	Realizuar	<b><u>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</u></b> Bazuar në Programin e Trajnimit të Vijueshëm Profesional të audituesve të brendshëm për vitin 2019, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.351, datë 31.12.2018 janë zhvilluar 13 javë trajnimi për periudhën Janar-Dhjetor 2019. Në këtë vit janë trajnuar 338 auditues të brendshëm, ose



	organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit. Përmes sigurimit të jashtëm të cilësisë, përmirësimet e nevojshme në auditin e brendshëm.			6150 Euro ('18) 6500 Euro ('19) 8000 Euro ('20) <hr style="width: 20%; margin: 0 auto;"/> (9600 €) 1,248,000 lekë (MFE)	vlerësime të jashtme të cilësisë çdo vit			100% e audituesve të brendshëm në detyrë të punësuar në sektorin publik. Temat kryesore të këtij programi trajnimi në funksion edhe të arritjes së objektivave strategjike të SNKK janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Planifikimi i veprimtarisë audituese me bazë risku, përcaktimi i sistemeve/fushave që do të auditohen në funksion të arritjes së objektivave të njësisë publike.</li> <li>• Parimet e Kontrollit të Brendshëm dhe roli i auditimit të brendshëm në procesin e menaxhimit të riskut.</li> <li>• Fokusi i audituesve të brendshëm në vlerësimin e riskut të mashtrimit.</li> </ul>
A.7.a.2	Rritja e kapaciteteve të auditit të brendshëm përmes zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit.	MFE	Dhjetor	3000 Euro ('18) 3000 Euro ('19) <b><u>1,700,000 lekë</u></b> 3000 Euro ('20) 6150 Euro ('18)	100% i auditit të brendshëm  8 vlerësime të jashtme të cilësisë çdo vit	Menaxhim më i mirë i fondeve publike	Realizuar	<b><u>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</u></b> MFE në bazë të një metodologjie bashkëkohore të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.22, 06.03.2017 “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik” vlerëson strukturat e auditimit të brendshëm që funksionojnë në sektorin publik për të verifikuar nivelin e zbatueshmërisë së standardeve ndërkombëtare. Gjatë vitit 2019 janë vlerësuar 15 njësi të auditimit të brendshëm sikurse ishin parashikuar për vitin në fjalë.

	<p>Përmes sigurimit të jashtëm të cilësisë, rekomandohen përmirësimet e nevojshme në aktivitetin e auditit të brendshëm.</p>			<p>6500 Euro (*19)</p> <p>6500 Euro (*20)</p> <hr/> <p>(9600 €) 1,248,000 lekë (MFE)</p>			<p>Njësitë e vlerësuara ishin përkatësisht Njësia e Auditimit të Brendshëm në: Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ZQRPPP dhe Bashkinë Sarandë, Bashkinë Devoll, Bashkinë Vlorë, Bashkinë Tropojë, Bashkinë Pogradec, OSHEE sha, KESH sha, Shërbimi Social Shtetëror, ISSH, Bashkia Krujë, Bashkia Shijak dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.</p> <p>Nga vlerësimet e jashtme të cilësisë për vitin 2019 rezultojnë gjetjet dhe rekomandimet kryesore për strukturat e auditimit të brendshëm janë sa më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rekomandimet e dhëna nga audituesit e brendshëm nuk ishin të qartë, specifike, të matshëm dhe në shumë raste nuk e orientonin subjektin e audituar drejt përmirësimeve efçente;</li> <li>• Nuk zbatoheshin plotësisht procedurat e përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, lidhur me fazat e auditimit;</li> <li>• Njësitë e auditimit të brendshëm nuk përcaktonin indikatorët e matjes së cilësisë së performancës dhe nuk hartonin Programin e Siguridhënies dhe Përmirësimin të Cilësisë;</li> </ul> <p>Monitorimi i rekomandimeve nuk kryhej në kohën e duhur, duke mos</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

								nxitur përgjegjshmërinë e subjektit të audituar për të reaguar në kohë për arritjen e objektivave të përcaktuara.
A .7 .b .1	Një ndarje e qartë e misionit të inspektimit financiar publik nga auditimi i brendshëm publik, si dhe trajnime vazhduese për auditorët e brendshëm/ Drejtuës të auditit të brendshëm CHU	MFE	Dhjetor	Buxheti i Shtetit <hr/>	Auditi i brendshëm + inspektime financiare	Mbrojtja e interesave financiarë të entiteteve publike kundër keqmena xhimit serioz financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërimit të pronës, keqpërdorimit të pushtetit apo korrupsionit.	Realizuar	Workshop i organizuar nga MFE me 30 drejtues të njësisve të auditit të brendshëm.
A .7 .c .1	Rritja e kapaciteteve të inspektimit financiar publik përmes	MFE	Dhjetor	2.479 Euro ('18)  5000 Euro ('19)	100% inspektim financiar	Mbrojtja e interesave financiarë	Realizuar	Trajnuar inspektorët lidhur me "Evidencimin e Rreziqeve për Korrupsion", organizuar me Projektin "Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e politikave

	<p>zhvillimit të trajnimeve profesionale vazhduese të organizuara çdo vit, në të cilat përfshihen çështje të mashtrimit dhe korrupsionit.</p> <p>Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve publike, punonjësve të tyre nëpërmjet trajnimeve profesionale e zhvilluese si dhe publikut në fushën e aktivitetit të inspektimit financiar publik.</p>			5000 Euro ('20)		të entiteteve publike kundër keqmena xhimit serioz financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërimit të pronës, keqpërdorimit të pushtetit apo korrupsionit.		<i>antikorrupsion në Shqipëri”, financuar nga BE si dhe mbi “Korrupsionin në administratën publike, mekanizmat e identifikimit”, organizuar nga ASPA. Përditësuar informacioni në web lidhur me veprimtarinë e DIFP dhe rezultatet e inspektimeve të kryera.</i>
A.7.d	Përmirësimi i kapaciteteve profesionale dhe rritja e llogaridhënies dhe integritetit të inspektorëve financiarë	MFE	Dhjetor	1.500 Euro ('18) 1.500 Euro ('19) 1.500 Euro ('20)	100% inspektimi financiar	Mbrojtja e interesave financiarë të entiteteve publike	Realizuar	Trajnuar inspektorët lidhur me temën “Korrupsioni në administratën publike, mekanizmat e identifikimit”. Janë zhvilluar takime dhe bashkëpunim i vazhdueshëm me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe organin e Prokurorisë. Gjithashtu në kuadër të luftës ndaj korrupsionit me fondet e BE-së,

<p>publikim përmes trajnimeve të tyre dhe kompletimin e strukturës së DIFP duke plotësuar vendet e lira.</p> <p>Takimi me nvelin e lartë drejtues (Sekretarja e Përgjithshme dhe Drejtori i Auditit).</p> <p>Takime apo bashkëpunime insitucionale me strukturat e përfshira në luftën kundër korrupsionit.</p>					<p>kundër keqmena xhimit serioz financiar, mashtrim it, vjedhjes, shkatërri mit të pronës, keqpërdorimit të pushtetit apo korrupsionit.</p>	<p>bashkëpunim i vazhdueshëm me OLAF, nëpërmjet rrjetit AFCOS.</p>
---	--	--	--	--	---	--

***Objektivi A.8 Përdorimi sistematik i mekanizmit të evidentimit të hapësirave për korrupsion***

**Treguesit e performances/ Indikatori:**

**Indikatori për Objektivin A.8 nuk është realizuar 0%.**

## Numri i institucioneve publike që kanë kryer analiza të riskut vjetore për prirjet ndaj korrupsionit

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Udhëzimet të zhvilluara dhe të pranuar për kryerjen vlerësimit të riskut në institucionet publike; Është përgatitur një program trajnimi për zbatimin e manualit; Është vendosur një plan veprimi ndërinstitucional për kryerjen e vlerësimeve të riskut; Mjetet e zhvillimit të vlerësimit të riskut të testuara dhe zbatuara në të gjitha institucionet publike; të gjitha ministritë / agjenci kanë zbatuar një vlerësim të riskut, respektivisht.

Në institucionet publike (Ministria, Drejtoria ose Njësia) do të përcaktohen dy lloje të dobësive ose riskut të korrupsionit:

1. Aktivitetet e lidhura me punën lidhur me p.sh. paratë, informacionin konfidencial, dhënien e lejeve, shtyrjen e kontratave, etj;
2. Dobësitë organizative. Kjo ka të bëjë me disa procese potencialisht të prirura për shkelje të integritetit ose korrupsionit, p.sh. Përzgjedhjen dhe rekrutimin e stafit, prokurimin, përpunimin e informacionit konfidencial.

Së bashku ato formojnë rreziqet potenciale për të cilat organizata është e ekspozuar.

Përveç kësaj, do të vlerësohet nëse këto rreziqe mbulohen mjaftueshëm nga rregullat dhe rregulloret ekzistuese administrative, të forta mjaftueshëm për të minimizuar rreziqet për korrupsionin. Fokusi atëherë është në përshtatshmërinë e rregullave (cilësisht) të mira, udhëzimeve, procedurave për t'u marrë me aktivitetet e cenueshme. Nëse ka një boshllëk, do të bëhen rekomandime për të forcuar rezistencën kundër korrupsionit dhe për t'i futur ato në organizatë.

Vlerësimet e riskut duhet të zbatohen në përputhje me ISO 31010/2009 - Menaxhimi i riskut dhe teknikat e vlerësimit të riskut dhe / ose Udhëzuesi i metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit (Projekti CoE - PACA, 2010).

Nr	Masa/Aktivitete	Institucioni Përgjegjës/Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor				

				<b>2019</b>				
A.8.1	Hartimi i manualit udhezues mbi analizen e riskut si pjese e planeve te integritetit	KKK		Buxheti i shtetit <hr/> 1,248,000 lekë financiar nga PNUD	Manuali i hartuar dhe aprovuar	Harmonizimi, vlersimi dhe analizimi me i mire i riskut per shkeljen e integritetit te punonjësve	Në proces	Në dhjetor, është dorëzuar draft manual/metodologji për vlerësimin e riskut të integritetit në institucionet e qeverisjes qendrore. Metodologjia përfshin fushat e funksioneve të përgjithshme të institucioneve qendrore si edhe fushat e MD, institucioni lider dhe i parë që po realizon vlerësimin e riskut të integritetit. Dokumenti final pritet të përfundojë brenda muajit shkurt 2020, nga organizata/ekspertet teknikë të kontraktuar për këtë qëllim. Dokumenti final pas vlerësimit do të miratohet nga Ministri i Drejtësisë. <i>Shtyrja në kohë e zbatimit të kësaj masë është si pasojë e vonës së kontraktimit (procedurave) të grupit të ekspertëve që do të zhvillojnë dokumentin.</i>
A.8.2	Trajnime me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve të përfshira mbi implementimin e analizës së riskut si pjesë e planeve të integritetit	KKK/ Të gjitha Ministrinë		Buxheti i shtetit <hr/> 194,500 lekë financiar nga PNUD  <b>4,200 lekë MM</b>  <b>MBZHR</b> 17,000 lekë	Trajnimet e kryera	Rritja e kompetencave dhe kapaciteteve në zbatimin e vlerësimeve të brendshme të riskut	Në proces	Në varësi të aktivitetit A.8.1. Në muajin dhjetor 2019, janë zhvilluar dy sesione trajnime me stafin e MD mbi “metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore dhe plani i integritetit” si ministria udhëheqëse në këtë proces. Datat e trajnimit janë 23 e 26 dhjetor 2019. <i>Shtyrja në kohë e zbatimit të kësaj masë është si pasojë e vonës së kontraktimit (procedurave) të grupit të ekspertëve që</i>

				AKU 10,000 lekë				<p><i>do të zhvillojnë trajnimin.</i></p> <p><b><u>MBZHR:</u></b> U realizua trajnimi 3 ditor në ambjentet e ASPA, në datat 11, 12 dhe 20 Mars 2019 Për vlerësimin e rrishtit të pikave të kontaktit të antikorrupsionit.</p> <p><b><u>SHSSH:</u></b> Të dy audituesit e strukturës aktuale të Auditimit të Brendshëm të SHSSH kanë kryer trajnimin e vazhdueshëm organizuar nga ASPA në të cilën është përfshirë dhe tema: Analiza e rrishtit. Gjatë vitit 2019 kemi patur një workshop organizuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me OSBE dhe Autoritetin Italian për Antikorrupsionin me temë: <i>Mjetet për parandalimin e korrupsionit dhe planet e integritetit.</i> (MM)</p>
--	--	--	--	--------------------	--	--	--	---



A .8 .3	Implementimi i analizës së riskut nga të gjitha institucionet	KKK/ Të gjitha Ministrinë	Qershor	Buxheti i shtetit  <b>320,830 lekë</b> <b>MM</b> <b>MBZHR</b> 54,000 lekë <b>AZHBR</b> 100,000 lekë	Auditimi i brendshëm i riskut nga çdo institucion	Kuptimi koherent i rreziqeve të korrupsionit brenda secilit institucion	Pa realizuar	<p>Në varësi të realizimit të aktivitetit A.8.1 dhe A.8.2.</p> <p><i>Zbatimi i kësaj mase varet nga zbatueshmëria në kohë e masave që i paraprijnë, A8.1 e A8.2</i></p> <p><b><u>MFE:</u></b> Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe elementëve përbërës të tij bëhet përmes vetëvlerësimit, analizës së treguesve të performancës në këtë fushë, monitorimit në vend dhe shërbimit të pavarur të auditimit të brendshëm. Çdo vit, njësitë publike vlerësohen për performancën e tyre në zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, duke paraqitur arritje dhe mangësi në ndërtimin dhe zbatimin e instrumenteve kryesore të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</p> <p>Në mënyrë të veçantë, për sa i përket zbatimit të një procesi efektiv të menaxhimit të riskut, evidentojmë se njësitë publike janë njohur me konceptin e menaxhimit të riskut dhe rëndësinë e zhvillimit të tij, duke reflektuar një planifikim të përmirësuar të buxhetit që përcakton të gjitha objektivat dhe prioritetet e institucionit, së bashku me programet të cilave u përkasin këto objektiva.</p> <p>Për të adresuar mangësitë që lidhen me krijimin e një mekanizmi efektiv dhe funksional të menaxhimit të riskut,</p>
---------------	---	---------------------------	---------	--	---	---	--------------	---

							<p>Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit ka ofruar asistencë teknike dhe ka kryer një numër aktivitesh me qëllimin kryesor mbështetjen e njësive publike për të garantuar funksionimin e duhur të këtij procesi.</p> <p>Kështu, gjatë një periudhe tre-vjeçare, 10 njësi publike u asistuan në vend, duke punuar së bashku me stafin e tyre për të identifikuar, vlerësuar, kontrolluar dhe monitoruar risqet dhe duke hartuar një regjistër të konsoliduar të riskut për të gjithë njësinë.</p> <p>Janë marrë masa të vazhdueshme për të përmirësuar kapacitetin e punonjësve të administratës publike me qëllim rritjen e efektivitetit të zbatimit të mekanizmave të menaxhimit të riskut. Gjatë vitit 2019, janë zhvilluar 8 seanca 1-ditore trajnimi në bashkëpunim me ASPA për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të administratës publike me fokus të veçantë menaxhimin e riskut (149 pjesëmarrës).</p> <p><b>MM</b> ka përgatitur analizën e riskut në sektorin financiar dhe të auditimit të brendshëm.</p> <p><b><u>MBZHR</u></b></p> <p>Nga të gjitha strukturat janë hartuar regjistrat vjetorë 2019, të cilët janë depozituar pranë Drejtorisë së</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.</p> <p><b><u>AZHBR</u></b></p> <p>Spektori i Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit është struktura përgjegjëse për kordinimin në kuadër të menaxhimit të riskut dhe parandalimit të mashtrimit. Në manualet e procedurave të sektorit janë përcaktuar qartë rregullat që ndiqen për menaxhimin e mashtrimit dhe riskut. Koordinatori i riskut i ndodhur në këtë sektor, mban dhe përditëson periodikisht regjistrin e riskut. Çdo drejtori ka emëruar një koordinator risku i cili raporton në këtë sektor në përputhje me rregullat e përcaktuara në manualin e procedurave për menaxhimin e riskut. Vlerësimi i Riskut bëhet duke marrë parasysh ngjarjet e mundshme negative dhe impakti që ato mund të kenë në arrijten e objektivave të institucionit. Në varësi të këtij vlerësimi bëhet dhe përcaktimi i nivelit të riskut që institucioni është në gjëndje të pranojë. Në këtë kuadër bashkë me Regjistrin e Riskut hartohet edhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut.</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

A .8 .4	Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe/ose denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në të gjitha institucionet e administratës publike dhe agjencitë shtetërore	Task-forca Ndërinstitucionale Antikorrupsion / të gjitha institucionet  KKA (raportues)	Vazhdon	Buxheti i Shtetit /Pa kosto  <b>560,620 lekë MM AZHBR</b>  53,000 lekë  <b>AKU</b> 129,471,962 lekë	Nr. i raporteve të inspektimeve të grupeve të inspektimit  Nr. i masave të marra në përfundim të inspektimeve  Nr. i rasteve të referuara në Prokurori	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike  Garantimi i një administrate publike profesionale, transparente dhe të përgjegjshme  Përmirësimi i indeksit të	Realizuar           Realizuar	<b>Në kuadër të Task Forcës Antikorrupsion</b> , e cila është ngritur me VKM Nr. 241, datë 20 Prill 2018, përfshihen 4 institucione: Ministria e Drejtësisë – Kryeson; Antikorrupsioni – KM; Agjencia e Prokurimit Publik; Inspektoriat Qëndror. Sipas nevojave marrin pjesë në kontrollet e TFA-së dhe institucione të tjera me funksione kontrolli/inspektive. Për muajin janar-qershor 2019, Task Forca Antikorrupsion ka kontrolluar 26 institucione, si dhe janë përfunduar 13 nga këto kontrolle, nga të cilat janë rekomanduar: <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ 91 masa administrative,</li> <li>➤ 105 masa disiplinore.</li> </ul> Në përfundim të procesit janë realizuar: <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ 65 masa disiplinore</li> <li>➤ 84 masa administrative</li> </ul> <b>MBZHR</b> Në kuadër të platformës së bashkëqeverisjes, rastet e paraqitura për MBZHR raportohen direkt nga Koordinatorit i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje në Kryeministri. <b>AZHBR</b> Në kuadër të platformës së bashkëqeverisjes: gjatë periudhës janar-dhjetor 2019 janë verifikuar dhe u janë kthyer përgjigje 80 ankesave brenda afateve të përcaktuara ligjore.
---------------	---	---	---------	--	--	--	--	---

							<p>Për periudhën raportuese nuk janë paraqitur ankesa për punonjësit e institucionit.</p> <p><b><u>AKU</u></b></p> <p><b><u>Hetime administrative</u></b></p> <p>Për periudhën Janar - Dhjetor 2019 janë kryer 4 (katër) hetime administrative (<i>tre punonjës në tre hetime administrativ dhe shtatë punonjës në një hetimin administrativ</i>).</p> <p>Në strukturën e AKU është ngritur dhe miratuar Njësia për Sinjalizimin, Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në përbërje të cilit është struktura përgjegjëse e Sektorit të Auditimit të Brendshëm.</p> <p><b>Për periudhën Janar – Dhjetor 2019</b> është kryer hetimi për 1 sinjalizim dhe i është kthyer përgjigja sinjalizuesit brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Procedura është përfunduar dhe është përcjell në raportin vjetor të vitit 2019, për veprimtarinë e njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve pranë ILDKPKI.</p> <p>Është ngritur edhe struktura e konfliktit të interesave dhe Antikorrupsion.</p> <p>Lidhur me angazhimin si Autoritet Përgjegjës i ILDKPKI</p> <p>Informojmë se për 2019 janë dorëzuar deklaratat e pasurisë nga zyrtaret e nivelit të mesëm drejtues (të emëruar</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>me procedurë të rregullt rekrutimi në DAP).</p> <p>Është bërë trajnimi i autoritetit përgjegjës për kryerjen e veprimtarive deklaruese On-line.</p> <p><b><u>Aktiviteti i veprimtarisë Inspektuese të AKU-së për 12-mujorin e vitit 2019 është si më poshtë:</u></b></p> <p>Inspektime të kryera në PIK gjithsej <b>68.245</b>.</p> <p>Ngarkesa të kthyera në origjinë <b>46</b>.</p> <p>Numri i ngarkesave të asgjësuar <b>4</b>, në sasinë prej <b>22.3 Ton</b>.</p> <p>Janë marrë <b>3017</b> mostra për vitin 2019.</p> <p>Inspektime të kryera në terren <b>29,206</b>.</p> <p>Masa “Paralajmërim” <b>7,487</b>;</p> <p>Gjoha në numër <b>904</b></p> <p>Gjoha në vlerë <b>259,150,000 lek</b>.</p> <p>Bllokime <b>565,1 ton dhe 1,467 litra, 13,930 kokrra vezë</b></p> <p>Asgjësime <b>3,316 ton dhe 62,111 litra, 73 fidanë</b>.</p> <p>Ndërprerje aktiviteti <b>172 raste;</b></p> <p><b>AUDITIME 8</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 1 performance.</li> <li>- 7 i kombinuar dhe përputhshmërisë</li> </ul> <p><u>Rekomandime të dhëna gjithsej 88:</u></p> <p>masa për përmirësimin akteve rregullative <b>5 (pesë):</b></p> <p>Masa për përmirësimin e sistemeve <b>13:</b></p> <p>masa organizative <b>45:</b></p> <p>masa zhdëmtim dëmi <b>23:</b></p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>Rekomandim për fillimin e ecurisë disiplinore <b>2:</b>          Auditim tematik <b>1</b> “Për procedurën e licencimit”,<b>4</b> masa organizative.  <u><b>Procedura Disiplinore</b></u>          Për periudhën e kërkuar Janar 2019 - Qershor 2019 kemi këtë pasqyrim të veprimtarisë së Komisionit Disiplinor.          Procedura disiplinore të zhvilluara <b>62</b>          Procedura disiplinore në proces <b>7</b>          Ndërprerje të ecurive disiplinore <b>19</b>          Largim nga shërbimi civil <b>15</b>          Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë deri në dy vjet, përfshirë rritjen në shkallën e pagës <b>15</b>          Vërejtje <b>6</b>  <u><b>Ministria e Mbrojtjes</b></u>          Gjatë vitit 2019 nuk kemi raste të denoncimit të zyrtarëve për korrupsion. Nisur nga specifika e Forcave të Armatosura kemi raste të ushtarakëve të cilëve u janë dhënë masa disiplinore jo për korrupsion apo shpërdorim detyre, por bazuar në ligjin specifik për ushtarakët.  <u><b>MSHMS</b></u>          Nga 19 auditime të planifikuara për vitin 2019 në subjektet e varësisë të MSHMS, janë kryer 20 auditime (një auditim me urdhër të Ministrit)</p> <p>Janë dhënë 63 rekomandime për përmirësimin e funksionimit të kontrolleve të brendëshme. Në raport</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>me gjetjet, janë lënë rekomandime për të dhënë masa ndëshkuese (nuk jep e propozon auditi masa nominalisht me emra) sipas përgjegjësisë dhe proporcionalitetit të parregullësive të gjetura.</p> <p>Jane lënë për të vazhduar procedurat ligjore për zhdëmtim në shumën 648,000 lekë (shifër e përafërt pasi raporti mbyllet në mes të muajt shkurt).</p> <p>Nga verifikimi dhe kontrolli i ushtruar në Spitalin Rajonal, Dibër, bazuar në një denoncim anonim, u konstatuan veprime të keqëmenaxhimit të rëndë financiar dhe dyshime për vepër penale. Eshtë rekomanduar Drejtorit të Spitalit Rajonal, Dibër të referojë çështjen në prokurori. Drejtori ka zbatuar rekomandimin, çështja është referuar në Prokurorinë e Rrethit gjyqësor, Dibër</p> <p><b><u>Shërbimi Social Shtetëror:</u></b></p> <p>A- Drejtoria e Monitorimit të Shërbimeve Sociale në zbatim të Ligjit Nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 ka kryer, monitorime në 28 Institucione Publike e jo Publike të Përkujdesit Social. Gjithashtu Drejtoritë Rajonale të SHSSH periodikisht monitorojnë në 40 qendrat publike dhe jopublike në nivel Qarku.</p> <p>-Janë lënë 171 rekomandime në 26</p>
--	--	--	--	--	--	--	---



							<p>IPSH-të publike. Prej tyre:</p> <p>35 rekomandime për përmirësim të kushteve fizike të godinave.</p> <p>96 rekomandime për plotësim të standardeve dhe përmirësim të cilësisë së shërbimit.</p> <p>40 rekomandime për plotësim të strukturës me staf.</p> <p>Masat disiplinore në periudhën Janar-Dhjetor 2019:</p> <p>-Dy masa disiplinore “Largim nga puna”, të dy punonjësve në IPSH për thyerje rregullore.</p> <p>-Një “Vërejtje me shkrim” për mos zbatimin e rregullores së institucionit.</p> <p>B- Sektori i Auditimit të Brendshëm Janar- Dhjetor 2019 ka kryer 11 auditime përputhshmërie dhe financiar dhe janë lënë:</p> <p>100 rekomandime për përmirësimin e sistemeve të veprimtarisë.</p> <p>Është kërkuar kthimi në vlerën 1.477 mijë lekë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 99 mijë lekë (3 raste) përfituar pagë grupi jo sipas legjislacionit</li> <li>- 265 mijë lekë pagë dëmshmëri shëndeti përfituar jo në zbatim të akteve në fuqi (11 persona).</li> <li>-63 mijë lekë pagesë shpenzime hoteli të pajustificuara sipas legjislacionit.</li> <li>-860 mijë lekë nga kontraktuesi i furnizimit catering gjetje nga sistemi i prokurimeve (1 rast)</li> </ul>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>-27 mijë lekë detyrim për tatim në burim,</p> <p>-28 mijë lekë likuidim shpenzime qera jashtë periudhës së kontratës</p> <p>-135 mijë lekë blerje mallrash të pa përcaktuar e specifikuar. (2 raste)</p> <p>C Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe AK</p> <p>Gjatë vitit 2019 në bazë të planit vjetor të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm SHSSH nëpërmjet 12 Drejtorive Rajonale ka kontrolluar 243 njësi vendore lidhur me zbatimin e legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizur.</p> <p>Gjatë kontrolleve të ushtruara janë konstatuar 1719 familje të cilët kanë përfituar NE në kundërshtim me legjislacionin me dëm ekonomik 18.126.585 lekë. Nga 1719 familjet e evidnetuara me shkelje: 1538 prej tyre janë konstatuar raste me gabime dhe 189 raste të konstatuara si mashtrim në zbatim të metodologjisë së kontrollit të ndihmës ekonomike.</p> <p>Janë konstatuar pagesa në kundërshtim me legjislacionin për personat me aftësi të kufizuar dhe invalid pune për 585 përfitues me dëm ekonomik 9.897.018 lekë.</p> <p>Për shkeljet e konstatuara janë propozuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 99 masa disiplinore,</li> <li>- 1 gjobë</li> </ul>
--	--	--	--	--	--	--	--

								<p>-141 raste shpërblim dëmi.</p> <p>D -Për shkeljet e konstatuara në zbatimin e Kodit të Etikës është dhënë masë disiplinore “Vërejtje” për një punonjës.</p> <p>DAB e FSDKSH (1 Janar-31 Dhjetor 2019)</p> <p>U përgatit projekt raporti, raporti final si dhe rekomandimet dhe u evaduan rezultatet përfundimtare mbi auditimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Fondit. U auditua dhe u evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale Fier.</p> <p>U auditua dhe u evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale të Fondit Berat.</p> <p>U auditua dhe u evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Degën e Fondit Lushnje.</p> <p>U auditua dhe u evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale të Fondit Lezhë.</p> <p>U auditua dhe u evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale të Fondit Kukës.</p> <p>U auditua dhe u evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale të Fondit Durrës.</p> <p>U auditua dhe u evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale Tiranë.</p> <p>U auditua dhe evaduan rezultatet</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale Vlorë.</p> <p>U auditua dhe evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Degën e Fondi Pogradec.</p> <p>U auditua dhe evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale Elbasan.</p> <p>U auditua dhe evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë e Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terciare (DAPSHET)</p> <p>U auditua dhe evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale Dibër.</p> <p>U auditua dhe evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale Korçë.</p> <p>U auditua dhe evaduan rezultatet përfundimtare të auditimit për Drejtorinë Rajonale Shkodër.</p> <p>Ka filluar auditimi i aktivitetit të Fondit për vitin 2019.</p> <p>U realizuan auditime tematike në DIAS në Fond, DRF Dibër- QSH Kala e Dodës Dibër -, QSH Kamëz, Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse në Fond, Qendrën Shëndetësore të Specialiteteve Nr.1 Tiranë - ku janë evaduar rezultatet përfundimtare.</p> <p>Janë evaduar materialet përfundimtare për 15 njësi shpenzuese rajonale dhe</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>Drejtorinë e Përgjithshme të Fondit (auditimi për vitin 2018 i përfunduar në Shkurt të viti 2019) ku janë rekomanduar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> 254 masa organizative,</li> <li><input type="checkbox"/> 5 masa zhdëmtuese në shumën gjithsej 948 mijë lekë</li> <li><input type="checkbox"/> 28 masa disiplinore për 4 njësi shpenzuese, 6 njësi shpenzuese u është rekomanduar Drejtuesëve të njësi përkatëse marrja e masave disiplinore, ndërsa për 5 njësi të tjera nuk janë rekomanduar masa disiplinore.</li> </ul> <p>Drejtoria e Kontrollit e FSDKSH (Janar – Dhjetor 2019):</p> <p>Në total nga Sektori i Kontrollit të Mjekëve për periudhën Janar- Dhjetor 2019 janë kontrolluar 373 mjekë dhe 147 Qendra shëndetësore.</p> <p>Në përfundim të kontrolleve janë marrë masat administrative si më poshtë:</p> <p>Detyrim shpërblim dëmi në vlerën 2,665,506 lekë në total;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Gjoba në vlerën 360,000 lekë në total;</li> <li>· Kushte penale në vlerën 139,000 lekë në total.</li> </ul> <p>Nga Sektori i Kontrollit të Farmacive për periudhën Janar- Dhjetor 2019, janë kontrolluar në total 131 subjekte farmaceutike dhe janë marrë masat si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Gjobë në vlerën 28,000 lekë për 4</li> </ul>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>subjekte farmaceutike;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Detyrim shpërblim dëmi në vlerën 10,789,846 lekë për 132 subjekte farmaceutike;</li> <li>· Kushte penale në vlerën 138,000 lekë, ndaj 10 subjekteve farmaceutike.</li> </ul> <p>Spektori i Kontrollit të Depove për periudhën Janar- Dhjetor 2019, ka kontrolluar 2 depo me inventar dhe 29 depo me disponibilitet dhe 1 farmacie e QSUT-së.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Kushte penale në një vlerë totale prej 4,753,519 lekë.</li> </ul> <p>Spektori i Kontrollit të Spitaleve për periudhën Janar- Dhjetor 2019, ka kontrolluar 15 spitale dhe ka marrë masat si më poshtë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Kushte penale në një vlerë totale prej 383,000 lekë.</li> <li><input type="checkbox"/> Detyrim shpërblim dëmi në vlerën 12,321,042 lekë.</li> <li><input type="checkbox"/> Detyrimi i prapambetur i lënë si mase organizative 4,622,019 lekë.</li> </ul> <p><b>ISHP:</b> Ka pasur një rast për hetim administrativ në institucion.</p> <p>Nuk ka patur rast për periudhën Janar-Dhjetor 2019</p> <p><b>MSHMS:</b> Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB) ka kryer një inspektim në Spitalin rajonal Shkodër për procedurë prokurimi. Rezulton se procedura ishte anuluar konform rregullave.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>Dy referime (rekomandime për kallzim penal) në Prokuri nga auditimi i brendshëm (AB) në DSHP Dibër. Spitali Lushnje, rekomandime për kallzim penal nga (AB).</p> <p>Në DRSHP Durrës dhënë rekomandim për masa zhdëmtimi për shkak të abuzimit me fonde të Zv Drejtorit njëkohësisht dhe vlerësim për qëndrimin ose jo në detyrë nga strukturat eprore.</p> <p><b><u>Ministria e Drejtësisë</u></b> Gjatë periudhës janar – dhjetor 2019, janë dhënë 4 masa disiplinore për punonjësit e aparatit.</p> <p><b><u>Agjencia Kombëtare e Falimentit.</u></b> AKF nuk ka konstatuar asnjë rast korrupsioni si dhe nuk ka dhënë asnjë masë disiplinore apo administrative.</p> <p><b><u>Komiteti Shqiptar i Birësimeve.</u></b> -Gjatë vitit 2019, për institucionin nuk ka patur asnjë denoncim për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare. Në këto kushte, nuk ka patur asnjë vendosje të masave disiplinore apo administrative.</p> <p><b><u>Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Burgje.</u></b> Përsa i përket strukturave të kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë është vijuar me kontrollet dhe inspektimet sipas programeve të miratuara dhe detyrave të vëna nga</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

							<p>Ministri i Drejtësisë. Gjithashtu janë marrë masat e nevojshme për qëndrimin në gadishmëri duke mbuluar të 24 IEVP-të, në 24 orë në ditë.</p> <p>Për periudhën Janar-Dhjetor 2019, për punonjësit e këtij shërbimi janë dhënë në total 6 masa disiplinore "Vërejtje me shkrim". Arsyet e dhënies së masave kanë të bëjnë me shkelje të lehta disiplinore për shkak të moszbatimit në kohë të urdhërave të eprorit, mosdhënien në kohë të informacionit, si dhe moskryerja e raportimeve periodike të vazhdueshme.</p> <p>Për vitin 2019 janë referuar në total 69 vepra penale me 88 autorë, në ngarkim të punonjësve të Sistemit të Burgjeve më konkretisht: 50 janë punonjës policie prej të cilëve 13 janë të arrestuar. 25 punonjës administrate, nga të cilët 1 i arrestuar. Gjithashtu janë referuar edhe 8 drejtues IEVP-je, 1 i arrestuar, si dhe 5 shefa policie.</p> <p><b><u>Agjencia e Trajtimit të Pronës.</u></b></p> <p>Agjencia e Trajtimit të Pronave, për periudhën janar – dhjetor 2019, nga Grupi i Inspektimit të ngritur në ATP ka përfunduar 6 raporte inspektimi. Është marrë masa disiplinore e “Largim nga detyra” dhe “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” për 2 nga punonjësit.</p> <p><b><u>Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit</u></b></p>
--	--	--	--	--	--	--	--



							<p><b><u>Përmbardimor.</u></b>  Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbardimit ka vijuar me procesin e monitorimit dhe kontrollit të zbatimit të ligjit në veprimtarinë procedurale dhe administrative të shërbimit përmbardimor gjyqësor shtetëror, nëpërmjet inspektimeve dhe kontrolleve me bazë ankesat dhe inspektimet dhe kontrollet sipas programit të miratuar.</p> <p>Nga kontrollet dhe inspektimet e realizuara për vitin 2019, gjithsej 8 (tetë) raporte, bazuar në rekomandimin e të cilëve janë marrë 11 (njëmbëdhjetë) masa disiplinore ndaj përmbarduesve gjyqësorë për shkelje të konstatuara në veprimtarinë procedurale, 2 (dy) prej tyre janë masa disiplinore “shkarkim nga detyra”, 6 (gjashtë) masa disiplinore ndaj përmbarduesve gjyqësorë për shkelje të konstatuar në veprimtarinë e tyre procedurale, 1 (një) masë disiplinore “shkarkim nga detyra” ndaj një nëpunësi të administratës, 1 (një) masë disiplinore “vërejtje” ndaj një nëpunësi të administratës së shërbimit si dhe një masë disiplinore “shkarkim nga detyra” ndaj një punonjësi të administratës së shërbimit.</p> <p><b><u>Instituti i Mjeksisë Ligjore.</u></b>  IML për vitin 2018, në Mars 2018, ka konstatuar një rast, për të cilin është marra masa e largimit nga puna. Rasti</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>është referuar në Prokurori.</p> <p><b><u>ASHGJ.</u></b> ASHGJ nuk ka konstatuar asnjë rast korrupsioni si dhe nuk ka dhënë asnjë masë disiplinore apo administrative.</p> <p><b><u>Qendra e Botimeve Zyrtare.</u></b> Gjatë periudhës janar – dhjetor 2019 QBZ nuk ka konstatuar asnjë rast korrupsioni si dhe nuk ka dhënë asnjë masë disiplinore apo administrative.</p> <p><b><u>Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës</u></b> Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës ka kryer 22 inspektime në zyrat vendore për periudhën Janar-Dhjetor 2019 dhe nuk ka marrë asnjë masë.</p> <p><b><u>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</u></b> Përsa i përket strukturave të kontrollit të brendshëm në D.P. Burgjeve është vijuar me kontrollet dhe inspektimet sipas programeve të miratuara dhe detyrave të caktuara nga titullari. Për vitin 2019 janë realizuar 18 kontrole dhe verifikime në lidhje me rastet apo denoncimet për praktika korruptive apo abuzive në sistemin e burgjeve. Gjatë kësaj periudhe janë kryer 20 veprimtari auditimi, prej të cilave 6 auditime të pjesshme për vlerësimin e performancës, 5 auditime të kombinuara (4 në IEVP dhe 1 në proces në DPB), 7 të tjera me kërkesë të titullarit të institucionit, si dhe 2 auditim</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>dhënie konsulence.</p> <p>Si rezultat i kontrolleve dhe auditimeve janë dhënë këto masa:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Janë larguar nga detyra 6 drejtorë IEVP për shkelje të cilat lidhen drejtpërdrejtë me abuzim me detyrën, madje 4 prej tyre janë në ndjekje penale.</li> <li>- 3 pezullime nga detyra si rezultat i fillimit të procedimit penal nga organi i prokurorisë.</li> <li>-1 punonjës i është dhënë masa largim nga detyra.</li> <li>- 1 punonjës i është dhënë masa “vërejtje me paralajmërim”.</li> <li>- 8 punonjësve ju është dhënë masa “vërejtje me shkrim”.</li> </ul> <p><b><u>Ministria e Kulturës</u></b></p> <p>Ministria e Kulturës ka publikuar dhe shpërndarë posterin për denoncime mbi rastet e abuzimeve në institucionet e varësisë.</p> <p>Mbas shpërndarjes së posterave (gjithsej 30), në numrin jeshil të publikuar në të, kanë ardhur 2 mesazhe, prej të cilave vetëm njëra prej tyre lidhej me institucion në varësi të MK, Parku Kombëtar i Butrintit. Ndaj personit përgjegjës është marrë masa administrative “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”.</p> <p><b><u>MFE:</u></b></p> <p>Ka trajtuar 276 raste</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>(ankesa/denoncime/kërkesë për informim subjekteve, etj.).</p> <p>ka propozuar 167 masa disiplinore për punonjës doganorë, prej të cilave: (80 raste propozim Komisionit Disiplinor;</p> <p>55 raste për kompetencë eprorit direkt</p> <p>32 raste tërheqje vëmendje me shkresë në dosjen personale në DMBNJ)</p> <p>Bashkëpunim me institucione të tjera (Task Forca Antikorrupsion dhe kontrole për Kodin e Etikës), referuar në Komision Disiplinor në DPD;</p> <p>- 76 punonjës</p> <p><b><u>MASR:</u></b></p> <p>Numri i raporteve të inspektiveve të grupeve të inspektimit për periudhën janar-dhjetor 2019, janë si vijon: nga MASR/Aparati janë realizuar 95 inspektive, në të cilat janë dhënë rekomandime për masa sipas natyrës së problematikës.</p> <p>Ndër këto rekomandime janë zbatuar 8 masa disiplinore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Procedim disiplinor për ish Drejtuesen e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Dibër</li> <li>2. Masë disiplinore, shkarkim nga detyra të drejtorit të komanduar të Drejtorisë Arsimore Rajonale, Dibër.</li> <li>3. Masë Disiplinore shkarkim të drejtorit të gjimnazit “Said Najdeni 2”, Peshkopi.</li> </ol>
--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>4. Masë disiplinore “Vërejtje” për drejtoreshën e shkollës “Xhevdet Doda”, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Bulqizë.</p> <p>5. Masë disiplinore “Vërejtje” për Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Universiteti i Sporteve, Tiranë.</p> <p>6. Masë disiplinore “Vërejtje” për 3 anëtarët e Komisionit ad hoc të Vlerësimit të Dosjeve, Universiteti i Sporteve, Tiranë.</p> <p>Numri i raporteve të monitorimeve/vlerësimeve për periudhën maj-dhjetor 2019, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP): janë kryer 29 monitorime në të cilat janë dhënë rekomandime sipas natyrës së problematikës.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar që prej funksionimit të saj, muaji maj, 2019 deri në muajin dhjetor 2019, ka shqyrtuar ankesat e drejtuara në Kryeministri, MASR dhe DPAP si dhe në email-et e ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes, nga prindër, nxënës, mësues, drejtues shkolle. Specialistët e DPAP kanë trajtuar 299 raste të ankesave, nga të cilat 29 raste janë trajtuar nëpërmjet monitorimit të drejtpërdrejtë me autorizim në terren dhe 270 raste</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>(bashkëqeverisja, portal "Mësues për Shqiperinë", procedura levizje paralele, shpërndarja e ngarkesës mësimore, vlerësim karte performance, mesues ndihmes etj.) nëpërmjet komunikimit me ZVAP/DRAP-të dhe shqyrtimit të dokumentacionit të derguar.</p> <p>Nga DPAP janë bërë 10 rekomandime dhe nuk ka patur raste për referim në prokurori.</p> <p><b><u>Ministria e Mjedisit dhe Turizmit</u></b></p> <p>Ka marrë masa për të zbatuar vendimet e Task Forca ndërinstytucionale. Kështu nga masat e dhëna për 28 punonjës 22 prej tyre janë zbatuar siç kërkohet nga Task Forca në disa raste kanë qënë dhe më të rënda. Ndërsa për 6 punonjë komisioni i shqyrtimit i ngritur për këtë qëllim nga vlerësimi i situatës dhe provave ka vendosur te mos merrej masa e propozuar.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

N r	Masa/aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/ Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën <b>janar-dhjetor 2019</b>	Përshkrimi i arritjeve për periudhën <b>janar-dhjetor 2019</b>
			2019	Alokimi për periudhën <b>janar-dhjetor 2019</b>				
A .9 .1	Përgatitja dhe miratimi i Manualit mbi hartimin e planeve të integritetit	KKK		Buxheti i shtetit  3,555,000 lekë financuar nga PNUD	Manuali I hartuar dhe miratuar	Rritja e integritetit të administratës publike	Në proces	Ministria e Drejtësisë ka nisur procedurën për hartimin e planeve të integritetit me anë të shkresës nr. 8087, datë 24/09/2018. Manuali është në proces finalizimi. Në dhjetor 2019, drafti po plotësohet me objektivat dhe përgjegjësitë specifike të drejtorive dhe stafit teknik, të fushës së përgjegjësisë së MD. Drafti final pritet të dorëzohet për vlerësim në MD, nga ekipi i ekspertëve të pavarur brenda muajit shkurt 2020.  <i>Shtyrja në kohë e zbatimit të kësaj mase është si pasojë e vonësës së kontraktimit (procedurave) të grupit të ekspertëve që do të zhvillojnë dokumentin.</i>
A .9 .2	Trajnime me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve të përfshira mbi planet e integritetit	KKK/ Të gjitha Ministrinë	Prill	Buxheti i shtetit  194,500 lekë financuar nga PNUD <b>7,600 lekë</b>	Trajnimet e kryera	Rritja e integritetit të administratës publike	Në proces	Ministria e Drejtësisë ka nisur procedurën për hartimin e planeve të integritetit me anë të shkresës nr. 8087, datë 24/09/2018. Në muajin dhjetor 2019, janë zhvilluar dy seanca trajnime me të gjithë stafin e MD, si ministria udhëheqëse në këtë proces mbi “Komunikimi, mobilizimi i stafit të MD për procesin dhe ngritja e kapaciteteve (trajnime) mbi

								Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut”. Datat e trajnimit janë 23 e 26 dhjetor 2019. <i>Shtyrja në kohë e zbatimit të kësaj mase është si pasojë e vonesës së kontraktimit (procedurave) të grupit të ekspertëve që do të zhvillonin trajnimet.</i>
A . 9 . 3	Hartimi/miratimi/ implementimi i planeve të integritetit nga të gjitha institucionet	KKK/ Të gjitha Ministrinë	Tetor	Buxheti i shtetit	Plan integriteti i hartuar nga çdo institucion	Rritja e integritetit të administratës publike	Pa realizuar	Në varësi të aktivitetit A.9.1 dhe A.9. Zbatimi i kësaj mase varet nga zbatueshmëria në kohë e masave që i paraprijnë, A.9.1 e A.9.2. MFE Kemi hartuar /implementuar një Plan Integriteti për vitin 2019 ku përmban informacion mbi etikën, kodin e mirësjelljes, reagimi ndaj sjelljeve profesionale të papranueshme. Gjatë 12-mujorit ka nisur implementimi i një Test Integriteti, i cili është ende në proces verifikimi/shqyrtimi. DPD ka kryer 2 (dy) Teste Integriteti.

**Objektivi A.10** Analizimi i prirjeve të korrupsionit dhe përmirësimi i statistikave në lidhje me veprimtarinë e agjencive ligjzbatuese kundër korrupsionit

**Gjendja aktuale për këtë objekt**

Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë çdo gjashtë muaj dhe në çdo vit mbledh, statistika të harmonizuara dhe të konsoliduara mbi korrupsionin. Kur përfundohen çdo gjashtë muaj dhe në çdo vit, raporti i dërgohet Komisionit Europian. Ato janë publikuar një në vit si pjesë e raportit vjetor të statistikave.

Informacioni është gjeneruar nga Drejtorja e Përgjithshme e Politikave; Prokuroria, Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë si dhe institucionet e reja që do të krijohen në sistemin e drejtësisë dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.

Pasi informacioni është mbledhur dhe analizuar në fazën e fundit të gjitha statistikave harmonizohen përpara se të publikohen. Raporti i statistikave vjetore



ka një kapitull të veçantë dedikuar korrupsionit.

Procesi i grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave do të përforcohet për të siguruar që statistikave të harmonizuara dhe të konsoliduara të përfshijnë të dhëna relevante sipas praktikave më të mira ndërkombëtare përkatëse, ndër të tjera rekomandimin e FATF 33 për statistikave. Statistikave të harmonizuara dhe të konsoliduara do të bëhen një mjet operativ për të raportuar, ndër të tjera, mbi indikatorin B1, dhe çdo tregues tjetër që lidhet me ndëshkimin e korrupsionit. Një numër kriteresh themelore cilësore do të karakterizojnë raportin statistikor, duke siguruar aftësinë e tij për të gjetur një rast nga hetimi në dënim.

### **Treguesit e performancës/ Indikatori:**

#### **Statistikave të harmonizuara dhe konsoliduara mbi korrupsionin prodhohen dhe publikohen periodikisht**

##### **Indikatori për Objektivin A.10, është realizuar në masën 100%.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Statistikave prodhohen dhe publikohen një herë në vit; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit të statistikave duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C1, D1; Përmirësimi i mekanizmit të raportimit statistikor duke përfshirë (nga lista e mëposhtme): - A, B, C, D1, D2, D3 dhe të prodhuara dhe të botuara çdo vit.

Një numër kriteresh themelore cilësore duhet të karakterizojnë raportin statistikor, duke siguruar aftësinë e tij për të gjetur një rast nga hetimi në dënim. Përmbledhja e çështjeve, duhet të plotësohet nga një bazë të dhënash, e cila përshkruan situatën specifike:

##### *A. Numri i hetimeve të filluara*

##### *B. Numri i hetimeve të kërkuara nga Prokuroria*

1. Numri i kërkesave për sekuestrim

##### *C. Numri i dënimeve*

1. Numri i kërkesave për sekuestrim të miratuara
2. Numri i kërkesave për konfiskim të miratuara

##### *D. Detajet mbi menaxhimin e aseteve:*

1. Vlera e aseteve të konfiskuara nën menaxhim
2. Vlera e realizuar nga shitja e aseteve të konfiskuara
3. Numri i aseteve të kthyer pronarit
4. Numri i aseteve të shkatërruara
5. Vlera monetare e transferuar në buxhetin e shtetit pas shitjes

Treguesi do të vlerësohet duke matur përmirësimin e mekanizmit të raportimit të statistikave (procesit) dhe publikimit të tij për vit (performancën).

N r	Masa/aktivitet i	Institucioni Përgjegjës/ Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën <b>janar-dhjetor 2019</b>	Përshkrimi i arritjeve për periudhën <b>janar-dhjetor 2019</b>
			2019	Alokimi për periudhën <b>janar- dhjetor 2019</b>				
A 1 0. 1	Përmirësimi i sistemit statistikor (manual), kordinim efikas, mbledhja, përpunimi dhe harmonizimi i stasisitikave të konsoliduara mbi korrupsionin.	MD	Vazhdon	Buxheti i Shtetit - 1.200.701 lekë  1,200,701 lekë	Përmirësimi i tabelës ekzistuese të statistikave të harmonizuara dhe Raporti vjetor i publikuar.	Statistika të përmbledhura dhe gjithëpërfshirëse mbi korrupsionin	Realizuar	Gjatë vitit 2019, janë mbledhur, përpunuar dhe harmonizuar stasisitikat e konsoliduara mbi korrupsionin (Policia e Shtetit, P. Përgjithshme dhe Gjykatat) për vitin 2018, për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2019. Janë analizuar të dhënat statistikore për periudhën gjashtëmuajore të viteve 2017-2018. Gjithashtu janë publikuar të dhënat për asetet e konfiskuara të vitit 2018, si dhe janë mbledhur këto të dhëna edhe për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2019.

**Objektivi A.11** *Adoptimi i politikave kunder korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore*

**Gjëndja aktuale për këtë objektiv**

Planet e integritetit për bashkitë janë një domosdoshmëri dhe një objektiv specifik i strategjisë.

Duke e zbatuar udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë, bashkitë do të ndihmohen nga kordinatori kombëtar dhe MB për të krijuar një plan integriteti, me qëllim parandalimin e korrupsionit në shërbimet e ofruara prej tyre.

Megjithëse disa bashki kanë miratuar strategji / plane kundër korrupsionit, ato do të krahasohen me udhëzimet kombëtare dhe duhet t'u caktohen buxhetet specifike në mënyrë që të jenë të zbatueshme dhe të kenë ndikim në korrupsion.

**Treguesit e performances/Indikatorit:**

**A.11.a: Përqindja e bashkive që kanë zhvilluar masa lokale mbi anti-korrupsionin dhe plane integriteti në nivel lokal** (në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër korrupsionit)

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Udhëzimet e krijuara (referojuni A9). MB dërgon udhëzime për të gjitha bashkitë; Udhëzimet e shpërndara në mënyrë aktive nga MB për të gjitha bashkitë, ndër të tjera nëpërmjet sesioneve të mundshme informuese dhe 5 bashki prodhuan dhe miratuan një plan lokal të integritetit; 10 bashki prodhuan dhe miratuan një plan lokal të integritetit, respektivisht.

Një plan integriteti do të ofrojë kornizën konceptuale për politikën dhe masat për të parandaluar shkeljet e integritetit të zyrtarëve publikë dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në një institucion publik. Ai përmban informacion mbi (i.a.):

-Fusha specifike të korrupsionit në bashki.

-Etika dhe fushat e integritetit personal, p.sh. kodi i Etikës, pranimi i dhuratave, raportimi i korrupsionit (duke përfshirë "sinjalizimin"), veprimet disiplinore (të regjistruara), reagimi ndaj sjelljeve morale dhe profesionale të papranueshme, trajnimi mbi etikën;

-Mjet për vlerësimin e riskut.

-Një vizion për luftën kundër korrupsionit në bashki

Nxitja e planeve të integritetit në nivel local do të krijojë gjithashtu mundësi të mëtejshme për qytetarët që të bëjnë përpjekjet anti-korrupsion dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive ndaj tyre.

Bashkitë do të zhvillojnë planin e tyre të integritetit bazuar në Udhëzimet e miratuara për zhvillimin dhe zbatimin e një plani të integritetit, të hartuar nga MD / KKK (referojuni A9).

Performanca do të vlerësohet së pari nga krijimi i udhëzimeve (procesit) dhe më pas nga rritja e numrit të përgjithshëm të planeve të integritetit lokal të miratuara dhe të publikuara (performanca).

**Indikatori A.11.a për Objektivin A.11, është i realizuar në masën 10%.**

#### **A.11.b: Numri i bashkive që përcaktojnë një linjë specifike buxheti për të implementuar politikën lokale anti-korrupsion**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 5 bashki ndajnë një përqindje të buxhetit për zbatimin e planit lokal anti-korrupsion për vitin 2020.

Alokimi i linjave specifike të buxhetit për të zbatuar planin vendor është vendimtar për të siguruar efektivitetin dhe ndikimin e planit, si dhe performancën e përgjithshme në luftën kundër korrupsionit në nivel lokal.

Performanca do të vlerësohet së pari duke matur numrin e përgjithshëm të bashkive të cilat kanë ndarë një përqindje të dedikuar të buxhetit vjetor, që do të dakordohet me secilin prej tyre individualisht për zbatimin e planit të integritetit lokal.

Nr	Masa/Aktivitet e	Institucioni Përgjegjës/Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
A111	Përgatitja e një modeli për tu adoptuar nga Bashkitë në bashkëpunim me Departamentin e Kryeministrisë.	MB / Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		Buxheti i Shtetit /Kosto Administrative  5,059,772 lekë nga donatorët	Modeli i plotësuar në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit	Një model gati për tu adoptuar nga Bashkitë	Realizuar	Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar përgatitja e Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes. Materialet i janë nënshtruar konsultimit publik dhe më pas janë reflektuar të gjitha sygjerimet e mbledhura gjatë këtij procesit të konsultimit. Metodologjia e Vlerësimit të riskut të integritetit dhe Kodi standart i sjelljes i janë dërguar për mendim dhe ILDKPK, KDIMDP dhe MD të cilat kanë shprehur vlerësimin e tyre mbi materialet e paraqitura.
A112	Adoptimi i modelit me modifikimet e nevojshme nga 10 Bashki. Adoptimi nga Bashkitë që aktualisht kanë plane për amendimet e nevojshme. Dërgimi i modelit 10	MB / Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Tremujori 4	Buxheti i Shtetit /Kosto Administrative  Konferenca të mundshme të mbështetura nga donatorët  7,529,886 lekë nga donatorët	Adoptimi nga bashkitë i modelit "tailor-made" në specifikat e tyre	Bashkitë kanë plane integritet i/antikorrupsioni me qëllim për të punuar në fushat më të ndjeshme	Në proces	Gjatë vitit 2019, janë organizuar 4 takime Informuese rajonale në qytetet: Tiranë, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, ku morën pjesë përfaqësues të 61 bashkive dhe prefekturave të vendit. Në takimet rajonale, u prezantuan: a) Metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Integritetit (Metodologjia VRI) për Vetëqeverisjen Vendore; b) Modeli Standard i Kodit të Sjelljes. Takimet u kryesuan nga Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK) dhe Ministria e

	Bashkive të zgjedhura me qëllim që ato të diskutojnë dhe adoptojnë atë në Këshillin Bashkiak. Mbështetje teknike për finalizimin e modelit.					në një mënyrë strategjik e.		<p>Brendshme/ Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), organizuar nga IDM. Gjithashtu janë organizuar takime koordinuese me 6 Bashkitë (Elbasan, Mat, Patos, Mallakastër, Gjirokastrë dhe Durrës) të cilat kanë dalë vullnetare për të pilotuar metodologjinë e riskut të integritetit.</p> <p>Me vendim të Këshillave Bashkiak janë miratuar planet e integritetit për Bashkinë Elbasan, Mat, Mallakastër dhe Patos. Ndërsa për Bashkinë Durrës dhe Gjirokastrë është përfunduar hartimi i planeve respective të integritetit dhe pritet miratimi i tyre nga Këshillat Bashkiak.</p>
A 1 1 .3	Adoptimi i planit të antikorrupsionit nga më shumë së 20 bashki. Dërgimi i modelit 20 Bashkive të zgjedhura me qëllim që ato të diskutojnë dhe adoptojnë atë në Këshillin Bashkiak.	MB / Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		Buxheti i Shtetit /Kosto Administrative	Adoptimi nga bashkitë i modelit "tailor-made" në specifikat e tyre	Bashkitë kanë plane integritet i/antikorrupsioni me qëllim për të punuar në fushat më të ndjeshme në një mënyrë strategjik	2020	Ky aktivitet është parashikuar të realizohet gjatë vitit 2020.

						e.		
A 1 1 4	Inkurajimi i 10 bashkive të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e planit lokal në përputhje me Strategjinë Kombëtare	MB / Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Lokale		Buxheti i Shtetit /Kosto Administrative	Përcaktimi i një buxheti specifik për implementimin e masave specifike të planit lokal.	Rritja e transparencës në punën e qeverisë vendore/lokale	T3 2020	Ky aktivitet është parashikuar të realizohet në T3 2020.

- Qasja ndëshkuese – B

### **Objektivi B.1 Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit**

Treguesit e performances/Indikatorit:

#### **B.1.a: Numri i hetimeve për rastet e korrupsionit (rastet dhe personat)**

#### **Për objektivin B.1 indikatorin B.1.a, është arritur 100%.**

Objektivat për tu arritur në, 2019 dhe 2020 janë: rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe pandehurve të dërguar në gjykatë; rritja me 5 % krahasuar me vitin paraardhës e numrit të çështjeve dhe pandehurve të dërguar në gjykatë.

Hetimet, të zbatuara nga agjencitë e zbatimit të ligjit nën kordinimin dhe udhëheqjen e Prokurorisë, do të çojnë në përgatitjen e akuzës nga Prokuroria dhe paraqitjen e tyre në Gjykatë. Rritja e efektivitetit të hetimeve pritet, ndër të tjera, të rritë numrin e akuzave. Një vlerësim i plotë do të marrë në konsideratë rastet dhe personat.

Performanca do të vlerësohet duke matur rritjen e numrit të përgjithshëm të akuzave për korrupsion. Treguesi do të matet si nga numri i rasteve dhe numri i

personave të përfshirë në akuza.

Një nën-tregues shtesë përfshihet, për të vlerësuar performancën në kontekstin e veçantë të të ashtuquajturave "raste të korrupsionit në nivel të lartë". Në këtë kuadër, "rastet e nivelit të lartë" përcaktohen si ato që lidhen me nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal (që parashikojnë një dënim minimal prej 1 dhe 4 vjet). Llogaritja e raportit/përqindjes do të kryhet si:

- Nën-treguesi B.1.a.1: Raporti i aktakuzave të "korrupsionit të nivelit të lartë", mbi numrin e përgjithshëm të aktakuzave për korrupsion;

$$R_{\text{KNL}} = \text{shuma (e numrit te hetimeve "korrupsionit te nivelit te larte") / shuma (e numrit te total te padive per korrupsion) X 100\%}$$

SHËNIM: Efektiviteti i hetimit është gjithashtu i lidhur me numrin e aktakuzave që gjenerojnë dënime përfundimtare - ky element (i cili nuk varet vetëm nga hetimet, por, në mënyrë thelbësore, në kryerjen e procedurave gjyqësore) do të matet me Pasaportën e Treguesve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

#### **B.1.b: Numri i kërkesave për sekuestrim të pasurisë në rastet e korrupsionit**

##### **Për objektivin B.1, indikatori B.1.b, është arritur 100%.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: në vitin 2018 të krijohet mekanizmi i raportimit të kërkesave për sekuestrim. Në vitin 2019 sistemi i raportimit do të jetë funksional dhe të dhënat do të raportohen. Në vitin 2020 të arrihet rritja e kërkesave për sekuestrim me 5 % krahasuar me vitin 2019.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi paraqesin një mjet kritik represiv për korrupsionin, duke hequr stimujt financiarë për veprimtarinë kriminale. Rritja e efektivitetit të hetimeve (të cilat ndër të tjera mund të përfshijnë hetime më të mira financiare dhe procedura të gjetjes së asetëve) pritet, ndër të tjera, të rritet numri i kërkesave për sekuestrim të paraqitura nga Prokuroria në Gjykatë.

Deri në fund të vitit 2017, këto të dhëna nuk gjurmohen nga statistikat e Prokurorisë. Mekanizmi përcjellës për statistikat e harmonizuara për korrupsionin dhe krimin e organizuar do të përditësohet për të gjeneruar këto të dhëna dhe të përfshijë shifrën në të gjitha raportet gjashtëmujore.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari përmirësimin e sistemit të ndjekjes (procesit) dhe më pas rritjes së numrit të përgjithshëm të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit (performanca). Treguesi do të matet si nga numri i rasteve dhe numri i personave të përfshirë në akuza.



Një nën-tregues shtesë do të përfshihet, që nga viti 2020, për të vlerësuar performancën në kontekstin e veçantë të të ashtuquajturve "raste të korrupsionit në nivel të lartë". Në këtë kuadër, "rastet e nivelit të lartë" përcaktohen si ato që lidhen me nenet 245 dhe 260 të Kodit Penal (që parashikojnë një dënim minimal prej 1 dhe 4 vjet). Llogaritja e raportit/përqindjes do të kryhet si:

- Nën-treguesi B.2.b.1: Raporti i kërkesave për sekuestrim në rastet "korrupsion në nivel të lartë", mbi numrin e përgjithshëm të kërkesave për sekuestrim në rastet e korrupsionit;

$$R_{KNL} = \frac{\text{Shuma (e numrit te kerkesave per sekuestrim ne rastet e "KNL")}}{\text{shuma (e numrit total te kerkesave per sekuestrim ne rastet e korrupsionit)}} \times 100\%$$

SHËNIM: Efektiviteti i hetimit është gjithashtu i lidhur me numrin e konfiskimeve - ky element (i cili nuk varet vetëm nga hetimet, por, kryesisht, në kryerjen e procedurave gjyqësore) do të matet nga Pasaporta e Treguesve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

### **B.1.c: Vlera e parashikuar e të ardhurave të krimit të sekuestruar në rastet e korrupsionit**

#### **Indikatori B.1.c, nuk është arritur (0%).**

Sekuestrimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi paraqesin një mjet kritik represiv për korrupsionin, duke hequr stimujt financiarë për veprimtarinë kriminale. Hetimet efektive do të gjenerojnë jo vetëm kërkesa shtesë për sekuestrim (shih treguesin B.1.c), por edhe rritjen e vlerës totale të aseteve të sekuestruara. Vlerësimi i këtyre të dhënave shtesë është vendimtar për të dhënë një pasqyrë të plotë të efektivitetit të hetimeve mbi korrupsionin. Bazuar në kuadrin ligjor shqiptar (VKM no.687, dt.5.10.11), asetet për të cilat është miratuar sekuestrimi do të dorëzohen në AAPSK për menaxhim. Pas marrjes së aseteve, Agjencia zbaton një vlerësim të brendshëm dhe cakton një vlerë të parashikuar. Kjo vlerë vlerësohet më tej nga ekspertë të jashtëm pas konfiskimit. Deri në fund të vitit 2017, këto të dhëna nuk gjurmohen nga AAPSK. Mekanizmi i raportimit të brendshëm të Agjencisë do të përditësohet për të gjeneruar këto të dhëna dhe të përfshijë shifrën në të gjitha raportet gjashtëmujore.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari përmirësimin e monitorimit të brendshëm të AAPSK (**procesit**) dhe pastaj rritjes së vlerës së përgjithshme të aseteve të sekuestruara në rastet e korrupsionit (**performancë**).

SHËNIM: efektshmëria e hetimit është e lidhur edhe me vlerën e konfiskimeve përfundimtare - ky element (i cili nuk varet vetëm nga hetimet, por, në mënyrë thelbësore, në kryerjen e procedurave gjyqësore) do të matet me Pasaportën e Indikatorëve të Strategjisë Sektoriale të Drejtësisë.

Nr	Masa/Aktivitete	Institucioni Përgjegjës/Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për				

				periudhën janar- dhjetor 2019			2019	
B .1 .1	Forcimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me gjithë agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër korrupsionit dhe këtyre të fundit dhe gjyqësorit.	PP  MFE, KLSH, MB, ILDKPKI, etj,	Në vijimësi	3,000,000 Lekë  Donator, buxheti i shtetit	Trajnime të kryera, persona të trajnuar	Njohuritë përdoren dhe cilësia e hetimit rritet.	Realizuar	<b><u>Prokuroria e Përgjithshme</u></b> <u>Shkolla e Magjistraturës ka realizuar dy aktivietë trajnuese me pjesëmarrje të prokurorëve me tema: Korrupsioni dhe legjislacioni i brendshëm dhe ndërkombëtar në këtë fushë. Veprat penale të Korrupsionit. Teknikat e hetimit dhe gjykimi i këtyre vepra penale.</u> <u>Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe risitë e tij; Hetimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale. Procesi i të provuarit dhe shndërrimi i barrës së provës. Risitë e shtesave dhe ndryshimeve.</u> <u>Me ftesë të Iniciativës Rajonale Antikorrupsion (RAI), një prokurore mori pjesë në shkollën verore të antikorrupsionit zhvilluar gjatë datave 30 qershor – 4 korrik, në Sarajevë. Tema e aktivitetit ishte “hetimi i rasteve të korrupsionit- mekanizma dhe mjete inovative”.</u> <u>Për objektivin B.1.a indikatori analizohet në vijim:</u>

								<table border="1"> <tr> <td>VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIO NIT (të gjitha nenet sipas raportimit në Statistikën e harmonizuar)</td> <td>Nr. proced dërguar gjyqit.</td> <td>Nr. Pandehurve dërguar gjyqit</td> </tr> <tr> <td>Viti 2018</td> <td>513</td> <td>719</td> </tr> <tr> <td>Viti 2019</td> <td>643</td> <td>841</td> </tr> <tr> <td><b>Trendi në %</b></td> <td><b>+ 25</b></td> <td><b>+ 17</b></td> </tr> </table> <p>Siç vërehet nga të dhënat, objektivi i parashikuar si rritje 5 % për vitin 2019, është arritur.</p>	VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIO NIT (të gjitha nenet sipas raportimit në Statistikën e harmonizuar)	Nr. proced dërguar gjyqit.	Nr. Pandehurve dërguar gjyqit	Viti 2018	513	719	Viti 2019	643	841	<b>Trendi në %</b>	<b>+ 25</b>	<b>+ 17</b>
VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIO NIT (të gjitha nenet sipas raportimit në Statistikën e harmonizuar)	Nr. proced dërguar gjyqit.	Nr. Pandehurve dërguar gjyqit																		
Viti 2018	513	719																		
Viti 2019	643	841																		
<b>Trendi në %</b>	<b>+ 25</b>	<b>+ 17</b>																		
B .1 .2	Krijimi i një sistemi raportimi për të ndjekur kërkesat për sekuestrim dhe aprovimin e tyre	PP	Tremujori i parë  Tremujori i tretë	Buxheti i Shtetit /Pa kosto  _____	Formati i raportimit statistikor dhe procesi i mbledhjes së të dhënave i krijuar  Raportimi periodik	Përcjellja (tracking ) më e madhe e të dhënave për sekuestri min dhe konfiski min e pasurive	Realizuar	<p>Me Udhëzimin nr.6/2018 të Prokurorit të Përgjithshëm u miratua formati statistikor për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave lidhur me sekuestrimet.</p> <p>Të dhënat janë mbledhur, analizuar e publikuar në raportin vjetor të gjendjes së kriminalitetit për vitin 2019.</p>												

B .1 .3	Krijimi i një sistemi raportimi për të përcaktuar vlerën e të ardhurave të krimit të sekuestruar në rastet e korrupsionit	AAPSK	Tremujori i dytë	Buxheti i Shtetit /Pa kosto <hr/> <i>Pa kosto</i>	Formati i raportimit statistikor dhe procesi i mbledhjes së të dhënave u krijua	Përcjellja (tracking) më e madhe e të dhënave për sekuestri min dhe konfiski min e pasurive	Në proces	<p>1. Për periudhën Janar-Dhjetor 2019 kemi një vendim gjyqësor nr.18, datë 27.02.2019 të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, për sekuestrim, por që ishte urdhëruar pezullimi i pasojave të zbatimit të masës së sekuestrimit, deri në dhënien e një vendimi gjyqësor penal dhe duke qenë se procesi gjyqësor penal ka përfunduar, është urdhëruar sekuestrimi i shumave monetare, kështu më datën 13.12.2019, janë sekuestruar nga AAPSK 144,810 Euro dhe 1000 \$.</p> <p>2. Është implementuar sistemi i hedhjes së të dhënave dhe nën monitorimin e firmes zbatuese të projektit, po punohet për të realizuar me sukses hedhjen e të dhenave dhe mund të marrim raporte statistikore nëpërmjet këtij programi. Jemi në proces.</p>
B .1 .4	Trajnimi i stafit të AAPSK për përdorimin e sistemit të ri të raportimit për të përcaktuar vlerën e të ardhurave të krimit të sekuestruar në rastet e korrupsionit	AAPSK	Tremujori i parë  Tremujori i tretë	Buxheti i Shtetit /Pa kosto <hr/> <i>Pa kosto</i>	Trajnime të kryera	Përcjellja (tracking) më e madhe e të dhënave për sekuestri min dhe konfiski min e pasurive	Pa realizuar	Nga komunikimi me ASPA-n për trajnimin e punonjësve të AAPSK-së, rezulton se është bërë me pagesë trajnimi për ata punonjës që nuk kanë statusin e nëpunësit civil. Administratorët e pasurisë së AAPSK-së, janë pa këtë status, kështu që mbetemi në pritje për pagesën për trajnimin e një punonjësi.
<b>Objektivi B. 2 Përmirësimi i bashkëpunimit midis institucioneve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndëshkimin penal të korrupsionit</b>								

**Treguesit e performances/Indikatorit:****B.2.a: Raporti i procedimeve te regjistruara mbi korrupsionin që rezultojnë nga referimet e administruara Për objektivin B.2, indikator B.2.a, nuk është arritur (0%).**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 70%, 75 % dhe 80 % respektivisht, duke konsideruar rritjen me 5 % më shumë çdo vit të këtij raporti.

Të dhënat do t'i raportohen Prokurorisë së Përgjithshme nga Prokuroritë e Shkallës së Parë në përputhje me formatin e tyre të të dhënave.

Zyra për Statistika në Prokurorinë e Përgjithshme do të procesojë të dhënat vetëm për ato nene të Kodit Penal që raportohen në statistikat e harmonizuara nën "korrupsionin".

Performanca do të vlerësohet duke matur numrin e procedurave të regjistruara mbi numrin total të referimeve të administruara x 100

**B.2.b: Numri i shtuar i bazave të të dhënave të aksesueshme për Policinë dhe Prokurorinë****Vlerësojmë se indikator B.2.b për këtë objektivin B.2, nuk është arritur nga Prokuroria e Përgjithshme (Policia e Shtetit, pa raportuar).**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë:

Policia ka akses në 12 baza të dhënash; Policia ka akses në 14 baza të dhënash; Policia ka akses në 16 baza të dhënash.

Shtimi i aksesit në 10 databaza deri në fund të vitit 2020 për Prokurorinë. Shtuar numri respektivisht në vitin 2018 -3; në vitin 2019-3; në vitin 2020-4.

Përmirësimi i aksesit të bazave të të dhënave dhe shënimeve publike nga policia dhe prokuroria është e rëndësishme për rritjen e efektivitetit të hetimeve, ndjekjes penale dhe ndëshkimit të korrupsionit.

Për rritjen e numrit të bazave të të dhënave të disponueshme nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Policisë së Shtetit, të dy institucionet duhet të nënshkruajnë memorandume mirëkuptimi me institucionet që zotërojnë bazat e të dhënave dhe Komisionerin për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit dhe të Dhënave Personale, të sigurojnë financime dhe të kenë staf të trajnuar për përdorim dhe mirëmbajtje.

Performanca do të vlerësohet duke matur numrin e bazave të të dhënave të disponueshme nga Prokuroria dhe Policia e Shtetit.

Nr	Masa/aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor				

				2019																
B.2.1	Zhvillimi i analizave të përbashkëta bazuar në të dhëna statistikore apo për raste konkrete.	PP  MF,KLSH, MB, ILDKP, etj,	Në vijimësi	Buxheti i Shtetit /Pa kosto shtesë	Numri i analizave të zhvilluara	Rritja e cilësisë së referimeve dhe akteve procedurale që pasqyrohet në rritjen e raportit të procedimeve të regjistruara me referimet .	Realizuar	<p><b><u>Prokuroria e Përgjithshme</u></b></p> <p>Në çdo analizë vjetore të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, ftohen për të marrë pjesë e diskutuar përfaqësues të Policisë së Shtetit. Lidhur me çështje konkrete të filluara për vepra penale në fushën e korrupsionit të cilat nuk kanë përfunduar me sukses, zhvillohen analiza të përbashkëta për të gjetur shkaqet dhe zgjidhjet për të ardhmen. Në analiza marrin pjesë si prokurorët dhe oficerët e çështjes por edhe nivele drejtuese.</p> <p>Për objektivin B.2.a, indikatorin analizohet në vijim:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT (të gjitha nenet sipas raportimit në Statistikën e harmonizuar)</th> <th>Nr. proced regj.</th> <th>Nr. Referimeve</th> <th>Raporti në %</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Viti 2018</td> <td>2126</td> <td>3440</td> <td>62%</td> </tr> <tr> <td>Viti 2019</td> <td>2257</td> <td>3538</td> <td>64%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Treguesi nuk është arritur megjithëse</p>	VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT (të gjitha nenet sipas raportimit në Statistikën e harmonizuar)	Nr. proced regj.	Nr. Referimeve	Raporti në %	Viti 2018	2126	3440	62%	Viti 2019	2257	3538	64%
VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT (të gjitha nenet sipas raportimit në Statistikën e harmonizuar)	Nr. proced regj.	Nr. Referimeve	Raporti në %																	
Viti 2018	2126	3440	62%																	
Viti 2019	2257	3538	64%																	

								rezulton rritje 2 % krahasuar me vitin 2018.
B.2.2	Nënshkrimi/rishikimi i memorandumeve/marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese dhe institucioneve të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit.	PP MF,KLSH, MB, ILDKP, etj,	Në vijimësi	Buxheti i Shtetit /Pa kosto shtesë	Memorandume të rishikuara/nënshkuara	Përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitucional operacionale	Realizuar	Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve nënshkruan në Mars 2019, një memorandum bashkëpunimi, për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore. Palët morrën përsipër në këtë memorandum kallzimin e hetimin me përparësi të veprave penale në fushën e zgjedhjeve ku sensitiv është korrupsioni aktiv e pasiv në zgjedhje.
B.2.3	Sigurimi i aksesit të mëtejshëm në bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronik shtetërorë, për kryerjen e hetimeve.	PP	Tremujori 4	25,000,000 Lekë Donator, buxheti i shtetit	Memorandume të nënshkuara	Databazat aksesohet drejtpërdrejt nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore	Në proces	Për periudhën raportuese, është realizuar aksesit në dy databaza për të cilat u lidhën memorandume bashkëpunimi në vitin 2018. Konkretisht: Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Regjistrin Elektronik të Pasurive të Paluajtshme.  Ndërkohë gjatë periudhës raportuese, kemi rënë dakort në parim dhe po vijojmë komunikimet në kuadër të nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit për aksesin në Regjistrin elektronik të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.  Indikatori B.2.b për këtë objektiv nuk është arritur.

								<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Policia e Shtetit ka siguruar aksesin ne bazat e të dhënave dhe në regjistrat elektronike shtetërorë të disa institucioneve si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, DPSHTRR, ZQRPP, QKB, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
B. 2. 4	Kryerja e trajnimeve të përbashkëta mes Prokurorisë, Policisë së Shtetit dhe organeve të tjera ligjzbatuese.	PP, PSH	Tremujori 4	Buxheti i Shtetit _____	Janë zbatuar raportet mbi trajnimet	Kapacitetet te avancuar a profesionale dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet agjencive	Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Gjatë kësaj periudhe janë realizuar: 12 trajnime/seminare, në fushën e Krimeve Ekonomike dhe Financiare, Korrupsionit dhe krimeve në detyrë. Me 34 përfitues nga burimet njerëzore që merren me trajtimin e rasteve të denoncuar nga qytetarët, apo hetime penale në këtë fushë. Trajnimet janë kryer nga: Këshilli i Europës; Akademia e Policisë; Ambasada Amerikane; Zagreb, Kroaci; Budapest, Hungari; Shkup.
B. 2. 5	Nënshkrimi i marreveshjeve të përbashkëta të bashkëpunimit	PP, PSH	Vazhdon	Buxheti i Shtetit _____			Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Në zbatim të V.K.M-së Nr. 06.11.2017 “Për Planin e Veprimit Kundër Krimit të Organizuar”, për krijimin e task



	mes Prokurorisë, Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese.							forcës “Forca e Ligjit”, është krijuar dhe funksionin struktura Task Forca “Forca e Ligjit”, si edhe është lidhur marrveshje bashkëpunimi midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme.
B. 2. 6	Dhënia e aksesit policisë gjyqësore në databazat e institucioneve.	PP	Vazhdon	Buxheti i Shtetit _____	Qasja në bazën e të dhënave e siguruar		Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Është nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Policisë së Shtetit “Për shkëmbimin e informacionit ndërmjet sistemit të menaxhimit policor të çështjes të Policisë së Shtetit dhe sistemit të menaxhimit të çështjes të Prokurorisë”, firmosur nga DPPSH me nr protokolli 4437/3 datë 12.07.2017, ndersa nga Prokuroria e Përgjithshme me nr. Protokolli 1689/2 datë 06.07.2017, për ndërlidhjen e 2 sistemeve të menaxhimit të çështjes mes DPPSH dhe Prokurorisë. Aktualisht është duke u punuar për zbatimin e saj dhe për realizimin e ndërlidhjes së 2 sistemeve.
B. 2. 7	Kryerja e analizave të përbashkëta periodike të punës apo edhe sipas rëndësisë së çështjes.	PP	Vazhdon	Buxheti i Shtetit _____	Zbatimi i seancave të përbashkëta të punës	Rritja e kordinimit ndërmjet agjencive operacionale	Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Gjatë kësaj periudhe janë kryer 227 takime dhe analiza të përbashkëta me Prokurorinë, dhe Agjensitë/Instucione të tjera ligjzbatuese, lidhur me trajtimin e akteve dhe hetimeve të proçedimeve penale.

**Objektivi B.3 Përmirësimi i kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimit ekonomik dhe financiar**

**Treguesit e performancës:**

**B.3.a: Numri i raporteve rishikuese të kryera periodikisht dhe bërja publike nga Ministria e Financave mbi përshtatshmërinë e kuadrit ligjor për ndjekjen penale të krimeve ekonomike dhe financiare.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Zbatimi i një veprimi shqyrtues; Një raport rishikimi publikohet dhe dorëzohet tek politikëbërësit; Një raport rishikimi publikohet dhe dorëzohet tek politikëbërësit, respektivisht.

**Për indikatorin B.3.a të Objektivit B.3, nuk është realizuar (0%).**

**B.3.b: Implementimi i legjislacionit për ngritjen e Zyrës për Rikuperimin e Aseteve.**

**Për indikatorin B.3.b të Objektivit B.3, nuk është raportuar.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë:

N r	Masa/aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/Raportues	Kohëzgjatja/Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
B.3.1	Raport mbi vlerësimin e kuadrit ligjor dhe rekomandimet e krijuara institucionale për ARO.	MFE	Tremujori i 3-të	Buxheti i Shtetit	MF fillon procesin e vlerësimit dhe shqyrtimit.	MF i bën propozim zyrtar qeverisë për fillimin e procesit të krijimit	Pa realizuar	Ky aktivitet është i parealizuar.

						te ARO		
B. 3. 2	Baza ligjore mbi ARO (institucioni pritës dhe procedurat standarde të veprimit) të hartuara nga institucioni përkatës	MFE	Tremujori i 2-të	Buxheti i Shtetit	Draft dokumenti i përgatitur	Draft dokumenti i aprovuar	Pa realizuar	Janë kryer takime ndërmjet Koordinatorëve të MFE, MD dhe MB lidhur me përcaktimin e bazës ligjore të ngritjes së ARO-s dhe është vendosur ngritja e një grupi ndëristitucional të punës, i cili do të zgjidhë problematikat e dala.
B. 3. 3	Miratimi, ngritja dhe operimi i institucionit ARO	MFE		Buxheti i Shtetit	ARO është funksional dhe bërë publik	Zbatimi i ligjit dhe funksioni i ARO	Pa realizuar	Ky objektivi nuk është realizuar ende, pasi pritet që grupi i punës të finalizojë propozimin e tij lidhur me bazën ligjore të ngritjes së këtij institucioni dhe se prej kujt duhet të ketë varësi ky institucion.

***Objektivi B.4 Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor dhe policor ndërkombëtar në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar***

**Gjendja aktuale për këtë objektivi**

Grupet kriminale e kanë shtrirë veprimtarinë e tyre në fushën e krimeve ekonomike e financiare në më shumë sesa në një shtet. Policia e Shtetit ka marrëveshje bashkëpunimi me Interpol dhe Europol si dhe me struktura homologe të vendeve të tjera, për të luftuar këto krime. Bazuar në këto marrëveshje strukturat ligjzbatuese nëpërmjet policisë së shtetit shkëmbejnë informacion në mënyrë të vazhdueshme. Në fokus të punës së policisë së shtetit do të jetë shkëmbimi i informacionit të prodhuar nga policia e shtetit me strukturat homologe për goditjen e krimeve ekonomike e financiare me qëllim organizimin e operacioneve policore të përbashkëta për goditjen e këtyre krimeve.

**Treguesit e performances/Indikatorit:**

**a: Numri i informacionit policor të shkëmbyer me vëndet e treta dhe institucionet ndërkombëtare të zbatimit të ligjit**

***Indikatorit B.4.a për Objektivin B.4, është i realizuar në masën 100%.***

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Përditësimi i procesit të monitorimit të brendshëm për të marrë të dhëna të detajuara të grumbulluara dhe të zbërthyera. Publikimi i të dhënave; Rritja prej 5% në raport me vitin 2018; Rritje prej 5% në raport me vitin 2019, respektivisht.

Rritja e bashkëpunimit operacional me vendet e treta dhe organizatat / rrjetet mbikombëtare të zbatimit të ligjit (duke përfshirë, ndër të tjera, Europol, Interpol, Frontex, Egmont, CARIN, etj). Siç është theksuar në Raportin e Bashkimit European të vitit 2016, "Shqipëria ka një marrëveshje operationale bashkëpunimi me Europol dhe që nga viti 2009 një oficer ndërlidhës në selinë e Europol. Shqipëria mbetet një partner reaktiv dhe jo proaktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar policor. Trende të ngjashme janë vënë re edhe në lidhje me bashkëpunimin me Interpol".

Që nga viti 2017, ndjekja e shkëmbimit të informacionit me vendet e treta dhe organizatat/rrjetet mbikombëtare të zbatimit të ligjit nuk është e standardizuar.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari përmirësimin e procesit të monitorimit të brendshëm të Policisë Shqiptare për të marrë të dhëna të zbërthyera (proces) dhe më pas rritjen e numrit të përgjithshëm të informacionit të shkëmbyer me vendet e treta dhe institucionin mbikombëtar.

**b: Numri i operacioneve të përbashkëta policore të lancuara nga Europol dhe Interpol në fushën e luftës kundër krimit ekonomik dhe financiar në të cilat Shqipëria merr pjesë aktivisht.**

**Indikatori B.4.b për Objektivin B.4, është i realizuar në masën 25%.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 3, 4 dhe 5 respektivisht.

Rritja e bashkëpunimit operacional me vendet e treta dhe organizatat /rrjetet mbikombëtare të zbatimit të ligjit (duke përfshirë, ndër të tjera, Europol, Interpol, Frontex, Egmont, CARIN, etj.). Siç është theksuar në Raportin e Bashkimit European të vitit 2016, "Shqipëria ka një marrëveshje operationale bashkëpunimi me Europol dhe që nga viti 2009 një oficer ndërlidhës në selinë e Europol. Shqipëria mbetet një partner reaktiv dhe jo proaktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar policor. Trende të ngjashme janë vënë re edhe në lidhje me bashkëpunimin me Interpol".

Shkëmbimi i informacionit (shih B.4.1) do të vazhdojë nga bashkëpunimi në nivel operacional, duke përfshirë operacionet e përbashkëta policore.

Treguesi do të vlerësohet duke matur numrin e përgjithshëm të operacioneve të përbashkëta të Policisë Europol dhe Interpol në fushën e luftës kundër krimit financiar dhe ekonomik në të cilin Shqipëria merr pjesë në mënyrë aktive.

N r	Masa/Aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/	Kohëzgjatja/ Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i	Statusi i aktivitetit për	Përshkrimi i arritjeve për periudhën <b>janar-dhjetor 2019</b>
-----	-----------------	--------------------------	--------------------	-----------------------	-----------------------	------------	---------------------------	--

		Raportues	2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019		Impaktit	periudhën janar-dhjetor 2019	
B.4.1	Krijimi i sistemit të brendshëm të monitorimit për të ndjekur shkëmbimin e informacionit me partnerët ndërkombëtarë, Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera me agjensitë partnere të zbatimit të ligjit	Policia e Shtetit		Buxheti i shtetit	Satistika mbi numrin e informacioneve të shkëmbyera me agjensitë homologe, të prodhuara nga Policia e Shtetit.	Rritja e besimit mes agjensive ligjzbatuese homologe në luftën kundër krimit ekonomik e financiar	Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Policia e Shtetit, sipas marrëveshjeve bashkëpunon me “EURPOL, “INTERPOL”, Oficer Ndërlidhës (Kontakti), të Policisë Shqiptare, të atashuar në vende jashtë shtetit, si dhe me Oficer Ndërlidhës (Kontakti), të vendeve të atashuar në Shqipëri., CARIN, SELEK, BAMIN, INTERFORCË, etj. Si dhe dhe mbi bazën e marrëveshjeve dy palëshe me shtete të tjera. Numri i informacioneve të shkëmbyera me agjencitë homologe, gjithsej 1178, në fushën e krimeve ekonomike dhe financiare, (ku përfshihen të gjithë sektorët, krimi ekonomik, pastrimi i parave dhe korrupsioni) si më poshtë: 718 Informacione, me Interpolin. 471 Informacione, me Europolin. 32 informacione me rrjetin e zyrave për gjetjen e rikuperimin e aseteve kriminale CARIN. 11 informacion të ardhura nga Interforca. Krahasur me vitin 2018, gjate vitit 2019 numri i shkëmbimit të informacioneve

								është rritur mbi <b>5%</b> .
B .4 .2	Kryerja e trajnimeve të përbashkëta me strukturat e agjensive partnere	Policia e Shtetit		Buxheti i shtetit	Numri i trajnimeve të kryera	Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në kryerjen e hetimeve të përbashkëta.	Realizuar	<b><u>Policia e Shtetit</u></b> Gjatë kësaj periudhe janë realizuar: 12 trajnime/seminare, në fushën e Krimeve Ekonomike dhe Finnaciare, Korrupsionit dhe krimeve në detyrë. Me 34 përfitues nga burimet njerëzore që merren me trajtimin e rasteve të denoncuara nga qytetarët, apo hetime penale në këtë fushë. Trajnimet janë kryer nga: 1. Këshlli i Europës; 2. Ambasada Amerikane; 3. Akademia e policisë; 4. Zagreb, Kroaci; 5. Budapest, Hungari; 6. Shkup.
B .4 .3	Nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe në luftën kundër krimit	Ministria e Brendshme		Buxheti i Shtetit  Kosto administrative	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara	Kordinim më eficient mes strukturave homologe në luftën kundër krimit ndërkombehtar	Realizuar	<b><u>Ministria e Brendshme</u></b> - Memorandum bashkëpunimi ndërmjet DPPSH të Republikës së Shqipërisë dhe strukturat të hetimit të krimit ekonomik e financiar në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën e Veriut. Nënshkruar 12 shtator 2019. - Marrëveshje Pune ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Qendrës Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave, nënshkruar më 13 mars 2019. - Letër Qëllimi mbi bashkëpunimin për sigurinë ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës Shqipërisë

								<p>dhe Ministrisë së Brendshme të Katarit, nëshkruar më 17 prill 2019.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Memorandum Mirëkuptimi mes Minsitrisë së Brendshme të Republikës Çeke dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, për dhurimin e pajisjeve për autoritetet ligjzbatuese në luftën kundër krimit kibernetik. Nënshkruar nga dy Ministrat e Brendshëm në Pragë, Çeki në datë 14.11.2019.</li> <li>- Me anë të ligjit 77/2019, Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për luftën kundër falsifikimit të monedhës; Shqipëria aderoi në këtë konventë.</li> <li>- Aneksi i Protokollit Shtesë mbi Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore përmes Kufijve Shtetërorë dhe për intensifikimin e Identifikimit, Njoftimit, Referimit dhe Kthimit të Asistuar të Viktimave, si dhe të personave të dyshuar si Viktima të Trafikimit të Qenieve Njerëzore, në plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin në Luftën Kundër Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Trafikut të Paligjshëm të lëndëve Narkotike, Substancave Psikotrope dhe</li> </ul>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

								Pararendësve të tyre, Migracionit të Paligjshëm dhe Aktiviteteve të tjera të Paligjshme, 16 tetor 2019.
B .4 .4	Kryerja e takimeve dhe analizave të përbashkëta për zbatimin e marrëveshjeve dhe rezultateve të arritura	Ministria e Brendshme	Tremujori i 3-të	Buxheti i shtetit	Numri i takimeve dhe analizave	Rritja e transparencës dhe besimit mes agjensive homologe të zbatimit të ligjit	Realizuar	<p>Gjatë vitit 2019, janë zhvilluar 2 analiza të brendshme nga MB mes Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive dhe Drejtorisë së Integritit dhe Marrëveshjeve, në shqyrtim të progres-raportit të Komisionit Europian, mbi zbatimin e rekomandimeve të tyre.</p> <p>Nënshkrimi i marrëveshjes me Qendrën Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave ishte rekomandim i progres-raportit të vitit paraardhës, që në vitin 2019 u evidentua si sukses.</p> <p>Gjatë takimit me palën maqedone për çështjet e trafikimit të personave, u evidentua nevoja nënshkrimit të një aneksi në protokollin shtesë mbi Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore përmes Kufijve Shtetërorë dhe për intensifikimin e Identifikimit, Njoftimit, Referimit dhe Kthimit të Asistuar të Viktimave, si dhe të personave të dyshuar si Viktima të Trafikimit të Qenieve Njerëzore, në plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin në Luftën Kundër</p>



								Terrorizmit, Krimet të Organizuar, Trafikut të Paligjshëm të lëndëve Narkotike, Substancave Psikotrope dhe Pararendësve të tyre, Migracionit të Paligjshëm dhe Aktiviteteve të tjera të Paligjshme.
B .4 .5	Rritja e pjesëmarrjes aktive të Policisë së Shtetit Shqiptar e numrit të aksioneve të përbashkëta policore.	PSH		Buxheti i shtetit	Numri i operacioneve të përbashkëta hetimore	Ulja e krimit transnacional në fushën e krimeve ekonomike e financiare	Realizuar	Gjatë kësaj periudhe është evidentuar 1 Operacion i përbashkët policor ndërkombëtar në bashkëpunim me Drejtorinë për Krimet Ekonomike dhe Financiare.

- *Qasja ndërgjegjësuere - C*

***Objektivi C.1 Ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë mbi pasojat e korrupsionit***

**Treguesit e performances/Indikatorit:**

**C.1.a: Krijimi i një plani vjetor të komunikimit dhe visibiliteti të Strategjisë Antikorrupsion**

***Indikatorit C.1.a për Objektivin C.1, është arritur në masën 50%.***

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Zbatimi i masave të Plan Veprimit

Harmonizimi i qasjes së vizibilitetit dhe komunikimit në kornizën e anti-korrupsionit është shumë e rëndësishme për të shpërndarë një mesazh dhe qasje të përbashkët. Një plan vjetor i vizibilitetit dhe komunikimit për Strategjinë Kundër Korrupsionit do të shmangë organizimin e ngjarjeve të komunikimit për anti korrupsionin në një mënyrë të pakordinuar dhe reaktive, të pakordinuar midis entiteteve të ndryshme qeveritare (në nivel qendror dhe lokal).

Ky Plan do të përfshijë prioritetet për t'u adresuar, objektivi i grupeve / institucionet, mjetet e shpërndarjes, mesazhet gjatë fushatave si dhe buxhetet për zbatimin.

Hartimi i planit do të kordinohet nga MD / KKK, në konsultim me institucionet e tjera. Zbatimi i planit do të ndikojë pozitivisht në perceptimin e qytetarëve për përpjekjet e zbatuara në Shqipëri kundër korrupsionit.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari krijimin e planit vjetor të vizibilitetit dhe komunikimit (procesit) dhe më pas përdorimin e tij operacional (performancën).

#### **C.1.b: Numri i fushatave vjetore për rritjen e ndërgjegjësimit në luftën kundër korrupsionit**

***Indikatori C.1.b për Objektivin C.1, është arritur në masën 100%.***

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Përmirësimi i mos tolerimit të korrupsionit nga Institucionet Publike,

- Rritja e çështjeve të raportuara mbi korrupsionin,
- Inkurajimi i bashkëpunimit më shoqërinë civile.
- Rritja e transparencës dhe përmirësimi i aksesit të informacionit publik
- Forcimi i integritetit të zyrtarëve publike

Do të hartohet një plan komunikimi i gjerë. 4 fushata të mëdha janë parashikuar gjatë vitit 2018; me qëllimin (1) për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për pasojat e korrupsionit dhe si ta denoncojnë dhe trajtojnë atë: (2) të rrisë ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me transparencën dhe të drejtën për informim: (3) të rrisë ndërgjegjësimin e sektorit publik dhe privat për zbatimin e Ligjit për Sinjalizimin: (4) të rritë ndërgjegjësimin e publikut dhe të zyrtarëve për forcimin e integritetit të zyrtarëve publikë;

Fushatat e rritjes së ndjeshmërisë duhet të jenë të qëndrueshme dhe afatgjata të orientuara dhe të planifikuara në një mënyrë që të arrijnë grupet relevante me

dendësi të mjaftueshme të komunikimit.

Kjo nënkupton një komunikim të qëndrueshëm "themelor" dhe disa "maja te komunikimit" gjatë periudhës. Fushata duhet të:

- Integrojnë disa kanale dhe mjete të komunikimit të cilat janë koherente,
- të ketë një dizajn tërheqës dhe lehtësisht të dallueshëm,
- Përcaktojnë grupe relevante duke përfshirë vendimmarrësit dhe mediat, dhe qëllim efekte të qëndrueshme.

Nr	Masa/Aktivitetet	Institucioni Përgjegjës/ Raportues	Kohëzgjatja/ Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
C . b . 1	Forumi i parë konsultativ (i brendshëm): shkëmbimi mbi planin e veprimit  Forumi i parë konsultativ (publik): sinjalizuesit	MD		MD/TAC/EU  MD pa kosto shtesë,	Pjesëmarrësi është i informuar për progresin dhe përfshirjen e planit të veprimit;  Progresi dhe pengesat në implementimin e Ligjit Për Sinjalizimi	Angazhimi i përgjithshëm i palëve të interesuara për aktivitetet e projektit për planin e veprimit kundër korrupsionit;	Realizuar në vitin 2018	

					n dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve	Zbatimi i plotë i Ligjit për Sinjalizimin		
C . b . 2	Takimi kordinues i donatorëve/ Konferencë për shtyp të planit të veprimit	MD	Tetor	MD MD pa kosto shtesë,	Numri i Donatorëve të pranishëm në takim	Qasja gjithëpërfshirëse: Përfshirja e donatorëve në procesin e zbatimit të AP kundër korrupsionit	Realizuar	Në date 11 Tetor 2019 u organizua takimi me partnerë ndërkombëtarë për planin e antikorrupsionit. Në këtë takim u bë një prezantim i rezultateve 6 mujore të masave të marra kundër korrupsionit si dhe të objektivave të reja të Planit të ri të Veprimit 2019-2023. Në takim u diskutua dhe lidhur me mbështetjen dhe financimin për masat antikorrupsion të Planit të ri të Veprimit 2019-2023. Në këtë takim morën pjesë ambasadorë si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Në këtë takim morën pjesë 29 persona.
C . b . 3	Vrapo kundër korrupsionit: Event i informues 10 km vrapim kundër korrupsionit: kanale online	MD		TAC/EUD/Bashkia/MD	Numri i pjesëmarrësve në eventin ndërgjegjësues	Numri i pjesëmarrësve në ngjarje duhet të jetë i vetëdijshëm për pasojat e korrupsionit dhe duhet të inkurajohet	Realizuar në vitin 2018	

						en të denoncoj në korrupsionin		
C . b . 4	Forumi i Dytë Konsultativ: Liria e Informacionit	MD		TAC/EUD/MD	Angazhim dhe përfshirje e plotë e palëve	Përmirësi i aksesit të qytetarëve në informacion	Realizuar në 2018	
C . b . 5	Filloi: Zëra Kundër Korrupsionit: Fushata dëshmuese	MD		TAC/EUD		Numri i njerëzve të ndërgjegjësuar mbi pasojat e korrupsionit	Pa realizuar	Aktiviteti nuk është realizuar gjatë vitit 2019.
C . b . 6	Rock kundër korrupsionit: festival muzikor	MD		TAC/EUD	Numri i pjesëmarrësve në eventin ndërgjegjësues	Numri i pjesëmarrësve në ngjarje do të jetë i vetëdijshëm për pasojat e korrupsionit dhe	Pa realizuar	Aktiviteti nuk është realizuar gjatë vitit 2019.

						do të inkurajohet për të denoncuar raste korruptive		
C . b . 7	Filloi: Informacion kundër korrupsionit: turne informues/ fletëpalosje	MD		TAC/EUD	Numri i qytetarëve të informuar	Informimi i publikut për pasojat e korrupsionit	Realizuar	Janë konceptuar fletëpalosje me informacion në tre drejtime: Liria e informacionit, ndërgjegjësimi për zbatimin e ligjit të sinjalizuesve dhe integritetit. Është përmbyllur dhe prezantuar në muajin prill 2019.
C . b . 8	Forumi i Tretë Konsultativ: Integriteti	MD		TAC/MD	Angazhim i plotë dhe përfshirje e palëve të interesuara	Forcimi i integritetit të zyrtarëve publikë;	Realizuar në 2018	
C . b . 9	Të rinjtë kundër korrupsionit: Shkëmbimi/eksperiencat/bashkëpunimi i të rinjve	MD		Zyra e Huaj Gjermane	Miratimi i praktikave më të mira për trajtimin e korrupsionit	Edukimi i të rinjve	Realizuar	Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar në tremujorin e fundit të vitit 2019 tre aktivitete me pjesëmarrjen e të rinjve/studentëve mbi luftën kundër korrupsionit. Në muajin tetor, Ministria e Drejtësisë zhvilloi një takim ndërgjegjësues me studentët e Fakultetit të Drejtësisë me fokus rolin e GRECO-s në luftën kundër korrupsionit dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe në vendet anëtare të KE-së. Në takim u diskutua mbi GRECO-n si instrument në luftën antikorrupsion dhe ndikimin që

								<p>rekomandimet kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional në vend për ndërtimin e shtetit të së drejtës.</p> <p>Në muajin nëntor Ministria e Drejtësisë organizoi një Workshop në bashkëpunim me Universitetin Washington &amp; Lee dhe Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Workshopi u fokusua në praktikën më të mira kundër korrupsionit, në kuadrin e bashkëpunimit kërkimor në kohështirje disa mujore mes studentëve të dy universiteteve. Stafi i dedikuar antikorrupsionit i Ministrisë së Drejtësisë do të angazhohet në plotësim të iniciativës me research mbi strukturat më të mira për të luftuar korrupsionin, si edhe masat që mund të merren në sektorë kyç si arsimit, shëndetësi, pronat dhe prokurimet publike.</p> <p>Në muajin dhjetor Ministria e Drejtësisë u zhvillua një takim me gazetarët, në fokus të të cilit ishte mes pikash të tjera edhe lufta antikorrupsion. Ministria e Drejtësisë ndau me median dokumentat strategjike, arritjet vjetore dhe sfidat që shtrohen në rolin e saj si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit.</p>
C . b	Forumi i Katërt Konsultativ: Konflikti i	MD		TAC/EUD/M D	Angazhim i plotë dhe përfshirje e	Forcimi i regjimit të	Realizuar në 2018	

. 1 0	Interesave				palëve të interesuara	zbulimit dhe kontrollit të rasteve të konfliktit të interesit		
C .b .1 1	Film kundër korrupsionit: festival filmi	MD		TAC/EUD	Nr I personave të informuar	Informimi i publikut për pasojat e korrupsionit me metodat vizuale	Realizuar në 2018	
C .b .1 2	Anketë kundër korrupsionit: Event i opinionit publik në bashkëpunim me IT	MD	Shkurt	TAC/EUD	Perceptimi mbi indeksin e antikorrupsionit	Mbledhja e të dhënave dhe analizimi ;	Realizuar	Për të vlerësuar efektet e masave antikorrupsion të Qeverisë dhe fushatës për rritjen e ndërgjegjësimit është zhvilluar një anketim me metodën e anketimit online mbi sinjalizuesit, së bashku me partneret akademik dhe shoqërinë civile. Anketimi është kryer me një sondazh online nëpërmjet faqes së internetit të projektit si dhe në faqet partnere. Anketat u shpërndanë në formë të printuar tek studentët në Universitetet e Tiranës, Shkodrës dhe Vlorës. Gjithashtu u realizua dhe një anketim rastësor. Kjo anketë kundër korrupsionit është prezantuar dhe përmbyllur në muajin Prill të vitit 2019.



C .b .1 3	Forumi i pestë Konsultativ Konkluzione & hapat e ardhshëm	MD	Mars	TAC/EUD/M D	Angazhim dhe përfshirje e plotë e palëve	Përcaktimi i hapave të mëtejshëm në luftën kundër korrupsionit	Realizuar	Forumi i pestë konsultativ, një takim ku do të trajtoheshin praktikat më të mira, konkluzionet do të hidhen më pas, mund të konsiderohet takimi përmbyllës i projektit, pasi aty u diskutuan të gjitha sa më lart, edhe ky i zhvilluar në muajin prill 2019. Në këtë takim u trajtuan të gjitha tematikat e parashikuar për forumin.
C .b .1 4	Mëngjesi Anti-korruption: takimet rregullisht dhe në sesionet/edicionet e veçanta	MD	periodikisht	Paguar nga çdo pjesëmarrës	Nr. i takimeve Nr. i pjesëmarrësve	Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe donatorët	Realizuar	“Në takimin e mëngjesit me studentët e ekselencës që kontribuojnë në Ministrinë e Drejtësisë, për Kodifikimin, Rregullimin e Profesioneve të Lira dhe Politikat Antikorrupsion”. Në datën 27 Shtator, Ministri i Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit ka zhvilluar takimin e mëngjesit me studentët e ekselencës që kontribuojnë në Ministrinë e Drejtësisë, me fokus politikat antikorrupsion. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe dhe konkretisht në muajin Shtator, nën drejtimin e Ministrit të Drejtësisë është organizuar një mëngjes pune me përfaqësues nga shoqëria civile, gjatë së cilës është diskutuar për përfshirjen e tyre antikorrupsion.
C .b .1	Takimi i Ministrit: KKK vizitë në vënde të ndryshme për subjekte të	MD	x	Buxheti i Shtetit /Pa kosto	Nr. i takimeve Nr. i personave të	Rritja e transparencës; qasje më të mirë	Realizuar	Vizitë e Ministres Gjonaj në Qarkun Lezhë; “Lufta kundër korrupsionit, rritja e cilësisë së trajtimit të të paraburgosurve dhe të burgosurve do të jenë çështjet kryesore në sistemin

5	ndryshme: Promovimi i Transparencës/ Reformës së Derregullimit /Integritetit/Proce sit të Planit të veprimit				informuar	në informat a për qytetarët	<p>penitenciar”. Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj zhvilloi një vizitë në Kosovë.” Shqipëria është në fazën finale të ngritjes së SPAK-ut, që do të hetojë krimin e organizuar si dhe korrupsionin në nivele të larta”.</p> <p>Vizitë dyditore në Austri, takim me Ministrin e Drejtësisë Austriake dhe nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit. Takim me Kryetaren e Gjykatës Kushtetuese.</p> <p>Takim me zyrtarë të lartë të OGP për të nxitur transparencën në nivel global dhe luftuar korrupsionin.</p> <p>Konferenca me temë: “Mjete në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit”.</p> <p>Takim me studentë të Universitetit të Hagës.</p> <p>Prezantim i Projektit të Masterit në kriminologji në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, OSBE dhe Ambasadën Britanike.</p> <p>Vendet e vizituara gjatë kësaj periudhe janë: Londër, Vienë, Berlin (2 vizita), Paris, Romë Bruksel, Strasburg. Gjithashtu, në kadër të luftës kundër korrupsionit, Koordinatori Kombëtar ka qënë pjesëmarrës në takimin e Polit të Drejtësisë, zhvillua në muajin Korrik 2019. Gjatë muajit Shtator janë zhvilluar dy takime, njëri prej të cilëve</p>
---	---	--	--	--	-----------	--------------------------------------	---

								<p>me deputetin gjerman Patrick Ernest Hermann Sensburg, dhe tjetri me Sekretarin e Shtetit në Ministrinë gjermane të Drejtësisë z. Christian Lange. Qëllimi i takimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe ka qenë prezantimi i disa nga rezultateve dhe objektivave mbi luftën kundër korrupsionit.</p> <p>15 nëntor – Takimi me Prokurorin Kombëtar të Drejtorisë Antimafia dhe Antiterrorizëm në Itali, Z. Federico Cafiero De Raho.</p> <p>18 nëntor - “Forumi Ministerial EU”.</p> <p>26 Tetor - Mëngjes pune me një përfaqësi të gjerë të shoqërisë civile.</p> <p>22 Tetor – Takimi me zv. ndihmës sekretarin e Shtetit të SHBA-ve, z. Jorgan K. Andrews.</p> <p>12 Tetor - Takim me përfaqësitë diplomatike dhe partnerët tanë ndërkombëtarë për të prezantuar disa nga rezultatet dhe objektivat mbi luftën kundër korrupsionit.</p> <p>4 Tetor - “Ministeriali i Drejtësisë”</p> <p>2 Tetor - Vizita e delegacionit gjerman në MD.</p>
C . b . 1 6	Debati televiziv me Ministrin si KKK duke prezantuar SPAK dhe Byronë e Hetimit	MD	x	Buxheti i Shtetit /Pa Kosto	Nr. i debateve	Rritja e transparencës; përmirësi mi i trajtimit	Realizuar	<p>12 deklarata për shtyp ku raportohet në mënyrë periodike të përjavshme për rezultatet e Task Forcës Antikorrupsion.</p> <p>Deklaratë për shtyp e Ministrit të Drejtësisë me temë: “Mbështetje</p>

						<p>të rasteve të korrupsionit; Përmirësi mi i efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit; përmirësi mi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit në ndjekjen penale dhe ndëshkimin e korrupsionit;</p>		<p>prokurorisë në luftën kundër korrupsionit, para përgjegjësishë ata që kanë abuzuar me ligjin dhe detyrën”. Intervistë në ERTV mbi shërbimin e ri Fast-Track, përmes të cilit mund të merren 9 shërbime në vetëm 24 orë. Dalje në televizionin ALB-UK nga Britania e Madhe ku nënvizoi projektet e Qeverisë Shqiptare për luftën kundër korrupsionit. Deklaratë për shtyp: “Rekomandimet e TI, pjesë e politikave të Qeverisjes, si parakusht për suksesin në luftën kundër korrupsionit”. Mbledhja e Komitetit Koordinator zhvilluar më datë 25.04.2019. Eventi me Projektin Twining më datë 26.04.2019, si dhe deklarata e përbashkët me Ministrin MoJ së Austrisë më datë 26.04.2019.</p>
C	Komunikimi	MD	x		Nr. i	Përmirësi		- Gjatë muajit Shkurt 2019 u realizua

. b . 1 7	audio-viziv i trajnimeve administrative mbi anti-korrupsionin				personave të trajnuara	mi i trajtimit të rasteve të korrupsionit;	Realizuar	trajnimi me temë “Anti -Korrupsioni për pikat e kontaktit në institucionet publike”. Ky trajnim u organizuar nga ASPA në bashkëpunim me Projektin Twinning “Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e politikave antikorrupsion në Shqipëri”, financuar nga BE. U trajnuan 11 trajnere per pikat e kontaktit antikorrupsion nga Projekti Twinning “Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e antikorrupsionit”. - Gjatë muajit Mars 2019 në datat 4-5 dhe 11-12, në ambjentet e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) u trajnuan 32 persona, pika kontakti antikorrupsion lidhur me vleresimin e rrishtit per korrupsion dhe zbatimin e masave antikorrupsion. - Në datat 28-29 Mars, në ambjentet e hotel Rogner u realizua trajnimi me temë “Mjetet për parandalimin e korrupsionit dhe planet e integritetit”. Ky trajnim u organizua nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE Tiranë dhe Agjensinë Kombëtare Antikorrupsion të Italisë (ANAC). Gjatë këtij trajnimi u trajnuan 38 nëpunës. - Gjatë muajit Prill 2019 u realizua trajnimi me temë: “Evidentimi i Rreziqeve për Korrupsion (Corruption Proofing)”. Ky trajnim u organizua nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin Twinning
-----------	---	--	--	--	------------------------	--	-----------	--

								<p>“Për mbështetjen, koordinimin dhe zbatimin e politikave antikorrupsion në Shqipëri”, financuar nga BE; Trajnimi u mbajt në datat 16-17-18 Prill (Stafi Antikorrupsion dhe Drejtoria e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, në datën 18 Prill), në ambjentet e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike(ASPA). Në këtë trajnim u trajnuan 73 nëpunës. - Në datën 24 Prill 2019, në ambjentet e MakAlbania Hotel u organizua nga ICC Albania (National Committee of the International Chamber of Commerce trajnimi me temë: “Anticorruption”). Nga ky trajnim u trajnuan 21 persona. - Gjatë muajit Qershor 2019 në datë 3 qershor 2019 u organizua nga ASPA trajnimi me temë: “Korrupsioni në administratën publike dhe mekanizmat e identifikimit në luftën kundër tij”, i mbajtur në të njëjtin ambjent. Në këtë trajnim u trajnuan 18 persona. Trajnim lidhur me menaxhimin e Financave Publike në kuadër të luftës AC zhvilluar në datat 11- 13 Shtator.</p>
C . b . 1 8	Raporte mujore/Çerek mujore në çështjet e adresuara në faqen e Ministrisë së Drejtësisë (Faqja e anti-	MD	x	Buxheti i Shtetit /Pa kosto  _____	Nr.i rasteve të raportuara	Përmirësi mi i trajtimit të rasteve të korrupsionit;	Realizuar	Publikuar në faqen Zyrtare të MD raportet e Monitorimit, Vjetore 2018, Tremujore 2019, Gjashtëmujore 2019, Nëntëmujore 2019 të SNKK-së.

	korrupsionit)							
C .b .1 9	Rritja e kapacitetit të aftësisë dhe kapacitetit të kordinatorëve për Lirinë e Informimit.	KMDIDP		Buxheti i Shtetit /Pa kosto _____	Numri i trajnimeve / nr i personave të trajnuar	Përmirësi mi i aksesit në informacion	Përfunduar në vitin 2018.	
C .b .2 0	Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për Ligjin për Të Drejtën e Informimit	KMDIDP		Buxheti i Shtetit /Pa kosto _____	Nr i ligjeratave/ nr i personave të trajnuar	Përmirësi mi i aksesit në informacion	Përfunduar në vitin 2018.	
C .b .2 1	Fushata për rritjen e ndërgjegjësimit në sektorin privat për forcimin/zbatueshë mërinë e Ligjit mbi Sinjalizuesit	ILDKPKI	x	_____		Forcimi i regjimit të rasteve të sinjalizuesit dhe kontrollit të zyrtarëve public	Përfunduar në vitin 2018.	Aktivitet i mbivendosur me A.5.11..

**Objektivi C.2 Nxitja e publikut për të përdorur aktivisht mekanizmat për denoncimin dhe parandalimin e korrupsionit**

**Treguesit e performances/Indikatorit:**

## **C.2.a: Numri i denoncimeve të korrupsionit nga qytetarët të ardhura në platformën shqiperiaqeduam.al**

### **Indikatori C.2.a, për Objektivin C.2, është i perealizuar.**

Target për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Rritje prej 25% në krahasim me vitin paraprak; Rritje prej 30% në krahasim me vitin paraprak, Rritje prej 30% në krahasim me vitin paraprak.

Portali i ri, shqiperiaqeduam.al, nga tetori i vitit 2017, krijoi një "one-stop shop" (pikë shërbimi me një ndalesë) për të gjitha ankesat dhe propozimet e qytetarëve. Portali stopkorrupsionit.al është mbyllur dhe funksionet e tij janë integruar nga portali shqiperiaqeduam.al.

Në mënyrë të veçantë për denoncimin e korrupsionit, portali i ri kërkon që qytetarët të identifikohen duke dorëzuar denoncime. Ky funksionalitet i ri ndikon pozitivisht në kapacitetin e zbatimit të ligjit për të ndjekur hetimet bazuar në denoncimet e qytetarëve nëpërmjet portalit.

Denoncimet e korrupsionit do të gjurmohen, nga ana e portalit, në mënyrë të veçantë nga të gjitha ankesat e tjera.

Treguesi do të vlerësohet duke matur numrin total të denoncimeve të qytetarëve për korrupsion të paraqitura në portalin shqiperiaqeduam.al

## **C.2.b: Numri i rasteve të korrupsionit të gjeneruara nga denoncimet e qytetarëve në www.shqiperiaqeduam.al, të cilat janë raportuar në Policinë e Shtetit/Prokurori**

### **Indikatori C.2.b, për Objektivin C.2, është i paraportuar (Nuk kemi informacion pasi është task forca antikorruption dhe struktura antikorruption ajo që i referon).**

Target për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Rritje prej 25% në krahasim me vitin paraprak; Rritje prej 30% në krahasim me vitin paraprak, Rritje prej 30% në krahasim me vitin paraprak.

Portali i ri, shqiperiaqeduam.al, nga tetori i vitit 2017, krijoi një "one-stop shop" për të gjitha ankesat dhe propozimet e qytetarëve. Portali stopkorrupsionit.al është mbyllur dhe funksionet e tij janë integruar nga portali shqiperiaqeduam.al.

Në mënyrë specifike për denoncimin e korrupsionit, portali i ri kërkon që qytetarët të identifikohen kur dorëzojnë denoncime. Ky funksionalitet i ri ndikon pozitivisht në kapacitetin e zbatimit të ligjit për të ndjekur hetimet bazuar në denoncimet e qytetarëve përmes portalit.

Denoncimet e korrupsionit do të gjurmohen, nga ana e portalit, në mënyrë të veçantë nga të gjitha ankesat e tjera. Ato dërgohen në institucionet përgjegjëse, aty ku bëhet një vlerësim i nivelit të parë. Rastet që konfirmohen të lidhen me praktikatat korruptive, i referohen Policisë Shqiptare për hetime të mëtejshme.



Treguesi do të vlerësohet duke matur numrin total të rasteve të korrupsionit të krijuara nga denoncimet e qytetarëve në shqiperiaqeduam.al, të cilat raportohen nga institucionet e linjës tek Policia Shqiptare.

Nr	Masa/aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/Raportues	Kohëzgjatja /Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor 2019	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019	Alokimi për periudhën janar-dhjetor 2019				
C. 2. 1	Raportimi periodik i Agjencisë mbi denoncimet në portal	Agjencia për dialog dhe bashkëqeverisje	Periodikisht	Buxheti i Shtetit	Raporti i Prodhuar	Përmirësimi i vlerësimit të efektivitetit të portalit si mekanizëm raportues	Realizuar	Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, raporton periodikisht mbi denoncimet e qytetarëve dhe bizneseve, çdo javë nëpërmjet të dhënave të detajuara të paraqitura në raport për çdo ministër dhe Kryeministrin. Buxheti i shtetit është burimi i financimit të kësaj mase.
C. 2. 2	Dorëzimi i kërkesave mujore për institucionet e linjës për mbledhjen e	Agjencia për dialog dhe bashkëqeverisje	Periodikisht	Buxheti i Shtetit	Raporti Periodik i Prodhuar	Përmirësimi i vlerësimit të efektivitetit të	Realizuar	Në funksion të këtij objektivi janë përmirësuar proceset në sistemin elektronik të platformës së bashkëqeverisjes duke mundur gjurmimin dhe etiketimin elektronik të rasteve të dyshuara si korruptive.

	<p>numrit të qytetarëve të denoncimeve për korrupsion në portalin të cilat janë raportuar në Policinë e Shtetit Shqiptar / Prokurorinë</p>					<p>portalit si mekanizëm raportues</p>	<p>Për këtë periudhë janë raportuar pranë njësisë antikorrupsion në Kryeministri dhe pranë Task Forces Antikorrupsion ne MD, si dhe në institucionet ku denoncohet, 20 raste nga të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-12 për Ministrinë e Drejtësisë dhe Kryeministrinë,</li> <li>-2 Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,</li> <li>-1 Agjencia Shtetërore e Kadastrës,</li> <li>-1 Ministria e Financave dhe Ekonomisë</li> <li>-1 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,</li> <li>-1 Bashkia Vlorë</li> </ul> <p>Institucionet nuk kanë raportuar se ndonjë nga ankesat/raportimet për raste korruptive i kanë referuar në Policinë e Shtetit apo në Prokurori.</p> <p>Buxheti i shtetit është burimi i financimit të kësaj mase.</p> <p>Në total, për këtë periudhë raportimi janë regjistruar në nivelin qëndror 23,605 çështje, kërkesa, në të cilat janë trajtuar 22,423. Diferenca është e lidhur me ankesat dhe çështjet në proces në momentin e raportimit.</p> <p>Për vitin 2019 janë marrë 171 masa administrative ku në total prej periudhës së funksionimit të platformës deri më tani, janë marrë 814 masa ndëshkimore administrative.</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

### *Objektivi C.3 Inkurajimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile*

#### **Treguesit e performances/ Indikatori:**

#### **C.3.a: Krijimi i një Programi Antikorrupsioni nga AMSHC**

##### **Indikatori C.3.a, për Objektivin C.3, është realizuar në masën 100%.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: Ngritja e Programit Anti-korrupsion (duke përfshirë Planin e Veprimit 2019-2020); Raporti vjetor i zbatimit të Programit Anti-Korrupsion të prodhuar dhe publikuar (si një pjesë specifike e raportit vjetor të Agjencisë); Është përfunduar vlerësimi i jashtëm i zbatimit të Programit Vjetor Kundër Korrupsion të vitit 2019, respektivisht.

Ndër objektivat kryesore strategjike të AMSHC, siç është paraqitur në misionin dhe objektivat e saj, qëndron promovimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që kanë në fokus anti-korrupsionin.

Aktualisht, Agjencia ka një Program të specializuar kundër korrupsionit, i kordinuar nga një departament i saj. Krijimi i një programi të tillë do të kontribuonte pozitivisht në bashkëpunimin afatgjatë me OSHC-të, duke rritur parashikueshmërinë, angazhimin, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin. Programi duhet të përfshijë aktivitetet ekzistuese në fushën e anti-korrupsionit, duke krijuar produktivitet më të madh dhe efekt shumëfishues.

Treguesi do të vlerësohet duke matur së pari krijimin e programit të brendshëm kundër korrupsionit (procesit) dhe pastaj funksionalizimin e tij (performancës).

#### **C.3.b: Përqindja e projekteve mbi antikorrupsionin të financuara nga AMSHC**

##### **Indikatori C.3.b, për Objektivin C.3, është realizuar në masën 80%.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 25 %, 20% dhe 20% respektivisht.

Ndër objektivat kryesore strategjike të AMSHC, siç është paraqitur në misionin dhe objektivat e saj, qëndron promovimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që fokusohen në anti-korrupsionin.

Niveli i Thirrjes për Propozime të lancuara dhe veprimet e financuara, në fushën e anti-korrupsionit, paraqet një tregues të rëndësishëm të performancës. Analiza e të dhënave të tilla do të bëhet në kombinim me Indikatorin C.3.a (me Thirrje për Propozime që janë pjesë e programit Anti-Korrupsion nga viti 2019) dhe C.3.c (alokimi i buxhetit).

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin e projekteve të financuara në fushën e anti-korrupsionit, mbi numrin e përgjithshëm të projekteve të financuara nga AMSHC. Formula specifike e përdorur për vlerësimin do të jetë:

$$AK\ Proj = \frac{\text{shuma (e numrit te projekteve antikorrupsion te financuara nga AMSHC)}}{\text{shume (e numrit total te projekteve te financuara nga AMSHC)}} \times 100\%$$

### **C.3.c: Buxheti i përcaktuar për mbështjetjen e projekteve të Antikorrupsionit nga Organizatat e Shoqërisë Civile**

#### **Indikatori C.3.c, për Objektivin C.3, është realizuar në masën 70%.**

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 25 %, 20% dhe 20% respektivisht.

Objektivat për tu arritur në 2018, 2019 dhe 2020 janë: 25 %, 20% dhe 20% respektivisht.

Ndër objektivat kryesore strategjike të AMSHC, siç është paraqitur në misionin dhe objektivat e saj, qëndron promovimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që fokusohen në anti-korrupsionin.

Buxheti i alokuar, përmes Thirrjes për Propozime të lancuara dhe projekteve të zhvilluara, në fushën e anti-korrupsionit paraqet një tregues të rëndësishëm të performancës. Analiza e të dhënave të tilla do të bëhet në kombinim me Indikatorin C.3.b (numri i projekteve).

Performanca do të vlerësohet duke matur raportin e buxhetit të ndarë për projektet që synojnë anti-korrupsionin, mbi buxhetin total të alokuar për projekte nga AMSHC. Formula specifike e përdorur për vlerësimin do të jetë:

$$AK\ Proj\text{-}bxht = \frac{\text{shuma ( e buxheteve te projekteve AK te financuara nga AMSHC / buxhetet totale te projekteve te financuara nga AMSHC)}}{100\%}$$

Nr	Masa/Aktiviteti	Institucioni Përgjegjës/ Raportues	Kohëzgjatja/Afati	Fondet e parashikuara	Treguesi i Rezultatit	Treguesi i Impaktit	Statusi i aktivitetit për periudhën janar-dhjetor	Përshkrimi i arritjeve për periudhën janar-dhjetor 2019
			2019					

				<b>periudhën janar-dhjetor 2019</b>			<b>2019</b>	
C.3.1	Hartimi i vendimit të brendshëm për krijimin e një Programi Anti-korrupsion në AMSHC, thirrje për propozime specifike që kanë në qëndër korrupsionin.	AMSHC	Viti 2019	Buxheti i Shtetit /Pa kosto ekstra <hr/> <i>Pa kosto</i>	Është miratuar vendimi për krijimin e programit anti-korrupsion	Aktiviteti i integruar i AMSHC në sektorin e anti-korrupsionit	Realizuar	Përgjatë kësaj periudhe, ashtu siç edhe ishte parashikuar, AMSHC-ja ka hartuar Vendimin e Brendshëm për krijimin e programit Anti-Korrupsion në funksion të monitorimit të aktiviteteve të Institucionit. Programi Anti-Korrupsion ndodhet i pasqyruar në faqen zyrtare të AMSHC-së dhe i aksesueshëm për publikun. Ky program do të jetë objekt botimi i cili në mbarim do t'u dërgohet përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe Institucioneve të huaja të akredituara në Republikë.
C.3.2	Nisja e thirrjes për propozime posaçërisht për të synuar korrupsionin, si pjesë e programit anti-korrupsion, (krijimi i infrastrukturës së duhur me një numër telefoni dhe një email të disponueshëm për raportimin e provave të rasteve korruptive si	AMSHC	Tremujori i 4-t	25.250.000Le <hr/> 20,800,000 <i>lekë</i> 14,140,000 <i>lekë</i>	Numri i rasteve të raportuara të korrupsionit	Aktiviteti i integruar i AMSHC në sektorin e anti-korrupsionit	Realizuar	Përgjatë vitit 2019, AMSHC organizoi thirrjen për asistencë financiare ku, sipas parashikimit në planin e veprimit, 20 % e fondit të grantit, i'u transferua, organizatave të shoqërisë civile të cilat në projektin e tyre, parashikonin luftën kundër korrupsionit. Kështu, janë alokuar për 9 (nëntë) organizata në funksion të zbatimit të projekteve të paraqitura. AMSHC në vijim, do të kryejë rolin monitorues të zbatimit të projektit duke mundësuar, përthithjen e një produkti viziv si dhe një qëndrueshmërie të këtij impakti. Ndërkohë, AMSHC vijon të monitorojë Programin Antikorrupsion të saj.

	brenda AMSHC dhe jashtë saj.)							
C. 3. 3	AMSHC do të zhvillojë seanca trajnimi sensibilizuese gjatë 2018-2019 me OSHC-të në lidhje me luftimin e korrupsionit në të gjitha nivelet e paraqitjes dhe si të identifikohen rastet e korrupsionit.	AMSHC	Tremujori i 2-të	Buxheti i Shtetit /Pa kosto ekstra <hr/> <i>Pa kosto</i>	1.3.a. Numri i trajnimeve 1.3.b. Numri i pjesëmarrësve në këto trajnime	Rritje e informacionit për OSHC-të	Realizuar	AMShC ka realizuar 4 (katër) takime (Vlorë, Kukës, Berat dhe Korçë). Pjesëmarrja ishte mesatare nga përfaqësues të shoqërisë civile. AMShC do vijojë të jetë një promotor i këtyre angazhimeve sensibilizuese në funksion të një shoqërie civile sa më efektive në ndërgjegjësimin e publikut rreth fenomenit të korrupsionit dhe si mund të luftohet ai.

